

GNATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T I
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 27. 7. 2007

T R A N S K R I P T
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 27. 07. 2007. GODINE

KORRIK - JULI 2007

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 12 korrik 2007,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës, z. Agim Çeku, në kërkesë të Grupit Parlamentar ORA,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përkrahje materiale familjarëve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje,
7. Debat lidhur me ndërtimet ilegale kolektive nga qeveria e Serbisë në Veriun e Mitrovicës,
8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me propozimin e Prokurorisë Publike të Kosovës për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

DNEVNI RED

1. Usvajanje zapisnika sa predhodne sednice od 12 juna. 2007 gogine.,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Interpelacija premijera Kosova g-dina Agima Çeku, na zahtev PG ORA,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o materijalnoj podršci porodicama dece sa trajnim ograničenim sposobnostima,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o ličnoj karti,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o tretiranju bespravne gradnje,
7. Debata o ilegalnoj kolektivnoj gradnji u severnom delu Mitrovice od strane vlade Srbije,
8. Razmatranje izveštaja Komisije za pravosuđe, zakonodavstvo i ustavni okvir u vezi predloga Javnog tužilaštva Kosova za imenovanje člana Upravnog odbora Pravosudnog instituta Kosova.

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju lutem, i zini vendet..Të nderuar kolegë deputetë, i nderuari zëvendëskryeministër dhe Kabinet qeveritar . Mirë se keni ardhur në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës! Ju njoftoj se në sallë aktualisht janë 72 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Që në fillim ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 6.2. dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendi në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën plenare. Ndërkohë, në pajtim me Rregullën 23.2 dhe Rregullën 29 janë parashtruar edhe tri mocione për plotësim të rendit të ditës, e këto janë:

1. Grupi Parlamentar i PDK-së ka bërë propozim me shkrim për radhitjen në rend dite të debatit lidhur me situatën e krijuar me rastin e djegies së pyjeve në territorin e Kosovës. Propozimi i plotëson kushtet që të hyjë si pikë e rendit të ditës,
2. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis... propozon që në seancën e sotme të radhës të radhitet çështja e zjarreve në pyjet e Kosovës, dhe
3. Komisioni për Siguri i propozon Kuvendit të shqyrtojë situatën emergjente në vend dhe pas debatit të nxjerrë edhe disa rekomandime.

Andaj, lus deputetët që të deklarohen për miratim të kësaj agjende, respektivisht për këto tri pika shtesë të rendit të ditës, që në fakt është një pikë e rendit të ditës, sepse kanë të bëjnë vetëm me një çështje.

Urdhëroni zoti Gashi!

ALUSH GASHI – Faleminderit, zoti Kryetar. Mendoj se tri propozimet sipas Rregullores së Punës të Kuvendit mund të formulohen si një informatë nga ana e Qeverisë dhe sugjerimi ynë është që ajo të jetë një ndër pikat e para të rendit të ditës, mundësisht menjëherë pas pyetjeve dhe përgjigjeve. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Xhevat Bislimi e ka fjalën.

XHEVAT BISLIMI – Zoti Kryetar, unë propozoj që kjo seancë të shtyhet për arsye se sot në Junik vendoset monumenti - shtatorja e Edmond Hoxhës, njërit prej dëshmorëve të parë të UÇK-së dhe të kombit shqiptar. Është në nderin e deputetëve që sot të jenë atje, ta nderojnë atë që nderoi Kosovën, që nderoi kombin dhe i dha lavdi emrit shqiptar. Prandaj, unë propozoj që të shtyhet seanca dhe deputetët, ata që duan, të shkojnë në Junik. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla

GJYLNAZE SYLA – Faleminderit zoti Kryetar. Që të tri kërkesat, të Lidhjes Demokratike, të dy komisioneve, për Bujqësi dhe Siguri, e mbulojnë të njëjtën çështje dhe të njëjtën temë. Prandaj, mendoj që kjo mund të vihet në rend të ditës dhe me qenë se ministri Kuqi është këtu, ne mund të marrim menjëherë informatën lidhur me këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI – Zoti Kryetar, nëse ka mundësi të na sqaroni për ditën e hënë, nuk është shpërndarë ende thirrja lidhur me debatin për procesin politik në Kosovë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Do të shpërndahet sot, brenda ditës së sotme. I kemi dy propozime. Propozimin e shefit të Grupit parlamentar të LDK-së dhe tri çështjet që janë shtruar sot.

Kush është për? Ju faleminderit! Kundër, nuk ka. Abstenim, nuk ka. Ju faleminderit!

Kemi edhe propozimin e deputetit Xhevat Bislimi, që të shtyhet kjo seancë.

Kush është për? Kush është kundër? Abstenim?

Urdhëroni, ministri Et’hem Çeku e ka fjalën.

MINISTRI ET’HEM ÇEKU – Edhe unë votova për, por zbulimi i bustit bëhet në orën 11,00 dhe tani është, sa është ora? Do të thotë, absolutisht nuk mundemi që në çfarëdo mënyre të mbërrijmë atje. Unë e kam pritur familjen në mëngjes, jam takuar dhe, do të thotë, është e pamundshme që të mbërrihet në orën 11,00.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni, Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA – E kam një propozim, nuk e di se si është votuar dhe cili është rezultati i votimit. Por me qenë se busti ngritet në orën 11,00 propozoj vazhdimin e seancës në orën 14:00.

KRYETARI KOLË BERISHA – Pse pikërisht në 14:00. Gjylnaze Sylja e ka fjalën prapë.

GJYLNAZE SYLA – Zoti Kryetar, u sqaruam që në orën 11:00 është ngritja e bustit. Në qoftë se deputetët dëshirojnë të marrin pjesë dhe duan, natyrisht në shenjë respekti, atëherë mbasi të kryhet ceremonia, e kanë për obligim të vijnë të punojnë në Kuvend. Në aspektin kohor propozoj që kjo të jetë ora 14:00 se më duket rationale që në atë kohë mund të mbërrijmë. Faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni, Gani Koci.

GANI KOCI – Arsyetimi i zotit ministër Çeku ishte shumë me vend dhe ishte shumë i drejtë, por ishte i pakohë. Do të vlente vetëm pas propozimit që e bëri Xhevat Bislimi. Edhe propozimet që i bëri zonjusha e AAK-së është sikur kofini pas të vjelave. Nuk u deklarua askush për ose kundër në diskutim për propozimin e zotit Xhevat. Ju e vutë në votim dhe të gjitha procedurat dhe propozimet e tjera nuk vlejnë. Duhet të komunikoni rezultatin e votimit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Për shtyrje kanë qenë 25 vota. Kush është kundër? Mirë, thashë se 25 kandidatë kanë votuar për, 1 kundër. Shtyhet seanca.

Të martën, në orën 10:00, fillojmë me seancë. Të hënën është seanca e rregullt që është thirr.

* * *

E martë, 31 korrik 2007

Vazhdimi i seancës së ndërprerë më 27. 7. 2007

KRYETARI KOLË BERISHA – Me qenë se në mbledhjen e kaluar kemi aprovuar rendin e ditës, sot do të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Ju njoftoj se në sall kemi 75 deputetë prezentë. Urdhëro Gjergj!

GJERGJ DEDAJ – Faleminderit shumë, zoti Kryetar,

Zoti Kryeministër, ministra, deputetë,

Unë kam një vërejtje, jo pse është shtyrë seanca e kaluar për sot, keni bërë shumë mirë, bile është shumë e ndershme që me propozimin e deputetit Bislimi është shtyrë për të nderuar dëshmorin Edmond Hoxha. Mirëpo, më 27 prill të këtij viti po në këtë Parlament keni mbajtur seancë kur kam kërkuar që të shkojmë në Mejë, atë ditë kur janë varrosur 22 martirë të Kosovës dhe në atë vend janë varrë 377 shqiptarë, dhe nuk e keni bërë një gjë të tillë. Po ashtu, më 27 korrik, po atë ditë që keni shkuar në Junik, që keni bërë mirë që keni shkuar, në Korronicë është zbuluar pllaka përkujtimore për 102 martirë. Askush nuk ka ardhur prej Parlamentit, as RTK-ja, askush se keni ngritur zërin për atë gjë dhe unë mendoj se Kryesia e Kuvendit, Parlamenti dhe ju, zoti Kryetar, duhet të bëni një trajtim të barabartë për të gjitha monumentet, për të gjithë dëshmorët dhe për të gjithë martirët e Kosovës. Faleminderit shumë!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Shkojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 12 korrik 2007

Procesverbali u është shpërndarë deputetëve. A ka kush vërejtje? Fetah Berisha.

FETAH BERISHA – Faleminderit, zoti Kryetar.

Zoti Kryetar, në këtë Kuvend kohë më parë që propozuar të thuhet: “Miratimi i procesverbalit dhe i transkriptit”. Ky propozim u jetësua mbase dy herë. Fjala transkript, zoti Kryetar, ju përkujtoj edhe njëherë se ngërthen në vete brumin ose materialin e diskutimeve të deputetëve. Pra, edhe një herë fjalën e kam për gabimet gjuhësore, po tani nuk do ta përmend atë gabimin e famshëm kur Presidentin Athisari e patën bërë prej “ndërkombëtar” në “kombëtar”, nuk do t’i përmendi as proceset e montuara politike që i bënë “çeset e montuara politike”, po këtë herë e kam fjalën vetëm për një gabim, e nëse në 100 deputetë bëhet në çdo transkript nga një gabim, do me thënë janë 100 gabime gjuhësore. Këtu fjalën e kam për një Projektligj që është aprovuar këtu, në Parlamentin tonë, ku në vend të fjalës në lëmin e legjislacionit, është thënë: “në lëmin e licitacejonit”.

Do me thënë, gabimet gjuhësore po vazhdojnë qetë, pa u trazuar, e ju të çmuar deputetë, ju drejtohem edhe juve, duke ju përkujtuar se ky Parlament këtu në pikëpamje profesionale është heterogjenë, e mirë që është i tillë. Po, edhe matematicienti, edhe fizikienti, edhe historiani, edhe juristi, e gjeografi, kimisti e të tjerë, e kanë për detyrë që të mundohen ta flasin dhe ta shkruajnë gjuhën drejt e mirë, e pa gabime. Prandaj, zoti Kryetar, është koha e fundit të ndërmerrni diçka që të eliminohen gabimet nga diskutimet e deputetëve që i bëjnë. Ju faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI – Faleminderit, zoti Kryetar.

Më lejoni që t'i bëjë dy vërejtje, së pari në transkripto, në pjesën ku është përfshirë diskutimi im janë përvjedhur, besoj teknikisht, së paku tri lëshime. Në vend të shprehjes “prirur” është shënuar “thirrur”, në vend të “pashtyshme” është thënë “pashtushme” dhe në vend të “Ordër Pejper” është shkruar “Ordej Papër” që është kuptim tjetër. Kërkoj që të korrigjohen dhe mendoj që kjo është mirë të bëhet publikisht këtu dhe të mos lejohet praktika e ndërhyrjeve në tekst post festum pasi të shihet a ka dalë mirë a s’ka dalë mirë. Dhe vërejtja tjetër që është përmbajtësore, zoti Kryetar, në procesverbalin të mbledhjes së kaluar ka një shpërputhje me transkriptin dhe me punën e Kuvendit. E kam fjalën për pjesën që ka të bëjë me amendamentet në Rregulloren e Punës. Për të mos marrë kohë, është mirë të krahasohen dhe të korrigjohen. Meqë kjo nuk mund të bëhet këtu pa na marrë shumë kohë, propozoj që, meqë është ndërruar substanca e gjithë punës, edhe e vendimit edhe e vendimmarrjes edhe terminologjia, propozoj që procesverbali të mos miratohet në këtë mbledhje, por të krahasohet me transkriptin, të saktësohet dhe të na sillët herën tjetër. Nëse Kuvendi vendos ndryshe, atëherë jam gati që të bëj edhe shpjegimet konkrete. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Ragip Zekolli.

RAGIP ZEKOLLI – Faleminderit zoti Kryetar. Unë desha vetëm të sqaroj një diçka që u tha në fillim të seancës lidhur me atë që kërkoi zoti Dedaj. Nga ky Parlament kemi shkuar atë ditë në Meje deputetë të subjekteve të ndryshme politike duke ju falënderuar sekretarit të Kuvendit që shumë shpejtë na ka siguruar makinën e udhëtimit. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëro Gjergj.

GJERGJ DEDAJ – Unë thashë dhe po e përsëris. Dëshmorët dhe martirët kudo në Kosovë duhet t'i respektojmë gjithnjë njësoj. Atë ditë, më 27 prill kam kërkuar që të mos mbahet seanca, të shtyhet për shkak se atë ditë janë varrosur 22 martirë. Nuk ka ndodhur, në rregull, nëse mendoni që është në rregull. E respektoj atë që keni bërë për Edmond Hoxhën dhe i përkulem dhe i gënjëzohemi, kemi shumë respekt për Edmond Hoxhën dhe gjithë dëshmorët. Këtë e thashë, që në të ardhmen Kuvendi i Kosovës të mos bëjë për dikë shtyrje, e për dikë mosshyrje, t'i trajtojë të gjithë njësoj dhe kjo është poenta, e ndoshta zoti Zekolli s'e ka kuptuar.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëro, Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI – Unë dua ta falënderoj edhe Gjergjin, edhe Kuvendin në përgjithësi, për qëndrimin që ka marrë me kërkesë të deputetit Bislimi për të marrë pjesë në zbulimin e përmendores së zotit Hoxha. Njëkohësisht jam plotësisht dakord me zotin Dedaj, që thotë të mos ketë dallime në këtë drejtim, por realiteti është ky që është tek ne. Realisht, Kryesia e Kuvendit nuk ka mundësi dhe s'ka pasur mundësi të jetë e njoftuar me kohë gjithnjë dhe shumë herë s'ka pasur as ftesa, as njoftime për të marrë pjesë në manifestime të tilla. Prandaj, do t'u sugjeroja organizatorëve që në rastet e tilla të bëjnë njoftime dhe ftesa zyrtare Kuvendit të Kosovës me qëllim që, kur planifikohet puna në Kuvend, të dihet dhe të shohim se a mund të marrim pjesë apo s'mund të marrim pjesë diku të gjithë. Është në nderin tonë që t'i respektojmë vërtet të gjithë ata që kanë rënë për lirinë e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni Ragip.

RAGIP ZEKOLLI – Unë edhe një herë vetëm desha të sqaroj që ajo çështje nuk është votuar me procedurë në Kuvend, mirëpo megjithatë është realizuar. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Vërejtjet e dhëna në transkript dhe në procesverbal do të korrigjohen.

Shkojmë më tutje. Pika e dytë e rendit të ditës

2. Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta. Në afatin e paraparë janë parashtruar 23 pyetje. Pyetjet të cilat nuk arrijnë të procedohen sot, do të radhiten në seancën tjetër. Nëse ato nuk marrin përgjigje në dy seanca, do të publikohen në Buletinin e Kuvendit.

Vazhdojmë me pyetjet. Deputeti Xhevat Bislimi ka pyetje për Kryeministrin Agim Çeku. Urdhëroni zoti Bislimi!

XHEVAT BISLIMI – Zoti Kryeministër, kjo pyetje ka kohë që është bërë, por herë kam munguar unë, herë keni munguar ju, kështu që ja sot u takuam. Çështja është për shtatoren e komandantit legjendar Adem Jashari. Zoti Kryeministër, komandanti legjendar Adem Jashari dhe familja e tij janë sinonim i luftës për liri, sinonim i heroizmit shqiptar dhe sinonim i atdhedashurisë jo vetëm për kombin shqiptar, por edhe për botën e qytetëruar dhe demokratike. Ju personalisht nuk keni lënë tubim pa e përmendur këtë të vërtetë të pakontestueshme. Më në fund, edhe Kryetari i LDK-së dhe njëherësh edhe Kryetar i Kosovës, Fatmir Sejdiu, shkoi në Prekaz dhe deklaroi botërisht se pa luftën se sakrificën e Adem Jasharit dhe të Jasharëve Kosova nuk do të ishte në prag të pavarësisë. Rreth 5 milionë njerëz janë përkulur me nderim para heroizmit dhe sakrificës legjendare të komandantit legjendar të UÇK-së dhe familjes Jashari. Megjithatë, edhe 8 vjet pas mbarimit të luftës antipushtuese çlirimtare të UÇK-së nuk është gjetur një copë tokë në zemër të Prishtinës për ta vendosur shtatoren e komandantit legjendar. Kur do ta përmbushni këtë dëshirë mbarëkombëtare dhe këtë detyrim ndaj vullnetit dhe lirisë së popullit shqiptar. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni, zoti Kryeministër!

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – I nderuari zoti Kryetar,
Të nderuar deputetë, ministra,
I nderuari Xhevat,

Unë vetëm në një seancë nuk kam qenë prezentë. Ajo ka qenë seanca që është shtyrë për sot, kështu që nuk kam munguar, por gjithmonë kam qenë i gatshëm të përgjigjem në çdo pyetje. Vetë fakti që edhe pas 8 vjetësh pas përfundimit të luftës ende në Prishtinë nuk e kemi shtatoren e komandantit tonë legjendar, Adem Jasharit, duhet të rendojë në ndërgjegjen e secilit prej nesh. Të gjithë kemi nga pak faj, edhe Qeveria që unë drejtoj, edhe qeveritë para nesh, edhe kuvendi komunal, por edhe shokët edhe bashkëluftëtarët e Adem Jasharit. Pranimi i një pjese të fajit nuk do të thotë se Qeveria të cilën e drejtoj nuk ka bërë asgjë për kategoritë e luftës, për dëshmorët, për t'i nderuar dëshmorët. Vetë keni qenë javën e kaluar në Junik ku Qeveria ka participuar gjithashtu edhe në ngritjen shumë e shumë shtatoreve, të përmendoreve etj. Ju e dini se Qeveri është duke i financuar dy komplekse memorialë: Kompleksin memorial “Adem Jashari” dhe Kompleksin memorial në Reçak.

Me sa unë kam kontaktuar Kuvendin komunal, kam kontaktuar shoqatat, është e vërtetë se shoqatat e dala nga lufta ia kanë bërë një kërkesë qysh në vitin 2003 kuvendit komunal për ndërtimin e shtatores së komandantit legjendar Adem Jashari në Prishtinë. Kuvendi komunal është duke trajtuar, e dini që me emrin Adem Jashari e ka emëruar sheshin në mes të këtij Kuvendi dhe Kuvendit komunal të Prishtinës, është marrë vendim që të ndërtohet shtatorja. Ne si Qeveri jemi zotuar që do të participojmë, do ta ndihmojmë Kuvendin komunal në ngritjen e kësaj shtatoreje, kështu që unë mbes me shpresë se Festën e ardhshme të Lirisë së Prishtinës do ta presim edhe me shtatoren e Adem Jasharit, por edhe me shtatore të tjera që i mungojnë, pa dyshim, Prishtinës dhe shumë qyteteve të tjera.

Unë dua me këtë rast t'i përgëzoj kuvendet komunale. Shumë kuvende komunale me iniciativë të vetat kanë ngritur shtatore edhe të komandantit legjendar Adem Jashari, por edhe të shumë e shumë dëshmorëve. E kemi p.sh. Skenderajn, e kemi Malishevën, shumë shpejt në Vushtrri do të zbulohet shtatorja Adem Jashari, kështu që është për të përshëndetur dhe është për të inkurajuar kuvendet komunale që të marrin këso iniciativash. Na mungojnë shtoret, na mungojnë monumentet. Thonë që një vend që nuk ka monumente, nuk ka as histori. Ne kemi histori dhe këtë histori duhet ta shënojmë dhe ta jetësojmë me figura të shquara të luftës sonë. Kështu, besoj që shumë shpejt do të fillojmë punimet dhe qëllimi është që Ditën e Çlirimit të Prishtinës në vitin 2008 ta presim edhe me shtatoren e Adem Jasharit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! I njëjti deputet ka prapë pyetje për Kryeministrin. Urdhëroni zoti Bislimi, ke hequr dorë. Mirë. Deputetja Gjylnaze Sylja ka pyetje për ministrin Dugolli. Urdhëroni, Gjylnaze Sylja!

GJYLNAZE SYLA – Ndërmarrjet shoqërore të cilat janë privatizuar me spinof special, pas nënshkrimit të kontratës kanë marrë obligimin për punësim dhe investim. Këto zotime janë, pra, pjesë e kontratës së privatizimit dhe janë të detyrueshme për

investitorin. Sipas raportit të fundit për monitorimin e implementimit të këtyre zotimeve, del në pah se investorët nuk janë duke i zbatuar zotimet e dhëna. Sipas Rregullores, ekziston ndëshkimi për moszbatim në bazë të gjobave ditore e deri në marrjen e serishme të ndërmarrjes nga AKM-ja.

Zoti ministër, cilat veprime i ka ndërmarrë Bordi i AKM-së që të sigurohet se kontratat për investime dhe punësim janë duke u zbatuar me përpikëri dhe pse nuk ka filluar gjobitja e personave që nuk u përmbahen zotimeve për investime dhe punësim? Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni zoti ministër!

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – Faleminderit, zoti Kryetar. Konsideroj se kjo pyetje është shumë e vjetruar. Unë në një mungesë që e kam pasur në seancë, e kam dërguar zëvendësin, por deputetja nuk ka pranuar që zëvendësi t’i përgjigjet. Sido të që jetë, raporti i fundit ka qenë në fund të vitit 2006, ku në disa ndërmarrje janë vërejtur disa ngecje në realizimin e punësimit dhe të investimeve. Por, si do që të jetë, nga ajo kohë kur ne i kemi iniciuar dhe i kemi bërë publik emrat e ndërmarrjeve që kanë pasur ngecje, ka vazhduar një dinamikë shumë e theksuar në plotësimin e zotimeve të spinofit special te punësimi dhe te investimet. Zhvillim pozitiv ka shënuar Ndërmarrja e Duhanit e privatizuar kohë më parë në Gjilan, ku ka arritur ta përmbush numrin e të punësuarve dhe ne e kemi vizituar bashkë me shefin e Shtyllës së Katërt, zotin Polagra. Po ashtu ka vazhduar të ketë zhvillime pozitive në punësim ndërmarrja “Kosovateks”, ndërsa ndërmarrja “LLamkos” është duke negociuar me investitorin tjetër Global Metal Stil, një investitor shumë i njohur në fushën e çelikut, dmth. investitori më i njohur në botë sa i përket kësaj veprimtarie, që t’i marrë obligimet në një periudhë shtesë do t’i jep AKM-ja. Pas përfundimit të procedurës së monitorimit, në rast se ndërmarrja nuk e ka përmbushur numrin e të punësuarve dhe numrin e investimeve, atëherë aplikohen, sipas rregullores, gjobat. Gjobat janë 3000 euro për të punësuar në vit, ndërsa 20 përqindëshi i mjeteve të mbetura pa investim është gjobë që në fund të periudhës së monitorimit do t’i vendoset kompanisë në fjalë që nuk i ka realizuar investimet. Deri më tash, d.m.th. gjobitja fillon nga koha kur përfundon monitorimi, numërohet si në punësim, si në investime. Për të gjitha ndërmarrjet ekziston një databazë që është pranë menaxhmentit të AKM-së, Drejtorisë për Mbikëqyrje të Spinofeve Speciale dhe në fund të monitorimit për secilën pas auditimit që do të bëhet në mënyrë të pavarur do të vërehet se kush është i gjobitur në ato fusha dhe kush i ka realizuar investimet. Bordi për specifika të caktuara ka qenë tolerant në disa raste për t’u dhënë afate në rast se mbi 90 përqind është realizuar investimi, si në rastin e Sillos-it dhe është dhënë mundësia edhe 3 muaj që ta realizojë edhe pjesën tjetër prej 3 milionësh, por sido që të jetë, nuk ka pasur shtyrje të tjera dhe gjobitjet tash llogariten në fund të monitorimit.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Ramadan Kelmendi i ka dy pyetje për zëvendëskryeministrin Haziri. Urdhëroni Ramadan!

RAMADAN KELMENDI- Ju faleminderit!

I nderuari Kryetar, i nderuari Kabinet Qeveritar, deputetë të pranishëm,

Me datën 21. 03.2007 kam parashtruar këtë pyetje për ministrin e Pushtetit Lokal: A ka ndërmarrë ndonjë veprim juridik Ministria e Pushtetit Lokal që me ndonjë udhëzim administrativ të ndikojë në drejtoritë kompetente të kuvendit komunal për mbrojtjen e të drejtave në punë të një numri të madh të punëtorëve të punësuar në sektorin privat, të cilët diskriminohen nga marrëdhënia e punës lidhur me orarin e punës, pushimin javor, ditor, mujor, si dhe pagat dhe puna pa kontratë, pa pushim vjetor, pa paga të rregullta dhe forma të tjera të diskriminimit. E them këtë ngase në qarkullim është Udhëzimi administrativ nr. 2007/03 i Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë, i cili ...(ndërprerje e parashtrimit të pyetjes).

KRYETARI KOLË BERISHA- Urdhëroni zoti zëvendëskryeministër!

LUTFI HAZIRI - Ju faleminderit zoti Kryetar,
Të nderuar deputetë, i nderuari deputet Kelmendi,

Duke iu referuar pyetjes suaj lidhur me veprimet që i ka ndërmarrë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat, ju njoftojmë: Rregullorja 2001/19 e ndryshuar me Rregulloren 2005/15, Shtojca e 14-të, cakton në mënyrë detaje përgjegjësitë dhe kompetencat e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Në asnjërën prej këtyre dispozitave Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk përcaktohet përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve që punojnë në sektorin privat. Në bazë të nenit 3 të Ligjit mbi Inspektoratin e Punës është përgjegjësi e Inspektoriatit të Punës që funksionon në kuadër të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale që të mbikëqyrë zbatimin e Ligjit të punës, të kushteve të punës dhe të mbrojtjes në punë. Në nivel lokal, kuvendi i komunës zgjedh inspektorët komunalë të cilët koordinojnë veprimet me autoritetet lokale në sferën e inspeksionit tatimor, të inspeksionit shëndetësor, të autoriteteve të tjera relevante, si dhe të policisë së Kosovës. Autoriteti i inspektorëve komunalë është që të inspektojë respektimin e normave dhe të standardeve që dalin nga ligjet dhe udhëzimet administrative në nivel qeveritar. Autoritetet lokale nuk kanë kompetenca rregullative në këtë fushë. Andaj, pyetjen tuaj do ta dërgojmë në adresë të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale në kuadër të se cilës ekzistojnë inspektoratet që mbulojnë këtë fushë dhe besojmë se do të ndikojmë në përmirësimin e këtij problemi në nivel lokal. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI KOLË BERISHA, a ka pyetje shtesë? Urdhëroni!

RAMADAN KELMENDI – Pikërisht nga ajo që u tha rezulton se ka disharmoni ndërmjet përgjigjes dhe Udhëzimit administrativ nr. 2007/o3 ngase neni 1 i kësaj dispozite thotë: Me këtë udhëzim administrativ përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës, ndërsa dispozita e nenit 6 thotë: Administrata lokale me akte të veçanta përcakton orarin e punës në shitoret me pakicë dhe shumicë sipas rasteve konkrete për të gjithë, prandaj kjo jep për të kuptuar se ka një disharmoni dhe inspektorët e punës nuk kanë qasje në mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës për shkak të këtij udhëzimi që është në kundërshtim me raportin që u cek. Ndërsa, pyetja e dytë po ashtu është e datës 17.04. 2007 dhe ka këtë përmbajtje: Çka ka ndërmarrë Ministria e Pushtetit Lokal që pranë çdo kuvendi komunal të Kosovës të sigurojë funksionimin e zyrës së deputetit,

gjegjësisht të deputetëve në komuna në mënyrë që t'u mundësohet që punën e tyre ta kryejnë me cilësi dhe përmbajtje. Përkundër kërkesave të shumta...

KRYETARI KOLË BERISHA-Ju faleminderit! Zoti zëvendëskryeministër.

LUTFI HAZIRI – Ju faleminderit, zoti Kryetar,

Në bazë të legjislacionit në fuqi, misioni i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është që ta avancojë vetëqeverisjen lokale në harmoni me parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. Në këtë drejtim, Ministria është përgjegjëse që t'i sigurojë pushtetit lokal që duke vepruar brenda kornizës ligjore të rregullojë dhe menaxhojë në mënyrë vetanake një pjesë substanciale të çështjeve që kanë të bëjnë me pronat dhe administratën me interes të popullatës lokale. Prandaj, Ministria jonë është shumë e vendosur që pushteti komunal t'i kushtojë rëndësi informimit, konsultimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Në këtë aspekt kemi qenë shumë aktiv që Ministria përmes Udhëzimit administrativ 2006/03 mbi transparencën e komunave të këshillojë dhe kërkojë që administrata lokale të punojë konform kërkesave në zbatim të ligjit.

Ne gjithashtu punojmë në drejtim të avancimit të bashkëpunimit të komunave me fshatra, vendbanime dhe lagje për të cilat komunat e kanë të drejtën ta rregullojnë këtë çështje përmes rregulloreve komunale. Sa i përket çështjes kryesore të koordinimit dhe të angazhimeve që kanë të bëjnë me deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe përfaqësuesit e popullatës, në këtë drejtim ne mendojmë se ka ngecje jo vetëm për arsye se pushteti lokal nuk e ka këtë të drejtë, por për arsye të mungesës së kushteve, të mungesës së objekteve dhe të mundësive që pushteti lokal t'u ofrojë zyre dhe kushte të punës anëtarëve të kuvendeve komunale që vijnë nga komunat e ndryshme të Kosovës. Megjithatë, do të angazhohemi që në konsultim të ngushtë me asamblatë komunale të kërkojmë që të rregullohet kjo çështje dhe të ofrohen mundësi më të mira në mënyrë që hallka e koordinimit dhe e bashkëpunimit ndërmjet kuvendit komunal dhe deputetëve të Kuvendit të Kosovës në nivel komunal të koordinohet më mirë. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Keni pyetje shtesë, jo. Deputeti Xhevat Bislimi ka pyetje për Kryeministrin Çeku.

XHEVAT BISLIMI – Zoti Kryeministër, edhe 8 vjet pas lufte, Kosova vazhdon të jetojë me errësirë dhe në errësirë, sepse Qeveria juaj nuk ishte dhe nuk është e zonja të përmbush detyrimin njerëzor, politik dhe ligjor ndaj qytetarëve të Kosovës. Dëmet që Qeveria juaj dhe KEK-u po i shkaktoni çdo familjeje dhe krejt Kosovës është i shumëfishtë dhe i pallogaritshëm. Në vend se të jepni llogari dhe ta kompensoni qytetarin tonë për këto dëme, ju po vazhdoni ta gjobitni atë. Njëherë keni imponuar taksën për RTK-në që askush nuk është i detyruar ta paguaj, kurse tash po i kushtëzoni qytetarët me regjistrimin e automjeteve të tyre. Pyetje: A keni ndërmarrë ju personalisht diçka për ta penguar këtë arbitraritet dhe këto veprime antiligjore dhe antinjerëzore ndaj qytetarëve tanë? Ju faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISH – Faleminderit! Urdhëroni zoti Kryeministër!

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Po, unë fillimisht do të them që nuk pajtohem plotësisht me konstatimin e thënë se Kosova edhe 8 vjet pas luftës vazhdon të jetojë në errësirë. Kjo Qeveri së pari nuk është që 8 vjet në pushtet, ka pasur Qeveri edhe përpara dhe ka qenë situata shumë, shumë më e vështirë dhe jemi dëshmitarë se situata ende është problematike me furnizim me rrymë, por gjithnjë është në përmirësim e sipër. Edhe këtë dimër që e kaluam, edhe pse ka qenë më i butë, do me thanë, nuk kemi pasur pengesa të shumta. Edhe tani në këtë kohë të nxehtë ka shpenzime të shumta të energjisë elektrike, por furnizimi me energji elektrike është i shumtë.

Një ndër problemet për ta përmirësuar furnizimin me energji elektrike është pagesa e faturave, apo pagesa e rrymës nga qytetarët e Kosovës. Ne kemi shumë konsideratë për kategoritë e caktuara të cilat nuk mund ta paguajnë rrymën dhe Qeveria e paguan në emër të tyre. Janë disa kategori, e dini për lagjen në Podujevë, ka edhe kategori të tjera për të cilat Qeveria i kompenson këto shpenzime të energjisë elektrike. Por, ka shumë qytetarë që nuk janë duke paguar rrymën. Jeni dëshmitarë që këto ditë ka shkyçje të bizneseve dhe të konsumatorëve të ndryshëm që nuk po e paguajnë rrymën dhe për këtë ne kemi formuar një task-forcë apo grup të detyrës që të rritet inkasomi, ta ndihmojmë KEK-un si Qeveri në rritjen e inkasimit dhe si Qeveri kemi marrë një vendim që të gjitha Ministrinë ta ndihmojmë KEK-un dhe Ministrinë e Energjisë dhe të Minierave që të rritet inkasimi. Një ndër masat që është propozuar dhe është marrë është që të kushtëzohet regjistrimi i automjetit me dëshmi për faturën për pagimin e rrymës, sepse konsiderojmë se pagesa e rrymës është nevojë elementare e çdo qytetari apo rryma është nevojë elementare, kurse automjeti ende konsiderohet një luks për qytetarë apo për familje, kështu që së pari duhet t'i plotësojmë kërkesat elementare, e atëherë të kalojmë dhe t'i plotësojmë kërkesat e tjera.

Ne kemi marrë reagime të ndryshme lidhur me këtë Memorandum të Mirëkuptimit mes dy ministrive, ka reaguar edhe Ombdus personi, më ka dhënë detyrë personalisht se çka kam ndërmarrë personalisht, i ka dhënë detyrë Zyrës ligjore ta shqyrtojë këtë masë se a ka bazë ligjore për një gjë të tillë. Vendimi është i përkohshëm, do ta shqyrtojmë, por ajo çka mund të them është që ka rritje të madhe të inkasimit pas hyrjes në fuqi të këtij memorandumi.

Dhe unë mendoj që ndonjëherë edhe si opozitë, por edhe si deputetë duhet gjithë ta ngrisim zërin ndaj mospagimit të rrymës dhe t'u bëjmë thirrje qytetarëve të Kosovës që ta paguajnë rrymën. Është mënyra më e mirë, jo e vetmja, po njëra prej tyre për t'u përmirësuar furnizimi me rrymë. Por, duhet të pajtohem, do ta shqyrtojmë bazën ligjore të këtij memorandumi, duhet pajtohem që edhe mospagimi i rrymës është veprim joligjor. Me ligj, çfarëdo ligji të merrni, duhet të paguhet rryma dhe unë u bëj ftesë qytetarëve që ta paguajnë rrymën, t'i përmbushin obligimet ndaj shtetit, atëherë shteti do t'i kthejë këto në shërbime cilësore.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Ka pyetje shtesë? Urdhëroni, zoti Bislimi!

XHEVAT BISLIMI – Zoti Kryeministër, unë mendoj se qytetarët po e paguajnë shumëfish rrymën dhe mungesën e rrymës, madje edhe nëpërmjet Buxhetit të Kosovës edhe ajo pagesa nga qytetarët. Por, ju duhet të jepni shpjegim kush përgjigjet për 54% të

rrymës së humbur që nuk faturohet fare, a ka faj qytetari, apo kanë faj ata që menaxhojnë KEK-un, një, dhe dy, unë kërkoj kur do ta bëni Komisionin për hulumtimin e dëmeve që KEK-u ua ka shkaktuar qytetarëve të Kosovës? Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Zoti Kryeministër.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Nuk i ikim përgjegjësisë si Qeveri as si Ministri, por duhet ta dimë prapë se KEK-u është ende si ndërmarrje publike, është nën autoritetin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, por prapë e kemi edhe ne Qeverinë që është edhe tani ministri jonë është edhe kryetar i Bordit. Jemi përgjegjës edhe ne. Ju e dini që Bordi tani ka filluar me marrjen e disa masave me qëllim të përmirësimit të menaxhmentit në KEK dhe besoj që këto masa të nevojshme do të vazhdojnë të merren dhe do të sjellin përmirësim. Por, janë përgjegjës edhe qytetarët. Edhe qytetarët keqpërdorin rrymën, kyçen në mënyrë ilegale dhe nuk e respektojnë ligjin. Qeveria i ka instrumentet e veta për implemtimin e ligjit, kemi Ministrinë e Punëve të Brendshme, SHPK-në dhe menaxhmentin e KEK-ut. Me siguri bordi e ka marrë shumë seriozisht, e ka detyrë edhe nga Qeveria që të merret seriozisht me përmirësimin e inkasimit dhe të kërkojë përgjegjësi prej atyre, nga keqmenaxhimi i të cilëve kanë pasoja edhe qytetarët. Besoj që Bordi do ta ndërmerr një veprim konkret, do të jemi dëshmitarë të këtyre veprimeve dhe besoj që do të kemi përmirësim në furnizim dhe do t'i ndalojmë humbjet, vjedhjet e energjisë elektrike.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputetja Hatixhe Hoxha ka pyetje për ministrin Bujar Dugolli.

HATXHE HOXHA – Zoti ministër, kohëve të fundit në masmedia po qarkullon lajmi se në Kosovë po hynë armaturë me radioaktivitet në shkallë të lartë. A jeni në dijeni ju si ministër se metalet me origjinë të dyshimtë apo produkte me origjinë apo kualitet joadekuat po hyjnë në Kosovë dhe çfarë keni ndërmarrë në parandalimin e tyre?

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni ministër!

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – Faleminderit për pyetjen. Po, me të marrë pyetjen e juaj kam kontaktuar me Shërbimin Doganor të Kosovës për t'i pyetur rreth mundësisë së këtyre informacioneve dhe çka kanë ata në të vërtetë prej këtyre informacioneve. Shërbimi Doganor i Kosovës posedon aparaturën për kontrollimin dhe matjen e radioaktivitetit të mallrave që futen në Kosovë. Shërbimi Doganor i Kosovës nuk ka asnjë fakt lidhur me këto mallra që ju konstatojnë, përkundrazi ne i cilësojmë ato vetëm si shkrime të mediave që për natyrë të ndryshme kanë mund t'i bëjnë për të penguar afarizmin e ndonjë ndërmarrjeje. Por, sido që të jetë, mediat nuk posedojnë aparaturë për matjen e radioaktivitetit, por doganat, dhe ne u besojmë doganave që nuk ka një gjë të tillë. Përkundrazi, Ministria është duke bërë hapa që të kontrollojë të gjitha mallrat që importohen në Kosovë dhe për ta është duke kontaktuar dhe formësuar laboratorë të ndryshëm që do të vërtetojnë kualitetin dhe qëndrueshmërinë edhe të materialeve ndërtimore. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Keni pyetje shtesë, urdhëroni!

HATIXHE HOXHA – Sipas disa informacioneve, në regjion po qarkullojnë këto produkte me kualitet joadekuat, në disa tregje në Bullgari dhe Serbi po vërehen këto produkte. Prandaj, mendojmë se për këto mallra në kufi duhet të kërkohen përveç certifikatës së origjinës dhe të kualitetit, duhet të shihet edhe të matet edhe radioaktiviteti. Ne kemi pasur si Komision Parlamentar disa vizita edhe në dogana. Mua më intereson se sa jeni në dijeni ju se sa në dogana disponojnë me këto pajisje për matjen e radioaktivitetit?

KRYETARI KOLË BERISHA – Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – Unë thashë, Dogana posedon aparaturën për matjen e radioaktivitetit. Ata e kanë pohuar këtë dhe bëjnë matjen kur ka dyshime tilla, por deri më tash nuk janë konstatuar kurrfarë faktesh që ju i ngritni. Përndryshe, çështjet e konformitetit të aspekteve të tjera është mirë që Kuvendi ka miratuar Ligjin për konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe të gjitha këto jemi duke i zbatuar edhe me akte nënligjore, edhe me grupe punuese në nivel ekspertësh për t'i vlerësuar materialet e ndërtimit. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputetja Safete Hadrgjonaj ka pyetje për Kryeministrin Agim Çeku.

SAFETE HADRIGJONAJ – Faleminderit zoti Kryetar, Falënderoj zotin Kryeministër që, më në fund, është i gatshëm të më japë përgjigje në pyetjen, të cilën e kam bërë ditë më parë. Gjatë tremujorit të parë të këtij viti, bazuar në raportin e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave lidhur me pasqyrat financiare vërehet se suficiti buxhetor gjatë tremujorit të parë të këtij viti ka qenë 114 milion euro,. Kuptohet, 75 milion euro kanë qenë të hyra nga licenca e Telefonisë së Dytë Mobile, kurse 39 milion euro të hyra nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana. Pyetja ime është kjo: A ka Qeveria plane për të vënë në funksion këtë suficit buxhetor?

KRYETARI KOLË BERISHA – Zoti Kryeministër.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Unë këtë pyetje herën e parë ia kam deleguar ministrit të Ekonomisë dhe të Financave, por pasi që as ai nuk është sot këtu në këtë seancë, do të përgjigjem unë. Sipas raportit të monitorimit fiskal për tremujorin e parë të vitit 2007 ku pasqyrohen të hyrat dhe shpenzimet e mbledhura, kemi një rrjedhë më të lartë të të hyrave se shpenzimet. Kjo rrjedhë më e lartë e të hyrave sesa shpenzimet që ka ndodhur është normale, posaçërisht kur në këtë periudhë janë inkasuar të hyrat nga licenca e Telefonisë së Dytë Mobile në shumën prej 75 milion eurosh dhe posaçërisht në këtë periudhë, për shkak të procedurave të tenderimit, nuk fillojnë ende investimet kapitale. Gjatë vitit fiskal në periudhë të caktuar kohore shpenzimet janë më të ulëta sesa të hyrat, por në periudha të tjera kohore shpenzimet janë më të larta se sa të hyrat. Kjo është një dinamikë enormale.

Pra, në këtë rast, sipas praktikave buxhetore nuk mund të flasim për suficit buxhetor, pasi që bilanci buxhetor bëhet në fund të vitit fiskal. Po ju përkujtoj se për vitin 2007 Buxheti ka planifikuar shpenzimet prej 717.4 milion eurosh në një projeksion të të hyrave prej 656 milion eurosh. Në këtë projeksion të të hyrave ishin planifikuar rreth 20 milion

si të hyra nga licenca e operatorit të Telefonisë së Dytë Mobile. Megjithatë, është mirë që kemi realizuar 75 milion, d.m.th. 55 milion më shumë sesa kemi planifikuar. Kjo e bën që Qeveria e Kosovës këto mjete dhe mjetet e bartura nga vitet paraprake t'i përdorë për të mbuluar nevojat e reja pas statusit, siç është krijimi i ministrive të reja, të institucioneve të reja dhe shpenzimet që dalin nga bartja e përgjegjësisë nga UNMIK-u te Qeveria e Kosovës. Dëshiroj të theksoj se në vitin 2008 ne kemi projektuar një rritje të ndjeshme të shpenzimeve buxhetore nga 717 milion në këtë vit, në rreth 850 milion në vitin tjetër. Në bazë të planifikimeve, në vitin 2008 do të kemi një deficit buxhetor prej rreth 90 milion euro për të hyra, që do të mbulohej nga të hyrat e operatorit të Telefonisë së Dytë Mobile dhe suficitet e bartura nga vitet e kaluara. Projektione të tilla të shpenzimeve janë bërë edhe për vitin 2009 – 2010, të cilat, po ashtu, tregojnë një deficit buxhetor, i cili duhet të mbulohej po nga burimet e njëjta dhe nga mbështetja e donatorëve të cilën e kanë premtuar dhe presim që ta përmbushin. Faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! A ka pyetje shtesë deputetja? Po. Deputetja Safete Hadrgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADRGJONAJ – Nga përgjigja e zotit Kryeministër po vërejmë se Qeveria e Kosovës nuk ka prioritetet të caktuara se ku do të bëjë investimin e mjeteve dhe kjo është një diçka shumë e natyrshme me qenë se kjo Qeveri punon pa strategjinë zhvillimore, kështu që bënë investime ad-hoc aty ku të mundet, prandaj edhe kemi një gjendje të tillë të zhvillimit ekonomik tepër të ulët. Megjithatë, Qeveria asnjëherë nuk ka qenë transparente ndaj Kuvendit që t'i paraqet se ku i ka bërë investimet e suficitit buxhetor të vitit 2006 dhe njëkohësisht nuk është transparente as në shpjegimin e çështjes se ku po investohen mjetet e suficitit të vitit 2007. Nëse këto mjete kanë mbetur të bllokuara, siç e paraqiti zoti Kryeministër, që t'i mbulojmë deficitet e viteve të ardhshme, apo t'i ruajmë për vitet e ardhshme kur të shpallet pavarësia e Kosovës, unë dua t'i them zotit Kryeministër se sigurisht e kupton çka do të thotë kur mjetet mbesin në arkë të pashfrytëzuara.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Mjetet e pashfrytëzuara janë mjetet tona dhe mbesin në arkë. Arka është e jona dhe përdoren, me siguri do të përdoren për projekte të ndryshe, kështu që nuk janë të humbura, nuk humben. Kështu, sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike, të gjitha të hyrat derdhen në një vend, të gjitha të hyrat derdhen në një vend pa marrë parasysh a janë nga telefonia mobile, a janë nga taksat rrugore, a janë nga doganat. Të gjitha të hyrat hyjnë në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe nga buxheti financohen të gjitha kërkesat dhe shpenzimet. Kështu, nuk mund t'i trajtojmë të hyrat nga telefonia mobile si një fond i veçantë dhe të menaxhojmë me ato mjete si të tilla, por janë pjesë e buxhetit dhe menaxhohen në bazë të kërkesave të buxhetit. Ne thamë që kemi projektuar që 665 milion do t'i kemi të hyra vitin e ardhshëm, kurse buxhetin e kemi projektuar 850 milion, kështu që ka një rritje nga këto mjete dhe ka rritje nga suficiti i vitit të përparshëm.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zoti Kryeministër. Pyetja e 6-të, deputeti Fetah Berishaka pyetje për Kryeministrin Agim Çeku. Fetah Berisha, e ka fjalën.

FETAH BERISHA - Ju faleminderit, zoti Kryesues!
I nderuari zoti Kryeministër,

Ju me vendim caktuat Ministrinë e Shërbimeve Publike që të hartojë Projektligjin për Memorialin e Kryetarit dr. Ibrahim Rugova dhe për statusin e familjes. Po ashtu, Qeveria e Kosovës më 13.9.2006 mori vendim për ta proceduar këtë Projektligj në Kuvendin e Kosovës dhe i njëjti të miratohet. Natyrisht, hartimi i Projektligjit për Memorialin e Kryetarit doktor Ibrahim Rugova dhe statusin e familjes ka mbështetje edhe në Kornizën Kushtetuese. Edhe sekretari i juaj i përhershëm, zoti Fitim Krasniqi, ia konfirmoi sekretarit të Kuvendit se Zyra e Kryeministrit paraqet Projektligjin për Memorialin e Kryetarit dr. Ibrahim Rugova dhe statusin e familjes nr. 2006/20 me memorandum shpjegues, për procedim në Kuvend. Edhe deklarata e AIS konfirmon se ky Projektligj nuk është në kundërshtim me politikat dhe ...

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Zoti Kryeministër.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU - Ne kemi tërhequr këtë Projektligj edhe tërheqja ka qenë e përkohshme dhe si e tillë mbetet. Arsyeja ka qenë që të ripunohet kostoja financiare, sepse është vlerësuar se ka një kosto shumë të lartë dhe ka një kosto të papërbalueshme. Për ta shqyrtuar koston financiare është formuar një grup punues nga Qeveria. Fillimisht kryesuesi i këtij grupi ka qenë nga Ministria e Shërbimeve Publike, kurse më vonë me kërkesë të kësaj Ministrie e kemi ndërruar edhe kryesuesin e këtij grupi punues për të ripunuar koston financiare i cili tani është nga Zyra e Kryeministrit. Kështu, grupi punues gjatë muajit qershor i ka pasur tri takime dhe janë duke i harmonizuar me Ministrinë e Financave implikimet buxhetore për implementimin e këtij ligji. Gjithashtu, në Qeveri lidhur me këtë ligj kemi formuar Komisionin për hartimin, përgatitjen, menaxhimin dhe administrimin e procedurave për konkursin publik për Memorialin e Presidentit të ndjerë Ibrahim Rugova, ku do të përfshihen përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit, Presidenca, Ministria e Shërbimeve Publike, Ministra e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjeve Jorezidente dhe Kuvendi Komunal i Prishtinës, Universiteti i Prishtinës. Obligimi i këtij Komisioni është konsultimi i ngushtë edhe me familjen e Presidentit Rugova që të hartohet dhe të përgatitet tenderi publik për ndërtimin e këtij kompleksi memorial “Ibrahim Rugova”.

Dy, tri javë më herët Qeveria ka marrë këtë vendim dhe ky Komision është në formim e sipër dhe shumë shpejt, posa të kemi edhe koston financiare, ky komision do ta ndihmojë koston financiare pasi t’i bëjë procedurat e menaxhimit, të administrimit të këtij kompleksi. Ligji, pra, prapë do të vijë në këtë Parlament. Por, është duke u zhvilluar edhe një debat rreth këtij ligji, që ligji të ndahet në dy ligje, ashtu është propozuar. Një ligj të jetë Ligji për Kompleksin memorial “Ibrahim Rugova”, kurse tjetri të jetë Ligji për Presidentin e Kosovës, do me thënë presidentin aktual dhe të drejtat e obligimet e tij, të familjes së tij gjatë mandatit dhe pas mandatit, apo pas mandati që i skadon në mënyrë të rregullt demokratike ose pas vdekjes. Por, ende është duke u zhvilluar debati, ka zëra që e mbështesin këtë qasje, ka edhe kundër, po sidoqoftë ne jemi duke debatuar, ligji nuk është harruar dhe besoj që shumë shpejt do të vijë këtu para jush.

KRYESUESI NAIM MALOKU – A ka pyetje shtesë. Urdhëro!

FETAH BERISHA – Zoti Kryeministër, Ju nuk i baskët llogaritur punët mirë kur e keni paraqitur këtë ligji për procedim në Kuvendin e Kosovës. Tani na dolën shumë punë këtu. Po, meqë kemi të bëjmë me një personalitet shumë të merituar për Kosovën, atëherë kur e parashihni ju që do ta paraqitni këtë projektligj për procedim para këtij Kuvendi. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – A ka përgjigje? Urdhëroni zoti Kryeministër!

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Zëvendëskryeministri është caktuar nga unë, nga Qeveria, që të koordinojë me të gjitha këto ministri dhe të gjitha këto komisione. Nuk mund të jap datë, por jemi duke punuar në këtë drejtim dhe besoj që në një afat të shkurtër do ta sjellim këtë ligj.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Pyetja numër 7. Deputetja Hatixhe Hoxha ka pyetje për ministrin Agim Veliu. Deputetja Hatixhe Hoxha e ka fjalën.

HATIXHE HOXHA – Duke pasur parasysh, zoti ministër, Memorandumin e mirëkuptimit, në janar të vitit 2007 në mes të Universitetit të Prishtinës, Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë, Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale për lirimin e ndërtesës së re të Fakultetit Ekonomik që gjendet në kompleksin e Universitetit të Prishtinës, duke pasur parasysh faktin se Universiteti po përballet, ndër të tjera, edhe me mundësinë e mungesës së hapësirave, atëherë shtroj pyetjen për ju, zoti ministër: Çka keni bërë që të përshpejtohet puna që viti i ri akademik të fillojë në ndërtesën e re të Fakultetit Ekonomik?

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ministri Veliu e ka fjalën.

MINISTRI AGIM VELIU – I nderuari kryesues,
I nderuar Kryeministër,
Të nderuar deputetë, zonja Hoxha,

Pyetja lidhur me Memorandumin e nënshkruar në mes të UP-së, Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë dhe Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale për lirimin e objekteve që aktualisht i shfrytëzon më shumë u adresohet subjekteve nënshkruese të marrëveshjes së janarit 2007. MASHT ka mirëpritur këtë Memorandum mirëkuptimi, por dua t'ju them se mungesa e hapësirës në UP është një sfidë e vazhdueshme që po pamundëson rritjen e numrit të studentëve dhe shumë maturantëve po u zvogëlon mundësinë për studime. Në mungesë të hapësirës, Qeveria e Kosovës shfrytëzon objektin e Universitetit të Prishtinës për nevojat e Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë dhe të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale. Planet janë që ky objekt të përdoret për nevojat e Universitetit të Prishtinës dhe Memorandumi i mirëkuptimit nënkupton se këto dy ministri do t'i përdorin këto objekte derisa të mbarojnë procedurat për sigurimin e objektit tjetër për punë. Këto procedura besoj se do të përfundojnë në shtator.

Në strategjinë për arsimin e lartë në Kosovë, Ministria e Arsimit ka një qasje të qartë sa i përket rritjes së hapësirës fizike në arsimin e lartë për të absorbuar numrin e madh të

maturantëve që kryejnë arsimin e mesëm, për çka është llogaritur edhe kostoja për investime kapitale.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! A ka pyetje shtesë? Deputetja Hatixhe Hoxha e ka fjalën.

HATIXHE HOXHA – Zoti ministër, në Memorandumin e mirëkuptimit në mes të dy ministrive edhe Universitetit të Prishtinës nuk është e prezicuar koha se kur këto dy ministri janë të obliguara t’ia lëshojnë ndërtesën Universitetit të Prishtinës, gjegjësisht Fakultetit të Arteve. Prandaj, mendoj se do të duhej të përcaktohej koha precize, sepse e dimë në bazë të praktikave se nëse nuk ka një afat të caktuar, e dimë se zakonisht ajo shtyhet e shtyhet.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! A ka koment nga ministri, përgjigje? Ministri e ka fjalën.

MINISTRI AGIM VELIU – Unë e thashë që kjo çështje është në procedurë. Në bazë të informacioneve që kam dhe të rrjedhës së procedurave, kjo çështje do të përfundojë në shtator të këtij viti.

KRYESUESI NAIM MALOKU –Ju faleminderit, zoti ministër! Pyetja e 8-të, deputeti Emrush Xhemajli ka pyetje për ministrin Jonuz Salihu. Për shkak se ministri mungon, kjo pyetje bartet për seancën e ardhshme. Nëse ka nevojë, deputeti ta parashtrojë pyetjen, nëse dëshiron. Deputeti Emrush Xhejamli e ka fjalën.

EMRUSH XHEMAJLI – Faleminderit! Unë pyetjen do ta lexoj çdo seancë derisa të vijë ministri. Përshëndetje të gjithëve. I respektuari ministër, përveç që jeni ministër, ju jeni edhe anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor të Kosovës. Brengë e shumë qytetarëve që kanë punë me drejtësinë është jo vetëm puna e ngadalshme e gjykatave, por edhe pasi lëndët e marrin formën përfundimtare, vendimet nuk ekzekutohen. Pyetja ime është kështu: Pse edhe pas përfundimit të lëndëve, ato nuk përmbahen, përkatësisht nuk ekzekutohen. Konkretisht, pse është gjendja kështu dhe çka jeni duke ndërmarrë që të përmirësohet sistemi gjyqësor në këtë drejtim? Faleminderit, mund të përgjigjet edhe zëvendësi i tij, s’ka problem.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Me Rregullore ju keni kërkuar ministrin dhe ministri do të përgjigjet.

Pyetja e 9-të, deputeti Mazllom Kumnova ka pyetje për ministrin Agim Veliu. Deputeti Mazllom Kumnova e ka fjalën.

MAZLLOM KUMNOVA – Zoti ministër, duke u nisur nga ajo që në vitin shkollor 2007/2008 përmbillet reforma në shkollat fillore, për herë të parë edhe në klasët e pesta, aktualisht ka shqetësime se nga kjo reformë një numër i konsiderueshëm i arsimtarëve të ciklit të lartë të shkollës fillore do të largohen nga puna. Pyetja: Sa janë bërë përgatitjet nga Ministria e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë për të filluar mbarë vitin shkollor 2007/2008 në klasën e pestë me të gjitha këto probleme.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Ministri Veliu e ka fjalën.

MINISTRI AGIM VELIU – Faleminderit! Në ndryshimet që ndodhën në periudhën e pasluftës në Arsimin e Kosovës, në harmoni me Ligjin e arsimit fillor dhe të mesëm dhe të Kornizës së Kurikut të ri të Kosovës, Libri i Bardhë, është miratuar edhe struktura e re e arsimit parauniversitar, neni 6.1. i Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm të Kosovës. Në bazë të Ligjit, arsimi fillor është nga klasa I deri V. Kjo strukturë e re konsiston me sistemet më të përparuara në shumicën e vendeve evropiane. Marrja e vendimit nga Ministria e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë për implementimin e klasës së pestë shënon përmbylljen e reformës në sistemin e arsimit para universitar të vendit. Klasa e pestë në strukturën e re të arsimit para universitar të Kosovës është vazhdimësi e klasës së katërt.

Këtë vit shkollor 2007/2008, në klasën e pestë do të fillojë mësimi me plan-programet dhe tekstet e reja shkollore, të cilat janë përgatitur nga Ministria e Arsimit. Për organizimin e mësimi në klasën e pestë MASHT ka nxjerrë Udhëzimin administrativ nr. 12/2007 të datës 25. 6. 2007. Sipas neni 5 të këtij Udhëzimi administrativ, mësues klasor i kualifikuar është kandidati i cili i ka të mbaruar njërin prej profileve arsimore në vijim: Fakultetin e Edukimit, Fakultetin e Mësuesisë, Shkollën e Lartë Pedagogjike, mësimi klasor, Fakultetin Filozofik - Degën e Pedagogjisë dhe Shkollën Normale. Mësimdhënësit të cilët kanë mbajtur orë vetën në klasën e pestë dhe mbeten pa orë fare në vitin shkollor 2007/2008, do të sistemohen sipas këtyre kriterëve: Kandidati i cili posedon njërin nga kualifikimet e lartshënuara do të mbetet mësues klasor, kandidatët e tjerë do të konkurrojnë në konkursin i cili do të shpallet në gusht të vitit 2007 dhe në kushte të barabarta përparësi kanë arsimtarët të cilët paraprakisht kanë punuar me klasë të pesta, neni 8 i Udhëzimit Administrativ.

Drejtoria komunale e Arsimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit do t'i sistemojë këta arsimtarë në atë shkollë apo në shkolla të tjera të komunës përkatëse, në shkolla të mesme të ulëta dhe në shkolla të mesme të larta, varësisht nga kualifikimi. Ministria e Arsimit me këtë hap realizon zbatimin e Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm, neni 6.1., përmbyll ciklin e reformave që e bëjnë arsimin e Kosovës të jetë i krahasueshëm me vendet evropëroëndimore si dhe krijon kushte për implementimin e strategjisë zhvillimore të arsimit parauniversitar 2007/2017, e cila është miratuar nga Qeveria e vendit.

Ministria e Arsimit mbetet në dispozicionin tuaj dhe të opinionit publik për të dhënë sqarime të tjera të nevojshme për zbatimin e Ligjit për përmbylljen e reformës si dhe për ecjen në kahet zhvillimore arsimore të vendit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zoti ministër! Pyetje shtesë? Deputeti Mazllom Kumonva e ka fjalën.

MAZLLOM KUMONVA – Unë e kam në dorë, zoti ministër, Udhëzimin që e keni firmosur ju më 26 qershor. Sipas këtij neni 2, udhëheqja e klasës së pesë, thuhet: Klasën e pestë e udhëheq mësuesi, i cili ka përgatitje profesionale për mësimdhënës në shkollën fillore. Ndërsa menjëherë neni 3 thotë: Mësuesi i klasës së parë në vitin shkollor 2007 /2008 klasën e parë do ta udhëheqë mësuesi, i cili në vitin shkollor 2006/2007 ka mbaruar mësimin në klasën e katërt. Sipas kësaj, do të thotë që do të hapen vende të reja për

klasën e pestë. Çfarë do të bëhet me arsimtarët, rreth 25% të fondit të orëve janë të klasës së pestë, a duhet të largohen këtë nga puna? Nëse largohen, të gjithë kanë të drejtë që ta fitojnë në gjykatë vendin e punës.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Zoti ministër, a keni përgjigje në këtë pyetje? Ju faleminderit!

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës të Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta, e 50 minuta kanë kaluar.

Të nderuar deputetë,

Në pajtim me Rregullën 61 të Rregullores së punës - Shmangiet nga Rregullorja e Punës, citoj: “Për shmangiet nga Rregullorja e Punës mund të vendos Kuvendi me 2/3 e shumicës së deputetëve të pranishëm në Kuvend”. A doni të vazhdojmë pasi që janë këtu kryeministri dhe ministrat. I kemi kaluar deri më tash 10 pyetje, janë edhe 12 pyetje. Lus deputetët që të deklarojnë, kush është për vazhdimin, pra për Rregullën 61 - Shmangie nga Rregullorja e Punës. Kërkohen 2/3 e deputetëve të pranishëm, ose deklaram të shfave të grupeve parlamentare. Unë jam i detyruar të punoj sipas Rregullores. Alush Gashi.

ALUSH GASHI – Faleminderit, zoti kryesues! Ne nuk shohim arsye të posaçme që t’i shmangemi Rregullores së Punës dhe ta përdorim forcën e votës në Kuvend. Andaj, presim që ju do të vazhdoni sipas rendit të paraparë të ditës, i cili është përgatitur në Kryesinë e Kuvendit me shfat e grupeve dhe është miratuar në fillim të seancës. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI NAIM MALOKU- Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka Sala Ahmetaj lidhur me çështjen që e shtrova.

SALA AHMETAJ – Kërkoj falje që dola këtu, por unë nuk e di mënyrën se si i procedoni pyetjet. Unë kam bërë tri pyetje. Një për kryeministrin dhe dy të tjera për ministra. Pyetja për kryeministrin, të cilën e kam bërë më 20.7 është e një rëndësie të veçantë. Ndoshta për këtë pyetje, të cilën e kam bërë, do të duhej të jepej përgjigja shumë shpejtë, ose do të duhej të reagoje Qeveria, pa e bërë pyetjen unë fare. Mendoj se edhe në Kuvend disa pyetje që janë më urgjente do të duhej të shtroheshin, kurse pyetjet e tjera nuk është e domosdoshme që të shtrohen menjëherë. Mendoj se në pyetjen e parë sot do të duhej të më përgjigjej kryeministri. Ju lus për mirëkuptim.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zonja deputete. Radhitja e pyetjeve është bërë sipas kohës së parashtrimit dhe nuk është e parashikuar se ka pyetje urgjente. Pra, ne flasim për vazhdimin ose jo të kësaj pike të rendit të ditës. Dëgjuam deputetin Alush Gashi, shef i Grupit Parlamentar të LDK-së. A ka shefa të tjerë të grupeve parlamentare? Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit, zoti kryesues! Grupi Parlamentar i Aleancës konsideron se duhet të vazhdojmë më tej me pikat e rendit të ditës, sipas radhës. Ju faleminderit!

KRKYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Konsideroj se nuk ka nevojë të hidhet në votim, Rregulla 61 -Shmangia nga Rregullorja e punës. Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës. Zonja deputete, ne kemi kaluar në pikën e tretë të rendit të ditës. Unë e pranoj si shkelje të procedurës sime. Keni të drejtë ta lexoni pyetjen. Urdhëroni!

SALA AHMETAJ - I nderuari kryesues. Të falënderoj për mundësinë që ma dhatë. I nderuari Kryeministër, të nderuar ministra dhe ju deputetë. Para disa ditësh në fshatin Radishevë, njerëz të armatosur dhe me uniforma u ndeshën me banorët e këtij fshati, duke i kërcënuar. Falë syçeltësisë dhe maturisë së banorëve nuk ndodhi ndonjë tragjedi. Kjo nuk është hera e parë që njerëz të uniformuar shqetësojnë banorët e këtij fshati. Pyetja është: A e ka hetuar Qeveria rastin e Radishevës? A ka Qeveria të dhëna se kush mund të qëndrojë prapa këtyre grupeve të armatosura? Çka ka ndërmarrë Qeveria që t'iu ofrojë siguri banorëve të këtij fshati, në mënyrë që fshati të mos braktiset tërësisht? Ju falënderoj për mundësinë që më dhatë.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Pika e tretë e rendit të ditës është - Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës, zotit Agim Çeku, më kërkesë të Grupit Parlamentar të ORA-s. Në pajtim me Rregullën 25.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Partisë Reformiste ORA i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit, me kërkesë për ta ftuar në interpelancë Kryeministrin e Kosovës, zotin Agim Çeku. Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 25. 7 të Rregullores së Punës, përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në përmbyllje të debatit deri në 5 minuta.

Ftoj përfaqësuesin e parashtruesit të interpelancës të Grupit Parlamentar të Partisë Reformiste ORA që ta marrë fjalën.. Fjalën e ka Nazim Jashari.

NAZIM JASHARI – I nderuari kryeministër,
Të nderuar ministra,
I nderuar kryesues,
Të nderuar kolegë deputetë,

Përkundër asaj që salla e Kuvendit është e restauruar, rinovuar, ne nuk e kemi modelin më të mirë për një kuvend demokratik, sepse po duhet t'ia kthejmë shpinën kryeministrit ose sallës, kurse interpelanca është një akt, një mekanizëm shumë i përdorshëm në kuvendet demokratike. Do të ishte dashur që ai që e thërret Kryeministrin në interpelancë të shihen sy më sy.

Grupi ynë parlamentar, të nderuar kolegë deputetë, i nderuar Kryeministër, është një grup me fuqi jo shumë të madhe në Kuvendin e Kosovës. Pra, ne jemi 7 deputetë, nga numri i përgjithshëm prej 120 deputetëve. Në aspektin formal të vendimmarrjes me gishtërinj nuk e kemi ndonjë fuqi të madhe. Mirëpo, jemi një grup aktiv, i cili fare qartë edhe mirë i ka ndarë dy momente të rëndësishme të funksionalizimit të jetës politike në Kosovë. Në aspektin e politikës së jashtme, e kemi përkrahjen tonë maksimale, zoti Kryeministër, posaçërisht për fjalën tuaj përmbyllëse. Mbrëmë, pata rast ta shoh në televizor, sepse kam udhëtuar më herët për në shtëpi, Pra, ju përkrah të insistoni në qëndrimin, në qëllimin tuaj që ky vend dhe ky Kuvend ta marrë përgjegjësinë e vet.

Unë i kam 10 minuta , të mijat janë, zoti Hamiti, Qysh e formuloj interpelancën është problem imi. Ti kur ta bësh interpelancën tënde - bëje si të duash. Unë timen e formuloj vetë. Prandaj, të lutem, ke konsideratë, mos ndërhyj. Më vonë mund të ndërhysh. Prit sa ta kryej unë fjalën time e tani ndërhyj. Duhet të më shtohen minutat, ju lutem. E keni përkrahjen tonë maksimale. Por, për politikë të brendshme, zoti Kryeministër, na vjen keq, përkundër respektit të madh, përkundër asaj që dëshirojmë të besojmë që ju nuk jeni pjesë e shkeljeve, e abuzimeve që kanë ndodhur me rastin e tenderit të telefonisë mobile, ne e kemi bërë, sepse jemi opozitë në Kuvend të Kosovës, nuk jemi pjesë e qeverisjes, që ta ngremë shqetësimin tonë, dhe qytetarëve të Kosovës t'u sqarojmë që Grupi Parlamentar ORA nuk është pjesë e abuzimeve me tenderin e telefonisë mobile. Ne jemi bashkë në bisedimet për statusin e Kosovës, por nuk jemi bashkë në procesin e tenderit të telefonisë mobile, jemi veç, zëri ynë është krejtësisht i ndryshëm dhe dua, që këtu edhe një herë t'u përkujtoj se çka ka ndodhur me rastin e atij tenderi dhe si është proceduar ai, duke shkuar krejtësisht ndesh me ligjin.

Ju na keni dhënë një përgjigje, duke na adresuar neve që në interpelancë ta ftojme drejtorin e ART-së, po drejtori i ART-së nuk është institucion, zoti Kryeministër. Është pjesë e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, në të cilat, në krye të njërit nga ato institucione qëndroni ju. Pra, ai është pjesë e Qeverisë. Është e vërtetë që mandatin e merr nga ky Kuvend, mandatin që ia garanton një autonomi pune. Në Ligjin për Telekomunikacionit, në nenin 3 thuhet: Ministria do të mbajë përgjegjësinë për hartimin e politikave për Sektorin e Telekomunikacionit, kurse ART-ja që themelohet me këtë ligj, është trup i pavarur brenda IPVQ-së, që mban përgjegjësinë për implementimin e politikave të IPVQ-së dhe të Ministrisë të udhëhequr nga ky ligj, si dhe për të gjitha pjesët legjislative në pajtim me këtë ligj.

Ne kemi pasur mundësi ta ftojme në interpelancë edhe ministrin Qemajl Ahmeti, por ministri t'jua them të drejtën nuk na e ka mbushur mendjen që është ministër, për një arsye themelore, sepse realisht në Ministrinë e tij ai nuk i ka kompetencat. Nuk e di kush i ka, sepse ky as nuk përpiket t'i ushtrojë kompetencat që ia jep ligji. Pra, ky i përpilon politikat, por do të duhej t'i detyronte të tjerët t'i zbatojnë ato. Fatkeqësisht, ky vetëm u bën iso atyre që i uzurpojnë të drejtat dhe kompetencat. Njeriu, që ia ka uzurpuar të drejtat dhe Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit është një njeri, i cili e ka shpallur veten kryesues të Bordit të ART-së. I kemi këtu dy ministra të Telekomunikacionit, zotin Zef Morina dhe zotin Qemajl Ahmeti. Do të kisha pasur dëshirë shumë që cilido prej tyre të na jap aktin, të na e paraqes aktin këtu përpara se kur, kush dhe në cilin rast e ka emëruar Anton Berishën me emër e mbiemër - kryesues të Bordit të ART-së? Ai njeri e ka uzurpuar atë post dhe me të ka bërë çka ka dashur, me vetë faktin që e ka komprometuar një proces tenderimi. Këtë e përmendi zoti. Zef Morina edhe me rastin e fjalës së djeshme. Pavarësisht që nuk ishte temë telefonia mobile, e përmendi rastin e huqjes së lidhjes së aleancave strategjike. Me këtë potencial frekuentues, ne kemi pasur mundësi të zgjedhim ne se me kënd dëshirojmë të lidhim aleanca e me kënd jo.

Është e nevojshme për t'u sqaruar, për t'ua tërhequr vëmendjen juve që ta nisni një hetim brenda institucioneve tuaja, sepse është dështuar në zbatimin e ligjit, zoti Kryeministër. Ne ua tërheqim vërejtjen edhe një herë në mënyrë të përsëritur, sepse dispozita 3,4 e dokumentacionit të tenderit, i cili është përpiluar nga Ministria, nuk

është përpiluar nga ART-ja, për licencimin e operatorit të dytë të telefonisë mobile lidhur me mos konfiskimin e 16.2 milion eurove që e përbëjnë 20% të shumës së ofruar nga fituesi i parë i shpallur. Kjo ka qenë një kërkesë eksplicite e thënë në dokumentacionin e tenderit. Në Ligjin e prokurimit publik, i cili është ligj bazik në funksionimin e institucioneve tona, pastaj në Ligjin për menaxhimin e financave publike, neni 55.1 pika c) (ii) thuhet qartë - Paratë, të cilat janë sigurim i tenderit, do të konfiskohen, atëherë kur, kam bukur shumë dokumentacion para vetës, pra, do të konfiskohen, në bazë të nenit 55.1 pika c) (ii), në qoftë se tenderuesit në fjalë i është dhënë kontrata përkatëse në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi pastaj refuzon ose dështon që të përmbushë çfarëdo kushti tjetër që ishte specifikuar në dosjen e tenderit para nënshkrimit të kontratës përkatëse. Ka qenë një kusht decidiv, para nënshkrimit që është dashur që bashkë me dokumentacionin e tenderit, parashtruesi i ofertës ta ketë një zarf, në të cilin e deponon një garanci bankare prej 20% të vlerës së ofertës. Vlera e ofertës ka qenë 81 milion euro, kurse 20% i asaj shume bën 16.2 milion euro. Prandaj, mendoj se nuk ka nevojë për shumë sqarime shtesë. Ligji është shumë i qartë, Ligji është shumë i prerë. Ka nevojë për hetim qeveritar. Në qoftë se nuk ka hetim qeveritar, ka nevojë për hetim parlamentar. Gjithsesi ka nevojë për hetim, sepse qytetarët e Kosovës janë privuar nga 16.2 milion euro, të cilat është dashur të inkasohen në bazë të legjislacionit në fuqi. Pra, ato para kanë mundur t'i shtohen atij 75 milionëshi që e përmendët pak më parë zoti kryeministër dhe prej 75 të bëhen mbi 90 milion euro, të cilat do të ishin përdorur për qëllime fisnike në këtë fazë të zhvillimit të Kosovës. Prandaj, ne insistojmë që ju të merrni gjithçka që është në dorën tuaj, në mënyrë që të mos kapërceni me kaq lehtësi mbi këtë moment të shkeljes së ligjit. Prandaj, ky insistim dhe kjo këmbëngulje që t'ua tërheqim vëmendjen edhe juve edhe qytetarëve të Kosovës. Pavarësisht asaj që jemi opozitë në Kuvendin e Kosovës, ne e kemi për borxh, e kemi detyrë që konform përgjegjësisë që na janë deleguar nga qytetarët, t'i ruajmë paratë publike. Nuk e kemi në dorë ta menaxhojmë, por ta tërheqim vëmendjen në keq menaxhim. Ne këtë e kemi bërë për tërheqjen e vëmendjes edhe me rastin e Vila Gërmisë së famshme, dhe fatmirësisht, përkundër hezitimeve fillestare në Kuvendin e Kosovës, të gjithë na janë bashkëngjitur. Nuk e di pse na janë bashkëngjitur. A na janë bashkëngjitur pse u ka kënduar pupëza në vesh dhe ua ka mbushur mendjen që duhet për të na u bashkëngjitur? Ndoshta në këtë rast fatkeqësia është që nuk po ju këndon pupëza në vesh dhe nuk po i detyron për të na u bashkëngjitur në hetim të kësaj shkeljeje të legjislacionit kosovar. Mirëpo, sido qoftë, mendoj se Kosova nuk mund të shkojë përpara duke i injoruar obligimet që dalin nga ligji. Obligimet që dalin nga Ligji janë obligime, pavarësisht nga çështjet me të cilat ka të bëjë ajo rregullativë. Ligjin duhet ta ndryshojmë, në qoftë se nuk na pëlqen e jo ta shkelim, siç po veprojmë ne.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zoti deputet. Para se t'ia jap fjalën Kryeministrit, lus deputetët që të përqendrohen në objektin e interpelancës. Unë jam i detyruar nga kjo që u tha në fjalën e zotit deputet, t'ua lexoj objektin e interpelancës: Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, Rregulla 25.1, Grupi Parlamentar i Partisë Reformiste ORA e thërret në interpelancë Kryeministrin e Qeverisë së Kosovës, Agim Çeku, në lidhje me dështimin në zbatimin të Ligjit të Kryeministrit të Qeverisë të Kosovës, zotit Agim Çeku, si garantues i zbatimit të rregullit dhe Ligjit për mos zbatimin e dispozitës 3.4 të dokumentacionit të tenderit, për licencimin e operatorit të dytë të telefonisë mobile, lidhur me mos konfiskimin e 16,2 milion eurove, që e përbëjnë 20%

të shumës së ofruar nga fituesi i parë i shpallur, siç parasheh neni 55.1 pika c) (ii) i Ligjit për prokurimin publik 2003/17.

Lus Kryeministrin dhe deputetët që e marrin fjalën të përkufizohen dhe të përqendrohen në objektin e interpelancës. Nuk ka këtu as Gërmim as të tjera, por ky është objekt i interpelancës.

Ftoj kryeministrin Agim Çekun ta marrë fjalën.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Ju faleminderit! I nderuar zoti kryesues, të nderuar deputetë, ministra. Në bazë të Ligjit për telekomunikacion, nr. 2002/7 i dt. 8. maj 2003, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut, 2003/16 të datës 12. maj 2003, nenit 36, Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit obligohet për përgatitjen e dokumenteve të tenderit për operatorin e dytë të telefonisë mobile, ndërsa Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit është implementues i tenderit. Në bazë të këtij neni, unë edhe kam bërë përpjekje, ju kam sugjeruar edhe juve që në këtë interpelancë ta ftoni ART-në, d.m.th. si institucion i pavarur. Është e vërtetë, siç thatë: është pjesë e IPVQ-ve, por edhe Qeveria është njëra prej IPVQ-ve. ART-ja nuk është pjesë e Qeverisë, por të gjithë ne jemi bashkërisht IPVQ, kështu që është autoritet i pavarur dhe nën kompetencat e këtij Kuvendi dhe i jep llogari vetëm këtij Kuvendi.

Mendoj se për interpelancën, pyetja është shumë e qartë dhe ka pasur mundësi shumë lehtë të bëhet edhe si pyetje parlamentare. Normalisht, Qeveria është garantuese e ligjit dhe jam për atë që të japim llogari për çdo ligj, a zbatohet dhe si zbatohet, por duhet të definohen përgjegjësit e drejtpërdrejtë për implementimin e ligjeve.

Që në fillim dua t'ju them se i tërë dokumentacioni i tenderimit të telefonisë së dytë mobile është dorëzuar në polici dhe është duke u hetuar nga Njësi për Hetime dhe procedura është në vazhdim e sipër. Por, unë kam qenë dhe jam gjithnjë i gatshëm që t'i përgjigjem çfarëdo pyetjeje që ju mund ta keni.

Pyetja është: Implementimi i dy neneve apo i dy ligjeve. Po shkojmë radhazi:

Konform Ligjit për telekomunikacion, pakoja tenderuese për telefoninë mobile është përgatitur nga kompania “Konsolente AB SCELAKON” e cila është angazhuar nga Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit. Më 10 tetor 2006, në bazë të vendimit nr. 08.219 të Qeverisë, përcaktohen metoda dhe kriteret për licencimin e operatorit të telefonisë mobile. Në këtë rast përcaktohet metoda e komunikuar, çmimi minimal i kombinuar me ankand dhe vlerësimi teknik i ofertave që në terminologji quhet Bjuti Kontekst. Kompania në fjalë në bashkëpunim me ART-në ka përgatitur pakon tenderuese për telefoninë e dytë mobile. Në bazë të kësaj pakoje tenderuese është bërë edhe ftesa për aplikimin e ofertuesve. Pakoja tenderuese përmban rregullat procedurale dhe instruksionet, të cilat në mënyrë të qartë përshkruajnë procedurën tenderuese për telefoninë e dytë mobile.

Në këtë mënyrë, pakoja tenderuese është dokument bazë në të cilin parashihen rregullat e veprimit gjatë procesit të tenderimit. Kjo nënkupton që me vetë faktin e aplikimit të nenit 36 të Ligjit për Telekomunikacion, procesi dhe procedurat e tenderimit të telefonisë së dytë mobile rregullohen në mënyrë të drejtpërdrejtë sipas pakos tenderuese. Prandaj, ky aktivitet i caktuar i tenderimit është plotësisht subjekt i nenit 36 të Ligjit për telekomunikacion 2002/17.

Pas afatit të aplikimit është formuar Komisioni vlerësues i përbërë nga dy përfaqësues të UNMIK-ut, dy përfaqësues të ART-së dhe një përfaqësues i Qeverisë. Gjithashtu, me insistimin tim si kryeministër, PSSP-ja me qëllim të rritjes së transparencës gjatë tërë procesit, është formuar edhe Komisioni Special i Mbikëqyrjes, po ashtu, i përbërë nga përfaqësuesit e UNMIK-ut, të ART-së dhe të Qeverisë.

Komisioni Special i Mbikëqyrjes, po ashtu, i përbërë nga përfaqësuesit e UNMIK-ut, ART-së. Komisioni Special i Mbikëqyrjes ka qenë përgjegjës për miratimin, zbatimin e pakos tenderuese, si dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të tërë procesit tenderues. Në procesin e tenderimit, në rastin konkret, anëtarët e dy komisioneve të lartcekura kanë qenë përfaqësues të tri niveleve: të UNMIK-ut, ART-së dhe të Qeverisë. Kthehem tash, sipas pikës 3.4, për çka është pyetja e juaj. Të pakoja tenderuese nga ofertuesi është kërkuar që të paraqesin një garanci të pakthyeshme bankare nga një institucion i njohur financiar, bashkëngjitur me ofertën financiare për Autoritetin Rregullator të Telekomunikacionit, në vlerë jo më pak se 20% të çmimit ofertues. Kjo nënkupton, pra se garancia bankare është i destinuar vetëm për ART-në, jo për buxhet. ART-ja është ajo e cila e ndalon garancinë bankare.

Në fund të procesit të vlerësimit, i cili nga e Komisionit Special Mbikëqyrës, në mënyrë unanime është vlerësuar si proces i rregullt, është bërë rangimi i ofertave dhe në vlerësimin e përgjithshëm të pikave nga Komisioni vlerësues Kompania “Kosmotel” është vlerësuar si ofertë e preferuar. Këtu ritheksoj edhe një herë se kompania në fjalë, në bazë të vlerësimit dhe në pajtim me pikën 3, 4 të shtojcës një të pakos tenderuese është vlerësuar si ofertë e preferuar, jo si fitues.

Kompania me ofertë të preferuar ka dështuar të përmbushë obligimin e saj konform dispozitës në pakos tenderuese. Në këtë rast, pika 22 e shtojcës 3 të pakos tenderuese, në mënyrë të qartë parasheh që ofertuesi i shpallur si ofertues i preferuar dështon ta bëjë pagesën e shumës së zotuar, në pajtim me pikën 19 të pakos tenderuese humb të drejtën e ofertës së preferuar. Sipas pikave të vlerësimit ofertues, ofertuesi i preferuar, shpallet ofertuesi i dytë me radhë, prapë si ofertues i preferuar. Në këtë rast ofertuesi i preferuar është shpallur kompania “IPKONET -Telekom Slovenija”. Kjo i ka përmbushur kriteret në bazë të pikës 3.4, me të cilin ka bërë pagesën e premtuar në shumë prej 75 milionë euro, në afat kohor prej dy javësh. Në bazë të pikës 3.9 të pakos tenderuese ART-ja ka dhënë licencën ofertuesit të preferuar katër javë pas shpalljes së ofertës fituese, pasi është konstatuar që ofertuesi i preferuar ka përmbushur të gjitha obligimet e pagesës në pajtim me instruksionet e pakos tenderuese.

Nënshkrimi i kontratës është bërë nëpërmjet ART-së dhe kompanisë IPKONET Telekom Slovenija, pas përmbushjes së të gjitha obligimeve në pajtim me dispozitat e përcaktuara të pakos tenderuese.

Janë ngritur edhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me Ligjin për prokurimin publik të Kosovës. Neni 55.1 e Ligjit për prokurimin publik, pika c (ii) përcakton si në vijim - citoj: “Gjatë një aktiviteti të prokurimit që shpie drejtë të dhënies së një kontrate me vlerë të mesme, ose të madhe autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit që të depozitojnë siguri, garanci bankare për tender. Siguria e tenderit që është depozituar

nga tenderuesit do të konfiskohet në rast se tenderuesit në fjalë i është kontrata përkatëse në bazë të tenderit të tij dhe ai pastaj refuzon, ose dështon që të përmbushë çfarëdo kushti tjetër që ishte specifikuar në dosjen e tenderit para nënshkrimit të kontratës përkatëse. Prandaj ,në këtë kontest mund të konkludojmë se nuk bëhet fjalë për shkeljet e nenit 55.1, pika c 2 të Ligjit për prokurim publik 2003/17, për arsye se nuk ka pasur dhënie të kontratës së licencës kompanisë “Kosmocel” .Pra, në këtë rast pika 3 4 e pakos tenderuese është zbatuar në mënyrë të rregullt.

Dua të shtoj se këtu kemi një kontest, me të cilin tani është duke u marr Gjykata Supreme e Kosovës. Në bazë të pikës 3 4 ART-ja ia ka bllokuar garancinë bankare “Kosmocelit”,pra është garancioni bankar i cili është dhënë nga obliguesi Kapital Menaxhmet Holding PLC dhe KUJTESA VLC dhe garancia vlen prej 7.1.2007 dhe datën e përfundimit më 6.1.2012. Këto mjete janë të bllokuara në ART. Në bazë të pikës 3 4 të pakos tenderuese, ART-ja i ka bllokuar këto mjete. Por, me qenë se neni të cilit ju i referoheni i Ligjit për prokurim 55.1 thotë: Garancia bankare i konfiskohet vetëm nëse pas dhënies së licencës dështon, ose tërhiqet, kështu që në këtë rast , vetëm kompania që e ka fituar kontratën, e ka fituar licencën IPKONET - Telekom Sllovenia, në qoftë se sot ata tërhiqen ose dështojnë në përmbushjen e kontratës, atëherë ju konfiskohen,Pra, e kemi një konflikt mes Ligjit për prokurim publik dhe pakos tenderuese. Ajo çka është faktike është se garancia bankare është bllokuar nga ART-ja ,kurse kompania e cila e ka dhënë këtë garanci bankare Menaxhment Holding PLC dhe KUJTESA bazohet në Ligjin për prokurim publik në pikën 55.1 dhe kërkon që t’i zhbllokohet kjo garanci bankare.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zoti Kryeministër! Shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së.

ALUSH GASHI – Ju faleminderit, zoti kryesues. Grupi ynë parlamentar e ka përcjellë me shumë kujdes tërë procesin për të cilin sot bisedojmë. Si në ditën e parë, ashtu edhe në këtë interpelancë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës angazhohet për zbatim të ligjit plotësisht. Në bazë të paraqitjes së propozuesit të interpelancës si dhe të përgjigjes së ekselencës së tij, Kryeministrit të Kosovës, ne nuk kemi të dhëna për ngritje të Komisionit Hetimor. Prandaj, zoti kryesues, ne do të marrim pjesë në debat dhe angazhimi ynë i palëkundur është zbatimi i ligjit plotësisht.. Ne këtë nuk e kuptojmë si fushatë elektorale, por si një përpjekje për kontribut të një grupi të nderuar parlamentar. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës , Bajrush Xhemajli. Urdhëroni, e keni fjalën.

BAJRUSH XHEMAJLI – Ju faleminderit, zoti kryesues! I përshëndes të gjithë.

Partia Demokratike e Kosovës, qysh moti ka tërhequr vërejtjen për manipulimet e shumta që janë bërë, jo vetëm me rastin e këtij tenderi, por edhe në rastet e tjera ka kërkuar të zbatohet ligji. Pra, edhe sot kërkojmë e që procedura të shkojë deri në fund.

Sa i përket interpelancës që ka kërkuar Partia Reformiste ORA, neve asgjë nuk na prish punë ngritja e një Komisioni Hetimor, edhe pse në këto raste mund të qesë edhe diçka tjetër edhe të papritur një komision i tillë. Ne duam të tërheqim vërejtjen se për krejt shkeljet që i ka bërë ART-ja, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka hedhur edhe në votim marrjen e besimit, për ta shkarkuar kryetarin e ART-së, ose edhe krejt bordin. Por shumica e deputetëve të Kuvendit nuk e ka pranuar një gjë të tillë. Ne kemi tërhequr vërejtjen për shkelje të shumta që janë bërë. Ka mundësi që edhe këtu të dalë ndonjë shkelje, por këtë, natyrisht, do të konstatojë Komisioni Hetimor që do të formohet.. Neve nuk na prishë punë një gjë e tillë. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ftoj shefin e Grupit Parlamentar, Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit, zoti kryesues. I nderuari zoti Kryeministër. Faleminderit për sqarimet e dhëna dhe të detajuara lidhur me kërkesën e Grupit Parlamentar ORA.

Grupi Parlamentar i Aleancës është i përkushtuar për zbatimin e ligjit me përpikëri. Megjithatë, edhe zbatimi i ligjit dhe siguri i zbatimit të tij janë me rëndësi si dhe interpretimi i tij nga organet përkatëse, përkatësisht nga gjykatat. Në këtë rast, meqë kryeministri e ceku se i gjithë dokumentacioni tenderues i është dorëzuar Gjykatës dhe Njësia për Hetim është duke punuar, konsideroj se nuk ka nevojë për ngritje të ndonjë komisioni, pasi që ky është subjekt i vet punës së gjykatës. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar 6+, deputeti Mahir Yagcilac

MAHIR YAGCILAR – Ju faleminderit, zoti kryesues!
I nderuar Kryeministër,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,

Grupi Parlamentar 6+ e mbështet në parim debatin për çështjet të cilat i ka iniciuar Grupi Parlamentar ORA. Pa marrë parasysh se për këtë fushë është përgjegjës drejtpërsëdrejti Agjencia e Pavarur, ose ART-ja, këtë problem e konsiderojmë me rëndësi të veçantë për Kosovën. Së këndejmi kryetari i Qeverisë, si shef ekzekutiv është mirë t'i jap disa sqarime të domosdoshme plotësuese rreth rastit konkret të konfiskimit të mjeteve financiare, përkatësisht depozitës lidhur me tërheqjen e fituesit të parë të shpallur, që e ka dhënë. Me këtë rast konsiderojmë se sqarimi i kryeministrit vetëm ndihmon dhe nxit transparencë dhe një frymë më të madhe demokratike. Prandaj, kërkojmë nga të gjitha palët që të punojnë në ndriçimin e këtij rasti, në pajtim me dispozitat ligjore. Sa i përket Komisionit, ne nuk kemi kundër, mundet të krijohet. Kjo është një çështje demokratike. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, ftoj deputeten Vezira Emrush ta marrë fjalën.

VEZIRA EMRUSH – Pozdruvlljam ovo Predsedništvo, premijera, gospodu ministre i sve polsanike,

Kao Grupa za integraciju mi smo zauzeli stav da se obavezno formira Anketna komisija, i to radi utvrdjivanja prave istine, radi onemogućavanja veće manipulacije oko ovog predmeta koji nam je izneo gospodin predsednik Vlade i na zahtev Grupe ORA. Ovo želimo u nadi da se ovo onemogući, znači da dodje do većeg onemogućavanja manipulacije. Ne prejudiciramo situaciju samo želimo da se uspešno utvrdi činjenično stanje. Hvala!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Për fjalë është paraqitur deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI – Ju faleminderit i nderuari kryesues. Unë më tepër jam paraqitur që të shpreh një shqetësim si kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, në relacion me Kryesinë e Kuvendit, e cila vazhdimisht po anashkalo çështjen e agjencive të pavarura tek organet të cilat vetë i ka nxjerrë që duhet të jenë llogaridhënëse ndaj këtij Kuvendi. Pra, ky është një preokupim i vazhdueshëm, me të cilin ne po ballafaqohemi.

Lidhur me çështjen – ngritjen e interpelancës, Kryesia e Kuvendit nuk është dashur ta ngarkojë Kryeministrin, e më së paku Qeverinë që të japë përgjigje për këtë për arsye se ne e kemi themeluar Agjencinë Rregullative të Telekomunikacionit dhe KRPP-në. Agjencia Rregullative e Telekomunikacionit obligohet në bazë të Ligjit për telekomunikacion, nenit, 5, alineja 7 që t'i japë llogari, ose raporte të hollësishme financiare Kuvendit të Kosovës dhe një raport të tillë e kanë në dorë. Jemi munduar disa herë që në Komisionin për Buxhet ta shqyrtojmë, por për mungesë të kuorumit nuk kemi arritur dhe një mbledhje të tillë e kemi paraparë edhe sot. Prandaj, ne kemi mundësi si Kuvend që ART-së t'i kërkojmë llogari për çdo shqetësim që ne kemi edhe ta ngrinin këtë çështje dhe ta ftojnë ART-në, ashtu siç e tha me plotë të drejtë edhe kryeministri. Edhe për çështjet e tjera KRPP-ja është organ i Kuvendit dhe i jep llogari vetëm këtij Kuvendi. Ne duhet ta eliminojmë ndërhyrjen e Qeverisë në organet e pavarura. Duhet ta eliminojmë ndërhyrjen edhe në këtë formë, por t'i eliminojnë edhe ndërhyrjet e tjera që bëhen me presione të ndryshme financiare gjatë hartimit të buxheteve. Ky është një shqetësim, një preokupim, andaj ju lutem si Kryesi t'i trajtoni këto çështje më seriozisht. Mos e ngarkoni as Qeverinë as kryeministrin me çështjet të cilat thjesht nuk janë çështje të tyre. ART-ja duhet të thirret në Parlament dhe të japë llogari për çdo gjë që neve na intereson. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zoti deputet. Kam një sqarim për deputetët. Në monitorin e paraqitjes për fjalë nuk kam hasur emër të Grupit Parlamentar të LDD-së dhe për atë nuk e kam thirrur Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë.

E keni mundësinë, nëse dëshironi që në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së ta merrni fjalën. Urdhëroni. Ramadan Kelmendi e ka fjalën.

RAMADAN KELMENDI - Ju faleminderit, kryesues. Rregull parimor është që për çështje të tilla të merret mendimi i çdo shefi të grupit parlamentar. Sido që të jetë, unë

mendoj se Grupi Parlamentar i LDD-së përkrah ligjshmërinë çdo kund, pranon arsyetimin e dhënë nga Kryeministri dhe nuk e sheh të arsyeshme formimin e Komisionit, përderisa çështja është ngritur në gjyq. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zoti deputet. Besoj që ju e keni pranuar sqarimin tim. Tjetër herë, kushdo nga grupi juaj mund të paraqitet për fjalë dhe nuk ka problem për kryesuesin. Ministri Qemajl Ahmeti e ka fjalën.

QEMAJL AHMETI – Ju faleminderit!

I nderuari kryesues,
Të nderuar deputetë,

Unë dola vetëm për një qartësim për deputetin Nazim Jashari. Unë nuk e di cilat kompetenca nuk janë zbatuar. Nëse Ministria mendon se duhet të ndërhyjë në punën e autoriteteve rregullatore, që janë të pavarura dhe kanë për detyrë zbatimin e politikave në përputhshmëri me ligjin, atëherë e ka gabim. Çka duhet të qartësoj? Për çfarëdo vendimi të gabuar nuk ka nevojë të ndërhyjë. Ndaj Autoritetit Rregullator është përgjegjëse gjykata, jo Qeveria. Qeveria e përgatit tenderin. Qeveria ka pasur për detyrë që ta përcjellë pakon tenderuese dhe zbatimin e saj. Për gabimet e tjera, pra, për vendimet e Autoritetit Rregullator të Komunikacionit është kompetente gjykata.

Ka një paqartësi edhe sa i përket Ligjit të telekomunikacionit, prandaj në Qeveri kemi filluar ndryshimin e tij. Nuk dëshiroj ta përsëris atë që e përsëriti deputeti Naser Osmani.. Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit i përgjigjet Kuvendit të Kosovës për punët që i kryen dhe në çdo 6 muaj është e detyruar t'i paraqes raport. Prandaj, në këtë drejtim e ndjeva për obligim të dal në foltore. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Për fjalë është paraqitur deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA - Ju faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara Qeveri,
Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh që tenderi i telefonisë mobile është një tender i një rëndësie jashtëzakonisht të madhe, sidomos duke pasur parasysh që operatori i tretë gati e ka të pamundshme të kyçet për shkak të përdorimit të brezit frekuencor në aso mënyre nuk i lejohet operatorit tjetër të hyjë, shihet rëndësia e veçantë e këtij tenderi. Gjithashtu, shihet rëndësia e veçantë dhe biseda për mbarëvajtjen e këtij tenderi dhe të procedurave, që do të ndihmojë në demokratizimin, në ngritjen e nivelit të punës, si të Kuvendit, ashtu edhe të të gjitha institucioneve.

Sa i përket Qeverisë, të gjithë e kemi të qartë se ART-ja është një organ i pavarur, por në asnjë mënyrë nuk mund të thuhet që ART-ja është një organ diku në qiell, i cili nuk ka kurrfarë lidhjeje me Qeverinë, ose me organet e tjera. Në fund të fundit, ligjshmëria dhe Ligji për prokurimin publik edhe dokumentacioni ka qenë i përpiluar prej Ministrisë dhe ka të bëjë me Qeverinë, me Parlamentin dhe me të gjithë.

Vetëm t'ju përkujtoj që sa i përket tenderit, garancisë së tenderit, në fakt nuk është një garanci e tenderit, por janë dy garanci. Janë Bid guarantee edhe Performace guarantee dhe në Komision, për të cilin zoti kryeministër tregoi kanë qenë edhe pjesëtarë, përfaqësues...

KRYESUESI NAIM MALOKU – (Ndërhyrje): - Çka janë ato, ju lutem, për ata që nuk e kuptojnë mirë anglishten. Këtu gjuhë zyrtare është shqipja. Çka janë ato garanci?

TEUTA SAHATQIJA - Si urdhëro, zoti kryesues. Kur flasim për tenderët dhe për garancitë, mendoj që të gjithë e kanë të qartë. Nuk e kanë të qartë ata që ndoshta nuk dëshirojnë ta kenë të qartë, sidoqoftë po ju shpjegoj.

KRYESUESI NAIM MALOKU – (Ndërhyrje): – Lus përkthimin në shqip, në gjuhën zyrtare të Kuvendit.

TEUTA SAHATQIJA - Po ju shpjegoj , Bid guarantee është tenderi, garancia, për të pasur leje për të hyrë në tender dhe për të pasur dokumenti yt arsye të hapet, ndërsa Performancee guarantee, për ata që nuk e dinë anglishten , është garanci, që mbahet kur të nënshkruhet kontrata, e pastaj_Këto janë dy garanci të ndryshme.

Të vazhdoj aty ku mbeta. Në Komisionin të cilin ju e thatë që i keni pasur përfaqësuesit tuaj, kanë qenë të detyruar që ata përfaqësues ta shikojbë dokumentacionin edhe të shohin a ekziston, a është valid apo nuk është valid. Prandaj, në qoftë se ky komision i cili nuk ka qenë vetëm i ART-së, por ka qenë komision në të cilin kanë qenë përfaqësues të tjerë, nuk e ka parë të arsyeshme të shikojë a ekzistojnë këto garanci, a janë valide, atëherë është më se arsyeshme që të formohet Komisioni Hetimor, i cili, pa marrë parasysh aktivitetin të cilin po ju përgëzoj që e kishit ndërmarrë me dërgimin e dokumentacionit në polici dhe prokurori, por të dokumentacion i cili në asnjë moment nuk e anashkalojnë Kuvendin. Kuvendi është përgjegjës edhe për ART-në, edhe për Qeverinë. Gjithsesi është përgjegjës dhe kujdeset për buxhetin e Kosovës. Pra, Komisioni Hetimor parlamentar në kompetencat e veta, në asnjë mënyrë nuk duhet të përzihet në kompetencat e gjyqësorit, por të shohë pse kanë ndodhur këto parregullsi, në mënyrë që nesër të evitohen parregullsitë e ngjashme dhe të ngritet niveli i përgjegjësisë së Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI - Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari Kryeministër,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Ndoshta nuk e kam të qartë, por sa më duket krejt interpelanca është e thirrur rreth konfiskimit të shumës prej 6 milion e 200 mijë eurove, e që kanë të bëjnë me tenderin për Telefoninë e dytë mobile.

Këtu, në këtë rast përdoren tri lloj dokumentacionesh kur është fjala për dhënien e telefonisë mobile. Dokumenti i parë, është Ligji për telekomunikacionin, neni 36, sipas të cilit ministri i Telekomunikacionit nxjerr vendimin për shpalljen e tenderit për telefoninë mobile dhe e përgatit pakon tenderuese. Me atë ai i ka kryer të gjitha punët e veta sa i përket tenderimit. Pastaj, implementimin e pakos tenderuese, në mënyrë strikte duhet ta bëjë ART-ja. ART-ja është një organ të cilin me vendim të këtij Kuvendi e ka themeluar ky Kuvend dhe ART-ja është një organ midis Qeverisë, sa i përket çështjeve teknike për implementimin e pakos tenderuese dhe Kuvendit të Kosovës, të cilit i përgjigjet për punën e tij.

Dokumenti i dytë thashë është pakoja tenderuese, që më tepër është dokument teknik, por edhe ka sanksione. Sanksionet e tij janë që nëse ofertuesi i parë heq dorë nga oferta dhe ka të deponuara të holla në depozit, por nuk e ka të nënshkruar pakon tenderuese, atij nuk mund t'i merren 6 milion e 200 mijë euro. Në rastin konkret, ofertues i parë është "Kosmoceli". Dokumenti i tretë është Ligji për prokurimin publik. Me nenin 55. 1. pika c) (ii) ai përcakton se, sikur që e citoi edhe zoti ministër, tenderuesit nëse i është dhënë kontrata dhe ai pas dhënies së saj, apo me gjuhën e tenderit -licencës, mund t'i ndalen, t'i konfiskohen ato 6 milion e 200 mijë euro. Në rastin konkret, "Kosmoceli", siç del nga raporti i kryeministrit dhe nuk dua të dyshoj nuk është raport korrekt, "Kosmoceli" nuk ka nënshkruar kurrfarë licencë-kontrate me ART-në. Pasi që çështja qëndron kështu ai do me thënë është tërhequr nga tenderi dhe me automatizëm tenderuesi i dytë e fiton tenderin dhe ai i ka kryer obligimet, por sa i përket këtij 6 milionëshi, sipas Ligjit për Prokurim nuk ka pasur të drejtë ART-ja t'ia ndalë atij 6 milion e 200 mijë euro. Ndoshta s'kam të drejtë, por rreth kthimit të këtyre 6 milion e 200 mijë euro është edhe kontesti në gjykatë. Tjetër nuk ka çka, sepse nuk ka pasur kundërshtarë, të cilët e kanë kundërshtuar vendimin për shpalljen e fituesit të tenderit, brenda afatit prej 30 -ditëve dhe për arsye se nuk ka pasur kontratë, atëherë ka pasuar lidhja e licencës-kontratës. Kjo është e tëra. Ato 6 milion e 200 mijë euro nuk mund t'i merren IPKO NET-it as Telekom Sllovenisë, sepse këta veç kanë hyrë në marrëdhënie kontraktuese me ART-në, e kanë lidhur kontratën edhe, siç u cek këtu, i kanë paguar të gjitha detyrimet. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zonja deputete! Fjala ishte për 16.2 milion euro. Për fjalë është paraqitur deputeti Zef Morina. E keni fjalën.

ZEF MORINA – Ju faleminderit, zoti kryesues! Përshëndes Kryeministrin, ministrat. Vërtet çështja e tenderit të telefonisë mobile na ka krijuar shqetësime shumë të mëdha që nga fillimi. Bordi i ART-së është krijuar sipas Ligjit për Telekomunikacionin, kjo duhet të kihet parasysh. Nuk është ashtu siç po thuhet që ART-ja është krejtësisht e pavarur. Shumë qartë ligji i përcakton përgjegjësitë e ART-së dhe mënyrën e zgjedhjes së ART-së. Pikërisht, duke e konsideruar vetën si një institucion krejtësisht të pavarur, ART-ja edhe në tenderin e parë ka bërë shkelje, të cilat e kanë detyruar në një mënyrë të prolongohet aq gjatë çështja e tenderit sa që tash paraqiten probleme të reja, probleme të tjera si arsye e konsiderimit të vetvetes nga ana e ART-së si organ mbi institucional. Sipas Ligjit i raporton Parlamentit për punën që e ka bërë, ndërsa është përgjegjës pikërisht ndaj Ministrisë. Mua më vjen keq se ministri dhe Ministria shumë pak kanë qenë të involvuara, të mos them fare të involvuara fare në këtë problem, përndryshe

nuk ka qenë dashur që kryeministri të jetë direkt i thirrur për këtë çështje, por pikërisht ministri.

Më lejoni vetëm një rast t'ju them, në pakon tenderuese të tenderit të parë, kur është shpallë, pikërisht kryetari i ART-së, e bën ndryshimin e pakos tenderuese, duke i ndryshuar kriteret sipas dëshirës së tij. Do me thënë këtu bëhet shkelje brutale e ligjit. Pikërisht për këtë arsye ka zgjatur problemi deri sot. Tani, çështja që ka ndodhur me rastin tjetër është e padrejtë që në një mënyrë me tërheqjen e ofertuesit të parë, të vijë në radhë ofertuesi i dytë. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur as në privatizimin që ka bërë AKM-ja, por sido që të jetë, si duket pakoja është përgatitur pikërisht për këtë arsye dhe ato mjete, të cilat kanë qenë garanci prej 16.2 milion eurosh, mendoj që nuk duhet t'ia kthejë fare kompanisë e cila ka konkurruar. Po që se analizohet mirë materiali, shihet se këtu është një marrëveshje ndërmjet dy kompanive dhe në këtë rast humbin qytetarët dhe Kosova. Këtu dëshiroj të them që ART-ja është duke funksionuar me numër jo të plotë të anëtarëve, gjë ka qenë dashur shumë shpejt Qeveria dhe Ministria të ndërhyjë për ta zgjidhur këtë problem.

ART-ja duhet t'i ketë 5 anëtarë, ndërsa funksion me 4. Të mos flasim tash për rastin që i ka ndodhur kryesuesit të Bordit. Zoti Jashari pyeti a është kryetar i Bordit a nuk është? Sigurisht do të ishte mirë ta pyeste ministrin, sepse zoti Berisha nuk është kryetar i Bordit, por është i pari ndër anëtarët e bordit dhe me ligj është kryesues i Bordit, që është i barabartë nga gjithë anëtarët, ndërsa ka vepruar jo si kryetar i Bordit, por në nivel të kryeministrit. Mendoj se këtë çështje duhet shikuar me gjak ftohësi dhe vërtet të mos të marrin masa të cilat do të na dëmtonin jo vetëm si institucione, por edhe ekonomikisht. Vetëm një minutë më lejoni ta ndërlidhi bisedën e mbrëmshme që e pata pikërisht për këtë çështje. Nëse ne e gojën plotë Amerikë e Evropë, vërtet është dashur të jemi më të kujdesshëm dhe të veprojmë për interesat e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Pasi që nuk ka të paraqitur të tjerë, ftoj propozuesin e interpelancës ta marrë fjalën.

I keni 5 minuta, zoti deputet.

NAZIM JASHARI – Mendoj se kjo interpelancë hodhi dritë në disa aspekte të rëndësishme të këtij procesi të dhënies së pasurisë së Kosovës në shfrytëzim. Pra, Kryeministri na njoftoj se pakoja tenderuese është në polici dhe se policia është duke i hetuar aspektet që kanë të bëjnë me rregullsinë e pakos tenderuese. Shpresoj që edhe Qeveria, duke pasur posaçërisht parasysh fjalën përmbyllëse të zotit Morina, sepse ai ka qenë njëri i cili e ka ndërtuar atë ministri dhe e dinë saktë mënyrën, punën dhe kompetencat e Ministrisë dhe të ART-së dhe raportet e tyre në praktikë dhe jo vetëm në bazë të asaj që shkruan në ligj. Pra, ky do të duhej të ishte një hetim qeveritar lidhur me të gjitha rregullsitë ose parregullsitë në këtë proces. Sidoqoftë, duhet edhe një herë ta sqarojmë një gjë. Ligji i prokurimit publik është miratuar në këtë Kuvend me një qëllim themelor. Pra, ta sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe të burimeve publike. Pra, dihet çka janë fondet publike dhe burimet publike.

Frekuencat, brezi frekuencor bën pjesë në grupin e burimeve publike, në grupin e pasurisë kombëtare të limituar- të pa riciklueshme. Është një sasi e kufizuar e pasurisë kombëtare, sepse e kemi një brez frekuencor, i cili ndahet dhe nuk ka më. Mund ta ndash, ne mund t'i japim edhe një operator të tretë të telefonisë mobile dhe më nuk ka. Faktikisht, është një burim shumë i kufizuar i pasurisë publike. Prandaj, me rastin e përpilimit të dokumentacionit të tenderit, Ministria si palë, si autoritet kontraktues, se është shumë me rëndësi kush është këtu autoriteti kontraktues. Nuk është ART-ja autoritet kontraktues, zoti kryeministër. Autoritet kontraktues është ai i cili e përpilon dokumentacionin e tenderit dhe i cili, thjeshtë, për shkak të nevojave për ekspertizë profesionale e delegon zbatimin në një trup profesional. ART-ja do të duhej të ishte trup profesional. Do të duhej të ishte e përbërë nga ekspertët më të mirë në lëmin e telekomunikacionit në Kosovë dhe jo të paguajmë ne qira për firma të tjera ekspertore që vijnë dhe bëjnë ekspertiza dhe marrin para të majme, sepse është dashur që ekspertët tanë ta bëjnë atë punë. Kudo në botë ekspertët vendorë e bëjnë atë punë, nuk goditen me firmat e tjera, të cilat e kryejnë atë punë. Fatkeqësisht, vetëm te ne i dyfishojmë ministrinë. E kemi pasur një ministri, e keni ndërtuar edhe një ministri, edhe një trup politik, sepse ART-ja na manifestohet si trup politik e jo si trup ekspertësh. Pra, ky është thelbi i problemit. I kemi dy trupe politike që luftojnë për kompetenca- ART-në edhe Ministrinë dhe ai që është më i zoti, ai që është më karizmatik, ai që grabit më shumë. Pikërisht është ajo që po doni ta bëni, zoti Kryeministër, me pavarësinë. Ai që guxon, e merr hapësirën, e pushton hapësirën. Anton Berisha ka guxuar, e ka pushtuar hapësirën. Kush guxon, rrezikon, fiton dhe humb. Unë dyshoj që Anton Berisha ka fituar në këtë rast, ai ka humbur. Jam i sigurt që ai ka humbur në qoftë se Kosova dëshiron të bëhet shtet ligjor. Pra, do të duhet detyrimisht të bëhet shtet ligjor. Ky tenderim patjetër do të duhej të hetohej deri në fund edhe konform Kodit Penal, i cili e parasheh edhe shkeljen ose krijimin e rrethanave për përfitime, për ndërmarrje publike, ose për persona private, në mënyrë të paligjshme. Në këtë aspekt, mendoj se ai, megjithatë, në fund do të jetë humbës, sepse do të duhet, do të detyrohet të përgjigjet për shkeljet që i ka bërë.

ART-ja nuk e jep licencën, sepse asnjë kompani botërore nuk do të kishte ardhur këtu me fjalën e ART-së, ka ardhur me fjalën e Kryeministrit të Kosovës. Ju nuk duhet ta mohoni nënshkrimin tuaj, ju keni qenë palë nënshkruese. Pra, nënshkrues i plotfuqishëm zyrtar i vetmi, i cili është garantues i zbatimit të atij vendimi. Mendoj se këtu u lexua edhe nga zonja Nekibe edhe nga ju një dispozitë e nenit 55 të Ligjit për prokurimin. U lexua gabimisht. Ne e kemi shkruar në kërkesën tonë për interpelancë- thotë: "Do t'i konfiskohen tenderuesit në fjalë që i është dhënë kontrata përkatëse në bazë të tenderit tij dhe tenderuesi pastaj e refuzon ose dështon që të përmbushë çfarëdo kushti..."

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zoti deputet! E përfundojmë këtë pikë të rendit të ditës. Pauzë deri në orën 13:30 minuta.

Vazhdimi i punës së seancës pas pauzës në orën 13:30

KRYESUESI NAIM MALOKU – Vazhdojmë me pikat e rendit të ditës të kësaj seance. Janë plotësuar kushtet për t'u mbajtur debati.

Pika e katërt e rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme

Konstatimet hyrëse

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 5 korrik 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj ministrin Ibrahim Selmanaj, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. Ministër, e keni fjalën.

IBRAHIM SELMANAJ – Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Më lejoni që me një rezymë të shkurtër të paraqes Projektligjin për përkrahje të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme.

Objektivi parësor i një programi të asistencës sociale, duhet të jetë krijimi i një rrjeti të sigurisë për më të cenuarit në shoqëri. Zgjidhja e programit të asistencës sociale përcaktohet nga kushtet e vendit, nga faktorët kulturorë dhe socio-ekonomik, të ardhurat dhe burimet e vendit që janë të gatshme për asistencë sociale.

Skema e asistencës sociale në Kosovë mbetet një skemë kategorike e limituar që ka në shënjestër familjet e varfra. Kategoria e parë ose nën A janë familjet pa burime, ku asnjëri nuk është i aftë të punojë ose të jenë në gjendje të punojnë ose nëna ose një fëmijë i vetëm. Kategoria e dytë, familjet, me të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeçare apo që kujdesen për një jetim nën moshën 15- vjeçare, anëtarët tjerë që janë të aftë për punë dhe duhet të regjistrohen si të papunë.

Përbrenda këtyre indikatorëve duke e ditur se edhe pse kemi ngritur skema pensionale dhe skema të asistencës sociale, fëmijët deri më tani janë trajtuar si pjesë e familjes dhe vetëm kaq. Familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, nëse i kanë plotësuar kushtet e tjera janë futur në skemën e ndihmës sociale e nëse jo, kanë mbetur në mbështetje dhe përkujdesje të familjes.

Projektligji i paraqitur sot para jush për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme, ka qenë imperativ i kohës për ta rrumbullakuar përkujdesjen tonë ndaj familjeve që i përmendëm më lartë, që janë të cënueshme dhe nuk kanë përkrahje.

Personi që ka nevojë për kujdes të përhershëm, është me aftësi të kufizuara deri në atë shkallë sa që mos kujdesia e përhershme për te paraqet rrezik serioz për sigurinë e tij, madje edhe për jetën e tij. Pra, kujdesi ndaj këtij personi duhet të jetë deri në atë masë sa që të pamundësojë, që personat që ofrojnë këtë kujdes të punësohet.

Projekti ka për synim që të ndihmojë këtë familje të fëmijëve prej moshës 1 deri në moshën 18 vjeç që janë qytetarë të Kosovës. Ndihma materiale për fëmijë me aftësi të kufizuara paguhet në emër të prindërit apo të kujdestarit të fëmijës nëpërmjet llogarisë

bankare për fëmijë të palëvizshëm, fëmijë plotësisht të verbër, fëmijë që nuk mund të ushqehen vetë, të vishen dhe zhvishen vetë, t'i kryejnë nevojat si dhe ta mbajnë higjienën personale të tyre. Është paraparë që komisionet mjekësore në shkallë të territorit të bëjnë ekzaminimet e nevojshme mjekësore dhe personat që kualifikohen. Në këtë Komision, siç është i paraparë me Ligj, personat me aftësi të kufizuara të përhershme procesohen nga zyrat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për pagesë, ndërsa ata që janë të pakënaqur me vendimet e shkallës së parë, mund t'i drejtohen Komisionit mjekësor të shkallës së dytë përmes zyrave të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale. Është parallogaritur se në Kosovë ka rreth 3000 fëmijë plotësisht dhe përherë me aftësi të kufizuara dhe duke u nisur nga fakti se familja ka shpenzime shtesë, për këta fëmijë si dhe që prindi apo kujdestari nuk mund të punojë, kemi propozuar që lartësia e ndihmës të jetë 100 euro në muaj për një fëmijë e barabartë me shumën që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale paguan për strehim familjar për një fëmijë të braktisur.

Nga ajo që u tha, rezulton se nëse paguhen 3000 familje me vlerën 100 euro në muaj është e barabartë me shumën 300.000 euro brenda muajit dhe llogaritur për 12 muaj të vitit, nevojiten 3.6 milion euro që ta kemi një kujdes të veçantë për këtë kategori të fëmijëve. Dhe krejt në fund, në takimet të cilat janë të vazhdueshme, posaçërisht me prindërit që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara, kanë vërejtje në moskujdes, unë propozoj që me kujdes ta shqyrtoni këtë ligj. Pra, propozoj që të përkrahet në parim dhe në mundësinë e parë të jetë ligj i zbatueshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka Naim Jerliu, në emër të LDK-së.

NAIM JERLIU – Ju faleminderit, zoti kryetar!

Do të duhej përgëzuar sponsorin për hartimin dhe sjelljen në Parlament të Projektligjit për përkrahje materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme. Ky projektligj është risi në legjislacionin e Kosovës. Hartohet për herë të parë dhe bën pjesë në vazhden e kompletimit të legjislacionit tonë nga sfera e shërbimeve sociale dhe familjare. Ndërkohë dihet që në Kosovë problemet sociale janë të ndryshme dhe komplekse. Ky projektligj i ka veçantitë e veta, sepse ka për qëllim që familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme t'u ndihmohet në pikëpamje financiare, në mënyrë që të zbuten problemet e tyre, duke pasur parasysh se kjo kategori e fëmijëve ka nevojë për një përkujdesje të shtuar dhe të veçantë dhe në këtë mënyrë. Kjo përkujdesje bartë në vete një kosto financiare mjaft të lartë për familjen e shoqërisë kosovare.

Do të duhej theksuar se Projektligji siguron një bazë të mirë legjislative sa i përket kësaj përkrahjeje dhe po ashtu siguron përmirësim të praktikave të punës sociale nëpër qendrat e punës sociale. Po ashtu krijon parakushte për zhvillim të programeve të politikave sociale në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës së kësaj kategorie sociale.

Projektligji siç u tha, parashihet që të trajtojë fëmijët moshës 1 deri 18 vjeç dhe besohet si i këtillë jetë një hap i mëtejshëm me ndërtim të një sistemi të qëndrueshëm të sigurimit të përkrahjes sociale dhe të kompletimit të këtij sistemi. Në veçanti do të duhet

theksuar se me këtë ligj krijohen mundësi në drejtim të deinstitutionalizimit, si një qasje e re e përkrahjes sociale të kësaj kategorie.

Në përgjithësi ligji siguron zgjidhje adekuate dhe të avancuara për këtë fushë .7 kapitujt e tij janë të hartuar në përputhje me standardet e legjislacionit dhe dispozitat të cilat janë të qarta dhe konkrete. Po ashtu janë në përputhje me standardin ndërkombëtar edhe në veçanti me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve të UNICEF-it. Si i tillë i plotëson kushtet që të miratohet në leximin e parë dhe të krijohen mundësitë që sa më parë të fillojë të zbatohet.. Ajo që u tha nga ana e ministrit, se llogaritet se janë gjithsej 3000 fëmijë që kanë nevoja të këtilla, do me thënë janë gjithsej 3000 familje që ballafaqohen me nevojën e ndihmës në këtë plan, sigurisht se do t'i kushtojë në një mënyrë buxhetit të Kosovës. Mirëpo duke ditur rëndësinë e veçantë që ka kjo mbështetje, kjo përkrahje do të duhej të bëhen të gjitha përpjekjet që të gjendet mundësitë që ky ligj pas miratimit të jetë i zbatueshëm plotësisht

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet miratimin në leximin e parë të këtij projektligji dhe do të kontribuojë në përmirësimin dhe plotësimet eventuale në leximin e mëtutjeshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputetja Flora Brovina, në emër të PDK-së.

FLORA BROVINA – I nderuari Kryetar, ministër, kolegë dhe kolege,

Është ky ligj i parë që vjen në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, për atë kategori më të ndjeshme të tyre, të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe me nevoja për asistencë, ose siç quhet Ligji për përkrahje materiale të familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme. E them këtë duke e tërhequr vërejtjen se Qeveria shumë pak ligje ka sjellë në mbrojtjen të drejtave të fëmijëve në Kosovë. Kosova lavdërohet me strukturën e re të popullatës, por kur fëmijët nuk i gëzojnë të drejtat e tyre të plota, sikur që i gëzojnë fëmijët kudo në botë, ose e veçoj, edhe në shtetet e rajonit. Fëmijët tanë nuk marrin as shtesa të fëmijëve, ndërsa fëmijët, familjet që kanë fëmijë më të madh se 5 vjeç, ata janë të privuar nga këto shtesa të fëmijëve atëherë kur familjet janë të varfra dhe pamundësi që ata t'i ushqejnë dhe t'i mbathin mirë.

Është e çuditshme kjo nga ana e Ministrisë pasi që dihet se fëmijët mbi moshën 5 vjeçare kanë më shumë nevoja për veshmbathje, për ushqim dhe për shkollim. Ky projektligj na nxit të mendojmë se sa në mënyrë të koklavitur është ndërtuar skema sociale në Kosovë në përgjithësi, kështu që politika sociale ka nevojë për ndryshime herë pas here.

Para sa kohësh, këtu në Parlament u miratua Ligji për, siç u quajt gabimisht, rehabilitimin profesional të personave me aftësi të kufizuara. Në të vërtetë ky ligj duhej të quhej: Ligji për aftësimin profesional. U bë mirë që u miratua ky ligj që lidhet drejtpërsëdrejti edhe me Ligjin që e diskutojmë sot, sepse këto ligje së bashku me Ligjin e punës dhe Ligjin për pensionet i dalin në ndihmë kësaj skeme sociale. Këta fëmijë, sigurisht duhet të kenë kushte më të mira të jetesës, arsimim adekuat dhe të aftësohen nesër për punë. Pse ndodhë kështu që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të na

sjellë ligje jo me një renditje çfarë duhet, por ligje që vijnë njëri para tjetrit. Ta zëmë Ligji për aftësimin profesional vjen përpara, ndërsa nuk vjen Ligji i punës ose i pensioneve ose ky ligj vjen pas tyre. Kështu ndodhë, sipas mendimit tim, sepse nuk ekziston një plan i mirëfilltë pranë kësaj Ministrie. Shpeshherë këto ligje sillen vetëm për ta plotësuar normën e mandatit. Edhe ky ligj nuk ka hyrë në skemën sociale për vitin 2008 – 2010 dhe e kam vështirë ta kuptoj se do të aplikohet gjatë këtij mandati, aq më tepër që edhe buxheti që parashihet ka dy variante – që dallohen shumë njëri nga tjetri, madje aq tepër dallohen sa që varianti i parë është dyfish më i lartë se varianti i dytë – 8.182.500 euro është varianti i parë, ndërsa 4.942.500 euro është varianti i dytë. Kjo dilemë është jo serioze për një ligj, siç shihet të pastudiuar mirë. Thuhet se në Projektligj kjo varet nga numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe lartësisë së përkrahjes materiale. Kur përgatitet një ligj, Ministria duhet ta dijë numrin e shfrytëzuesve të këtij ligji, pastaj edhe sigurisht edhe shumën që do ta fitojnë këta. Prandaj, kjo çështje sigurisht se do të rregullohet më vonë.

Partia Demokratike nuk është për ta refuzuar Ligjin, përkundrazi e quajmë si një ligj me përparësi të veçanta. Kemi pasur rastin që të kemi edhe ligje të tjera nga kjo Ministri që kanë merituar të refuzohen, por për shkak të çështjes delikate të trajtimit të vetë fituesve të këtyre ligjeve ne nuk i kemi refuzuar, por kemi dhënë kontributin tonë që këto ligje të bëhen sa më funksionale. Këtë do ta bëjmë edhe me këtë ligj. Vërejtjet tona do t'i bëjmë në rend të parë në lidhje me statusin e personit, gjegjësisht të fëmijës me aftësi të kufizuara ose me nevojë për asistencë dhe me futjen e terminologjisë humanitare në Ligj, me harmonizimin e kuptimit të fjalës familje, sepse në ligj nuk funksionon gjithherë sikur në ligjet e tjera, sidomos me Ligjin e familjes, me harmonizimin e Ligjit për shkollim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, pastaj me aftësimin profesional dhe të Ligjit për entet parashkollore.

Zhvillimi i një shoqërie matet me përkujdesjen që ajo shoqëri ka ndaj atyre që janë me nevoja të veçanta, sidomos kur është fjala për fëmijët jetim, për fëmijët viktime civile të luftës, fëmijët që jetojnë në varfëri të skajshme, e të tjera. Kjo pritet edhe nga shoqëria jonë dhe nuk lidhet vetëm me buxhetin e varfër të Kosovës, por edhe me qasjen dhe organizimin më të mirë të vetë shoqërisë dhe sidomos të institucioneve përgjegjëse. A kemi mundur gjatë këtyre 8 viteve këtë ta bëjmë më mirë? Sigurisht që po. A kemi ditur? Kjo është pyetja që shtrohet para vetë Ministrisë dhe para neve në Parlament. Besoj që ligji gjatë procedurës së ardhshme në Komision, do të plotësohet dhe përmirësohet. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të AAK-së, Myrvete Dreshaj.

MYRVETE DRESHAJ - Ju faleminderit zoti. Kryetar, zoti ministër, kolegë deputetë,

Projektligji për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershëm është më se i nevojshëm. Meqë vetëm kategoria e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme prej moshës 1 – 18 vjeç, më saktësisht prej 5-18 vjeç, që kanë nevojë për ndihmën dhe kujdesin e familjes nuk ka qenë e rregulluar me Ligjin nga sfera e shërbimeve sociale dhe familjare.

Familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme, jo vetëm që përballen me rritjen e fëmijëve që kanë vështirësi në zhvillim dhe aftësim për jetë të pavarur dhe që emocionalisht bartin një gjendje të rëndë psikologjike, por duhet të përballen edhe me vështirësi materiale, për arsye se për rritjen e këtyre fëmijëve, shpenzimet janë më të mëdha. Duhet të kemi parasysh se këta fëmijë kanë nevojë vazhdimisht për terapi, se shumica prej tyre kanë sulme epileptike, lëvizin me karroca ose mjete të tjera ndihmëse ortopedike, si dhe kanë nevojë për përdorimin e përhershëm të mjeteve shtesë higjienike.

Qëllimi i këtij projektligji është që të ndihmohen këto familje me ndihmë materiale të përhershme dhe të rregullohen çështjet e tjera të nevojshme në këtë sferë, në mënyrë që t'u mundësohet këtyre fëmijëve të bëjnë një jetë normale dhe të denjë. Në projektligj përkufizohen saktësisht mënyra e dhënies së ndihmës materiale, puna dhe përbërja e komisioneve mjekësore, si dhe çështjet e tjera të cilat do të rregullohen me akte nënligjore. Megjithatë, në këtë projektligj ekzistojnë disa paqartësi, sidomos sa i përket kostos buxhetore të paraqitur me dy alternativa, si dhe paraqitja aproksimative e numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara që supozohet se është 3000. Edhe tek dokumenti përcjellës i Qeverisë, i Projektligjit, Grupi Parlamentar kërkon mundësinë rishikimit të pikës 2 dhe 4 me interes të një ofrimi kohor, duke pasur parasysh nevojën emergjente për ndihmë nga kjo kategori e veçantë shoqërore.

Grupi Parlamentar i AAK-së e përkrah në parim Projektligjin dhe do të japë kontributin e duhur me përfaqësuesin e vet në Komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Nga ORA, Fatmire Mulhaxha.

FATMIRE MULHAXHA – Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Fillimisht dëshiroj të shfrytëzoj rastin, të shpreh vërejtjen në pjesën, udhëheqjen e seancës në pjesën e para ditës, kur Grupi Parlamentar ORA, në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, është privuar nga e drejta që në bazë të shkresës së dërguar Kryesisë së Kuvendit, kur në mënyrë taksative, decidive shkruan se sipas Rregullores pikës 25.9 propozojmë këtë rekomandim: - Të formohet Komisioni Hetimor Parlamentar, i cili do t'i hetojë përgjegjësinë e të gjithë atyre që kanë bërë shkelje të ligjit dhe të rregullave në këtë proces tenderimi. Kërkesa ka qenë me shkrim. Së paku kjo duhet të respektohet, përkundër faktit që edhe shumë propozime që me gojë parashtrihen, më tepër respektohen. Prandaj, ju kryetar nuk keni qenë aty, por po ju informoj që është bërë shkelje, prandaj ne protestojmë. Nuk kemi pasur mundësi që të shprehemi në fund të seancës se është përfunduar në mënyrë arbitrare. Deputetë janë ngritur dhe e kanë lëshuar sallën, prandaj kërkojmë që kjo të merret parasysh. Ju faleminderit! Kërkoj falje që u detyruam në këtë mënyrë të ndërhyjmë. Prandaj, tash po e shfrytëzoj rastin që të vazhdoj të debatoj për pikën e rendit të ditës që është: Miratimi në parim i Projektligjit për ndihmë familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme.

Më vjen keq që përkundër dëshirës së mirë të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenies Sociale, që në mandatin e vet, në këtë mandat, do të thotë, në krye me ministrin Selmanaj, ka vullnet dhe dëshirë që ta sjellë një projektligj të tillë në Kuvend për miratim, për faktin se është ligj i domosdoshëm, ligj që duhet të tregojë përkujdesjen

për ata fëmijë që janë fëmijët më të prekur dhe janë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme. Mirëpo, përkundër faktit që shuma prej 3.6 milion euro që megjithatë është shumë jo aq e madhe nëse e krahasojmë me shpenzimet e shumta që sot derdhen për shumë destinacione të ndryshme të panevojshme, kemi në vendim të Qeverisë që askush deri tani nuk e theksoi që propozimi i Kryeministrit Agim Çeku, është që zbatimi i këtij Projektligji të fillojë në vitin 2011. Këtë duhet ta dinë të gjithë familjarët, sidomos nëse kihet parasysh edhe deklarata financiare e bashkëngjitur Projektligjit ku në mënyrë shumë të qartë thuhet që Rekomandimi i Ministrisë së Financave është se duhet të merren parasysh politikat e Qeverisë së Kosovës dhe korniza afatmesme e buxhetit 2008 -2010, ku nuk do të ketë zgjerim të ndihmave, të skemave të ndihmave sociale ekzistuese, e me këtë as përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme. Prandaj, ky është njëri ndër projektligjet të cilat Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale tanimë i ka një në tavolinën e vet dhe nuk di çka të bëjë me to. Janë projektligje të dëshirave dhe të vullnetit të mirë, por të pamundësive për implementim. Cila është sfida jonë? Ta refuzojmë sot dhe të bëjmë një gjë që asnjë njeri normal nuk mund ta bëjë, t'i thotë jo një projektligji të tillë, apo t'ia japim në parim pëlqimin dhe mandej të qajmë kokën se si do të na vijë Fondi Monetar dhe të na thotë: - A është ky Kuvend që miraton projektligje për të cilat në fillim e dinë që diku ndoshta pas nja 10-15 vjetësh do të kenë mundësi implementimi?! Prandaj, edhe një herë dëshiroj që ministri, në fjalën e vet përmbyllëse, të na sigurojë se ajo dëshira e Ministrisë a është në përputhje me vendimin e Qeverisë, se përndryshe, këtë ligj është dashur ta nxjerrë një qeveri e ardhshme dhe një qeveri e cila nuk është në gjendje ta bëjë këtë. Ne jemi në vitin 2007, kjo do të mbetet për vite e vite në dëshirën e mirë, në ligj vetëm në letër, ndërsa familjarët do të trokasin në dyert e Ministrisë me kërkesë që të fillojë implementimi i tyre. Të jeni të sigurt që fjalën përfundimtare, megjithatë, do ta kenë familjarët e këtyre fëmijëve në amendamentim se ekzistojnë shoqatat të organizuara shumë mirë, shoqatat shumë mirë të informuara, të cilave edhe personalisht ua kam sjell kopjet e projektligjit, të cilët me bindje të plotë janë duke pritur fillimin e implementimit. Prandaj, të mos të luajmë me ndjenjat e atyre, të mos luajmë me ndjenja se kryesisht janë familje që janë në buzë të ekzistencës dhe nuk kanë mundësi t'iu sigurojnë as kushtet elementare, as një karrocë që ta shohin dritën e diellit. Ato nga kjo Qeveri nuk e kanë marrë asnjëherë së paku një karrocë, por i kanë marrë nga donacionet e ndryshme, nga dashamirët, nga njerëz me vullnet të mirë nga mbarë bota. Prandaj, dëshirat e mira unë i kuptoj, por dëshiroj që ato dëshira edhe të realizohen. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Grupi 6+, Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI - Hvala!

Poštovani presedniče, ministre, kolege poslanici,

U mnoštvo socijalnih problema koje zaokružuju kosovsko društvo, vrlo je značajno što je danas pred nama jedan Predlog zakona koji ima za cilj pružanje potpore i pomoći porodicama koje se brinu za decu sa trajnim poremećajima i oštećenjima.

Poseban značaj ovog Nacrta zakona je ne samo u tome što pruža pomoć porodicama, čija deca imaju potrebe za posebnom negom i brigom, lekovima, pomagalima i slično, već je u tome što ta deca zaslužuju da žive i bolje i dostojanstvenije kao deo našeg društva.

Radi se o deci od 1. do 18. godina, kojima je neophodna pomoć prilikom obavljanja svakodnevnih životnih aktivnosti. Takodje, ovaj Nacrt zakona podstiče i poboljšanje praktičnog socijalnog rada u centrima za socijalni rad. Posebno smatramo značajnim član 18. koji uređuje da materijalnu podršku može realizovati osoba, tačnije porodica bez obzira na njegovo ili porodično materijalno stanje, ukoliko ima dete sa stalnim ograničenim sposobnostima. Ono što bi trebalo uraditi jeste obratiti pažnju na način određivanja visine materijalne pomoći porodicama. U Nacrtu se navodi da će to biti uređeno podzakonskim aktom, kao i na finansijsku deklaraciju koja nudi dve varijante. Inače, Nacrt zakona je izradjen sa jasnim odredbama, konkretnim i preciznim i Parlamentarna grupa 6+ smatra da ovaj N/zakona ispunjava uslove za jedan zakon ovakve prirode i u načelu ga podržava. Hvala!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Nga Grupi për Integrim, deputeti Agani.

FERID AGANI - Ju faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar për Integrim e ka shqyrtuar tekstin e Projektligjit. Konsideron se kemi të bëjmë me një dokument jashtëzakonisht të rëndësishëm ligjor, një dokument i cili merret me një kategori shumë të ndjeshme të popullatës së Kosovës, e cila që 8 vjet ka qenë lënë anash nga përkujdesi i domosdoshëm institucional. Konsiderojmë se Projektligji përmban një seri të dispozitave mjaft të mira të përpiluara në një gjuhë juridike të qartë dhe në mënyrë substanciale konsiderojmë se do ta rregullonte këtë lëmi ligjore. Ajo që për Grupin Parlamentar për Integrim është e çuditshme, në këtë procedurë është se si paraqitësi i Ligjit, sponsori i ligjit, Qeveria e Kosovës, del para deputetëve të Kosovës me dy akte, të cilat janë në kundërshtim me njëri – tjetrin. Unë kam dilemë se si të procedojmë me këtë projektligj më tutje. Kisha pasur dëshirë që edhe ministri që është prezent, unë e përshëndes, të na jep një sqarim në lidhje me këtë. Konkretisht e përmendi edhe parafolësja se me vendimin e 27 qershorit të vitit 2007, Qeveria e Kosovës, zbatimin e këtij projektligji e përcakton që nga vitit 2011, ndërsa neni 27 i këtij projektligji thotë se ky ligj hyn në fuqi pasi të miratohet nga Kuvendi i Kosovës dhe pas shpalljes në "Gazetën zyrtare" të Kosovës. Pra, cila është e vërteta këtu? A është kjo që na duhet të vendosim për njërin prej këtyre dy solucioneve dhe çfarë kuptimi do të kishte miratimi i këtij projektligji në qoftë se ky duhet të fillojë të zbatohet pas katër vjetëve. Kjo nënkupton vetëm rritjen e pritjeve të popullatës, nxitjen e popullatës, vërtet për një projektligj shumë të nevojshëm, ndërsa në anën tjetër mosplotësimin e këtyre nevojave deri në vitin 2011. Propozimi i Grupit Parlamentar për Integrim është që ky projektligj të tërhiqet nga procedura, t'i kthehet Qeverisë, të harmonizohen këto dispozita të Projektligjit dhe të vendimit të Qeverisë dhe të dilet para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, me një tekst të unifikuar të projektligjit. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Nga LDD-ja, Milazim Haliti.

MILAZIM HALITI - Zoti Kryetar,
Zoti ministër,
Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, me vëmendje ka shqyrtuar Projektligjin për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme dhe vlerëson se Projektligji është i hartuar mirë, ka strukturën e duhur ligjore dhe si i tillë duhet të miratohet nga Kuvendi. Trajton një çështje shumë të rëndësishme të një kategorie që kanë nevojë të madhe për përkrahje materiale. Janë këto familje që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, e cila përkrahje u ka munguar. Këto raste kanë nevojë të madhe që të ndihmohen financiarisht që sadopak t'i zbusin problemet e tyre sociale. Ky projektligj do të jetë një vazhdimësi e kompletimit të legjislacionit të kësaj fushe të shërbimeve sociale.

Projektligji ,përveç dispozitave themelore ku parashihen përkufizimet me të cilat shpjegohen shprehjet dhe kuptimet e tyre, parashihet realizimi i së drejtës së ndihmës materiale, pastaj Komisioni mjekësor i ekspertëve ... dhe kategorizimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara, procedura për ekspertizë, mjetet financiare, parashtrimi i kërkesës dhe e drejta e ankimit.

Me miratimin e këtij Projektligji do të përfitojnë familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme , prej moshës njëvjeçare deri në moshën 18 vjeçare. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale do të sigurojë përkrahje materiale, varësisht nga mundësitë buxhetore. Duke pasur parasysh angazhimet e familjarëve për këtë kategori të personave me aftësi të kufizuara, do të ishte më humane aplikimi i alternativës së parë ku parashihet shuma për pagesë prej 100 eurosh. Përkundër vlerësimeve pozitive ky projektligj ka nevojë edhe për disa plotësime dhe korrigjime që të jetë më i kompletuar. Vërejtjet tona kanë të bëjnë me nenin 21, paragrafi 2 ku thuhet se: “Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me akt të veçantë mund të kërkojë edhe dokumente të tjera, përveç atyre të parapara me nenin 19 dhe 21, e që mendojmë se edhe ato duhet të parashihen me projektligj, që të mos lihet mundësia e veprimit ndryshe për disa raste , apo persona të caktuar”. Pastaj te dispozitat kalimtare, neni 25 nuk e ka karakterin obligues kur thuhet: “ Për zbatimin e ligjit, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale mund të nxjerrë akte të tjera nënligjore, e që mendojmë se do të duhej- Ministria përkatëse duhet të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e këtij projektligji”. Përkundër këtyre vërejtjeve të theksuara, të cilat besojmë se do të korrigjohen dhe plotësohen nga Komisioni Funkcional, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e përkrah në parim miratim e këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Naxhije Doçi.

NAXHIJE DOÇI – Ju faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari zoti kryetar,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë dhe të gjithë ju të pranishëm në këtë sallë,

Fëmijët me aftësi të kufizuar janë fëmijët që kanë zhvillim të ngadalësuar apo që janë të diagnostifikuar profesionalisht se kanë gjendje të atillë shëndetësore, pra që kanë plotësisht mungesë të zhvillimit fizik apo mental në një apo në më shumë aktivitete të jetës.

Sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, fëmijët me aftësi të kufizuara janë fëmijët prej moshës një deri në tetëmbëdhjetë vjeç që kanë të drejtat e njëjta sikurse edhe fëmijët e tjerë. Kanë të drejtë për kujdes të veçantë dhe për pranim të diferencave, për arsimim dhe për edukim gjithëpërfshirës që ata të gëzojnë jetë të përshtatshme dhe me dinjitet të plotë, në mënyrë që të arrihet tek ata vetëbesimi dhe mundësia më e lehtë për jetë normale dhe për integrim social me të tjerët. Që një gjithëpërfshirje e tillë të realizohet me sukses është e nevojshme ndihmesa dhe bashkëpunimi i ndërsjellë i partnerëve të interesuar për përkujdesjen ndaj fëmijëve të tillë. Bashkëpunimi me familjen është shumë i rëndësishëm, sepse familja është e obliguar që të ballafaqohet me vështirësitë dhe me problemet në mbrojtjen dhe në përkujdesjen e fëmijëve të tillë të tyre. Ata i njohin më së miri të fshehtat e karakterit të fëmijëve të tyre, sjelljen e ndrojtur të tyre, imagjinatën dhe shkallën e shoqërizimit të tyre.

Projektligji për përkrahje familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme, i ofruar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale si projektligj i domosdoshëm është vetë garantimi me ligj që i bën Kosova të drejtave të fëmijëve në territorin e saj sipas Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, si dhe vetë rregullimi me ligj për përkrahje material-financiare familjeve të cilat i ruajnë dhe kujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme.

Është një projektligj i ri dhe mjaft i avancuar në renditjen e kompletimit të legjislacionit për çështje të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovën e pasluftës 1999, që do ta zëvendësojë Ligjin për mbrojtjen sociale të vitit 1976, me pjesët nga kjo fushë, të cilat janë të vjetruar dhe me plot mangësi për kohën në të cilën po jetojmë. Projektligji për familjet e fëmijëve me aftësitë e kufizuara të përhershme që u ofrojnë ndihmë dhe kujdes fëmijëve të tillë, parasheh përkrahjen në formë të kompensimit mujor në të holla në pajtim me mundësitë buxhetore të Buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Kujtoj se lartësia e skenarit të parë, të përkrahjes materiale prej 100 euro është e qëlluar dhe duhet të përkrahët në këtë Parlament.

Ky projektligj, nuk i cenon parimet e legjislacionit të Bashkësisë Evropiane dhe është hartuar sipas ligjeve të njëjta të vendeve të rajonit me përshtatshmëri sipas kushteve tona në Kosovë. Mendoj se titulli i këtij Projektligji duhet të jetë- Projektligji për ndihma materiale e tjera, e jo Projektligji për përkrahje materiale, sepse këto dy fjalë përkrahje dhe ndihma edhe pse janë fjalë shumë të përafërta njëra me tjetrën, kanë dallime në kontest. Përkrahja është më tepër me fjalë e jo për të ndihmuar materialisht. Për shembull, përkrahje e fuqishme; përkrahje e së resë e tjera, ndërsa ndihma është kur i jep të holla një njeriu apo një grupi njerëzish që kanë nevojë. E ndihmoji me të holla, me libra etj. Në faqen katër të hyrjes, ku shkruan vendim, nën pikën 2 theksohet, citoj: “Zbatimi i këtij projektligji fillon nga viti 2011”. Sipas mendimit tim kjo thënie bie ndesh me nenin 25, paragrafi 2 të këtij Projektligji ku thotë: “Njohja e së drejtës për përkrahje materiale njihet nga data e aplikimit për këtë të drejtë”, ndërsa te kostoja buxhetore e vitit 2007, po ashtu në këtë Projektligj, pritet që ky ligj do të miratohet nga Kuvendi i Kosovës dhe do të nënshkruhet nga PSSP-ja në muajin shtator. Sido që të jetë, nëse vërtet zbatimi i këtij Projektligji fillon nga viti 2011, kjo do të thotë edhe katër vjet që është kohë shumë e gjatë e familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, e sidomos fëmijët invalidë të luftës së fundit, kanë nevojë urgjente për ndihma.

Te kostoja financiare është dhënë një pasqyrë financiare prej viti 2007 – 2009 ,mbase si të ndihmohen familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme. Sipas shkallës së përcaktimit të fëmijëve për ndihma nga komisionet mjekësore të monitoruar dhe të administruar nga Departamenti i Mirëqenies Sociale, përmes qendrave për Punë Sociale. Fondi prej 1 milion e 63 mijë e 614 euro me 20 të punësuar për t'i ndihmuar si duhet këto familje, mendoj se është i vogël për 3000 e më shumë fëmijë me aftësi të kufizuara.

Në kreun e tretë dhe të katërt të Projektligjit bëhet fjalë për komisionet mjekësore të shkallës së parë dhe të dytë rreth ekspertizës së gjendjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në nenin 16, pika 2 e kreut të katërt përmendet në mënyrë të përgjithësuar shpërblimi i kryetarit, i anëtarëve të Komisionit pa e cekur mënyrën e pagesës dhe lartësinë e kompensimit me arsyetimin citoj: “Mënyra e pagesës caktohet me aktin e caktimit të ekspertëve ose me akt tjetër të veçantë”. Propozoj që me një pikë shtesë të nenit në fjalë, të konkretizohet shuma e të hollave në euro, si për kryetarin ashtu edhe për anëtarët e Komisionit për ekspertizë, qoftë si ndihma në të ardhura mujore apo për mbledhje kur mban Komisioni gjatë dy vjetëve të mandatit të tij se një konkretizim i tillë e bënë ligjin më të hapur dhe më të fuqishëm si vlerë ligjore.

Nuk mund të lë pa e thënë se edhe në këtë projektligj si edhe në të tjerët ka gabime gramatikore, ndoshta më tepër lëshime teknike e që nuk është mirë të tolerohen si të tilla. Ka edhe gabime sintaksore që ndikojnë dëmshëm në kuptueshmërinë logjike të neneve. Propozoj që të bëhemi më të kujdesshëm në këtë aspekt, pra që ta lekturojmë mirë projektligjin që të dalë mirë edhe gjuhësisht ky ligj ashtu si është e mirë përmbajtja e Projektligjit, ashtu siç është i mirë edhe qëllimi i tij.

Në fund po e ceku se e përkrah në parim Projektligjin me bindjen se në Komisionin Funksional do të plotësohet dhe do të amendamentohet me vlerësimet e dobishme që do të jepen në këtë Kuvend të nderuar. Ju faleminderit zoti kryetar.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputetja Teuta Hadri..

TEUTA HADRI – Të nderuar deputetë,
I nderuari zoti Kryetar,

Të gjitha projektligjet e shqyrtuara dhe të miratuara deri më tani në këtë Parlament, kanë pasur rëndësinë e vet. Një rëndësi të veçantë ka edhe shqyrtimi i sotëm i Projektligjit për përkrahje materiale të familjeve, të cilët ruajnë dhe përkujdesen për fëmijët e tyre që janë me aftësi të kufizuara të përhershëm.

Thuhet se është një formë e re e Projektligjit për Kosovën. Mund të themi se po, ndoshta si projektligj i veçantë, e nuk mund të themi si mbështetje dhe përkrahje e këtyre kategorive.

Të nderuar deputetë,
T’ju përkujtojmë se edhe më parë këto kategori kanë pasur mbështetje dhe përkrahje nga familjarët edhe para luftës. Kanë pasur përkrahje edhe sipas Rregullores së punës së

Qeverisë së Kosovës. Edhe në Ligjin e shëndetësisë, në Ligjin e shërbimeve sociale dhe familjare, Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor. Prandaj, duhet të mendojmë për vlerat e punës së institucioneve tona dhe të atëhershme e jo të themi se po na mbinë diçka e re. Mund të themi se ky projektligj do të promovojë dispozita për përkrahje materiale familjeve të cilat ruajnë dhe përkujdesën për fëmijët e tyre, të cilët janë me aftësi të kufizuara të përhershme. Qëllimi kryesor është të nxisë moralin për përkueseje, për përkrahje të këtyre kategorive, e cila do të do të mundësohet me ligj dhe me akte nënligjore për ndihmë financiare këtyre përkrahësve. Kjo formë e përkrahjes bëhet dhe sigurohet vetëm në formë ligjore mes institucioneve të Kosovës dhe qendrave për punë sociale. Për përmirësimin e kushteve duhet të hartojmë politika, strategji, programe për këto kategori që Kosova me gjithë problemet sociale të mëdha që ka, varfëri, papunësi, çështja e pensioneve dhe grumbullimi i shumë problemeve sociale të pasluftës, do ta mbështesë këtë kategori të ndihmëtarëve, se me vullnet t'u ofrojnë ndihmë, ngrohtësi, jetë këtyre personave me aftësi të kufizuara. Mirëpo, i nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë, unë e kam një vërejtje thelbësore, mund të them edhe bazike të ky Projektligj. Ndoshta projektuesit nuk e kanë menduar, ndoshta e kanë menduar, është bërë lëshim. Këtu në këtë projektligj thuhet se ndihmë do t'u ofrohet të gjithë atyre personave prej moshës 1 deri në 18 vjeç, por këta persona janë me aftësi të kufizuara të përhershme siç thuhet edhe në Projektligj. A është paraparë të miratohet edhe ndonjë projektligj tjetër prej moshës 18 vjeçare, do me thënë prej moshës 1 – 18 vjeçare të mbrohet nga sponsori apo Buxheti i Kosovës. Mirëpo çka do të bëhet me këta persona të nderuar deputetë pas moshës 18 vjeçare kur nevoja më e madhe e këtyre personave, qoftë nga ngarkesa e peshës apo e përgjegjësisë duhet dikush nga familja pas moshës 18 vjeçare t'i mbështes. A është paraparë zoti ministër, jeni ju këtu të bëhet edhe një ligj i veçantë, kështu ashtu Buxheti i Kosovës a është i ngarkuar. Ky projektligj, ne siç e pamë, është mjaft i ngarkuar për buxhetin. A do ta bëni edhe një projektligj pas moshës 18 vjeçare? Prandaj, si deputete propozoj se kjo kategori, kështu ashtu e ngarkon buxhetin mjaft dhe të mos lihet hapësirë për këtë, pas moshës 18 vjeçe që të vendos ky Parlament, që këtyre personave t'u jepet ndihmë edhe pas moshës 18 – vjeçare, derisa ata janë gjallë Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka Gjulshen Berisha.

GJULSHEN BERISHA – Ju faleminderit Kryetar i Parlamentit,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,

E kam lexuar disa here këtë projektligj, sepse më ka interesuar kjo kategori e fëmijëve dhe kam parë shtimin e interesimit të shoqërisë sonë ndaj kësaj kategorie. Prandaj e përshëndes hartimin e këtij projektligji për përkrahjen materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, si një projektligj jo vetëm për të plotësuar zbrazëtirat juridike, sepse në Kosovë një ligj i tillë hartohet për herë të parë, por si një ligj që vë në mbrojtje të drejtat e fëmijëve, veçanërisht fëmijët me aftësi të kufizuara.

Përkrahja materiale për këta fëmijë është edhe përkrahje morale, që dëshmon që shoqëria jonë do të ketë një nivel më të lartë të vetëdijesimit në këtë punë sa humane, aq edhe të natyrshme, për një jetë më të dinjtetshme të kësaj kategorie dhe kësaj moshe të fëmijëve.. Unë kam disa vërejtje të cilat në procedurën e amendamentimit mund të

merren parasysh nga Komisioni Funkcional. Kam vërejtje në nenin 18, pika 3, ku thuhet : “Kërkesa nuk mund të paraqitet para se fëmija me aftësi të kufizuara të përhershme të ketë arritur moshën njëvjeçare”. Mendoj se kërkesa duhet të bëhet më herët që fëmija kur ta mbushë moshën njëvjeçare ta realizojë këtë të drejtë. Disa deputetë theksuan se që tetë vite Qeveria nuk është marrë fare me ta. Unë them se jo vetëm këto tetë vjetët e fundit, por në vazhdimësi ka munguar kujdesi i duhur institucional për këta fëmijë. Ne e dimë që kohëve të fundit, në këto disa vite të fundit ,nëpër shkolla janë hapur paralele të bashkëngjitura që përkujdesen, mirëpo ato nuk mund t’i përfshinë të gjithë ata fëmijë, sepse ka ende familje të cilët nuk i paraqesin.

Me zbatimin e këtij Ligji, do të ngritët në nivel më të lartë kujdesi i përgjithshëm dhe do të krijojë një siguri dhe perspektivë për një jetë më të mirë. Në funksion të kësaj do t’i propozoja Komisionit Funkcional një amendament që ka të bëjë me formimin dhe financimin e këshillimoreve për përgatitjen e prindërve për punën e tyre me këta fëmijë. Projektligji parasheh komisionet për vlerësimin e shëndetit të fëmijëve. Unë propozoj edhe këshillimore për aftësimin e prindërve për përkujdesje adekuate të këtyre fëmijëve. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ilaz Pireva.

ILAZ PIREVA – Zoti kryetar,
Zotërinj ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Si anëtar i Komisionit Funkcional desha edhe unë të jap një kontribut timin lidhur me këtë projektligj për përkrahjen materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Që në fillim, pajtohem që ky ligj duhet të miratohet në parim. Këtë e tha në emër të Grupit Parlamentar, zoti Jerliu dhe e thanë edhe disa të tjerë.

Megjithatë, unë pajtohem edhe me vërejtjet paraprake, me vendimin e Qeverisë që ky ligj duhet të hyjë në fuqi në vitin 2011, që bie ndesh me nenin 27 të këtij projektligji, i cili thotë se Ligji hyn në fuqi , pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës. Këtë dilemë duhet të na e heq, po mendoj Ministria, faktikisht sponsori i këtij ligji. Gjithashtu, ka edhe vërejtje të tjera, prej përkufizimeve lidhur me familjen ,ose edhe bashkësinë familjare, të cilën përkufizim ne duhet ta marrim nga Ligji për familjet, sepse po na dalin disa përkufizime ç’ është familja? Po ashtu, kam vërejtje edhe në përbërjen e Komisionit për vlerësimin e aftësive të kufizuara të përhershme. Këtu thuhet se anëtarët e atij komisioni, prej kryetarit dhe anëtarëve duhet të kenë nga 5 vjet përvojë pune. Unë nuk di pse parashihet ai kriter. Po ashtu, këtu shohim se duhet të ketë edhe specialistë nga fusha e otorinolaringologjisë, ndërsa kjo kategori nuk përfshihet në këtë projektligj. Kam edhe vërejtje të tjera të natyrave të ndryshme, të cilat besoj se do të arrijmë që t’i mënjanojmë në Komisionin Funkcional.. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Me qenë se nuk ka më kandidat të paraqitur për diskutim... Urdhëroni zoti ministër! Ministri e ka fjalën.

MINISTRI IBRAHIM SELMANAJ - Ju faleminderit, zoti Kryetar! Për ligjin që po diskutojmë po shihet edhe interesimi i deputetëve. Nuk është hera e parë që e kemi në

dorë, ne si Ministri, por kjo i ka dy vjet që e kemi prezantuar në Kabinetin qeveritar dhe çdo herë arsyetimi ka qenë mungesa e mjeteve buxhetore.

Një propozim që u përmend shumë herë në propozimin e Kryeministrit, ne kemi planin legjislativ para vetës dhe në secilin vit ofrojmë planin legjislativ për hartimin e ligjeve. Njëri prej ligjeve që ka kaluar në Qeveri është Ligji për përkrahje të familjeve me persona me aftësi të kufizuara të përhershme. Është e vërtetë se Ligji për persona me aftësi të kufizuara mbi moshën 18- vjeç trajton personat me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç që nga viti 2002. Por, fëmijët me aftësi të kufizuara nga mosha 1 deri 18 vjeç nuk janë të përkrahur. Secili nga ju ka pasur rastin t'i shohë dhe t'i takojë. Unë i takoj edhe familjarët edhe fëmijët dhe ata janë në gjendje të keqe. Organi më i lartë është Kuvendi i Kosovës. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale i ka të dhënat e veta , përafërsisht kemi 3000 familje. Nuk kemi të dhëna dhe statistika zyrtare që mund të flasin me shifra të sakta sa fëmijë i kemi, por kjo është një nga shifrat më të përafërta çka do të thotë se 3 milion e 600 mijë euro nuk janë shumë për buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Ministria i ofron përkrahje Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa .Dihet se organi më i lartë është Kuvendi i Kosovës. Çdo propozim tjetër, pavarësisht rekomandimeve nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, nga Banka Botërore, partnerë të qëndrueshëm, partnerë stabil e të respektuar prapëseprapë ne i trajtojmë fëmijët tonë, ne i trajtojmë familjet tona. Në njërin nga rastet e para kur i kam kontaktuar nën organizimin e TMK-së, e kam ndier veten tepër të fyer, e kam ndier vetën tepër keq, sepse vërtet këto familje e meritojnë më shumë dhe ata fëmijë e meritojnë më shumë. Unë nuk po dua të hyjë në secilën çështje, jo me radhë , jo pa radhë.. Sikur të kishte mundësi që ligji të kalonte në Qeveri dhe sikur ajo t'i kishte mjetet, nuk do ta sillnin në Parlament , sepse Parlamenti nuk do të kishte nevojë të diskutonte për këtë. Problemi qëndron pikërisht në atë se këto mjete buxhetore, lejohen kur Komisioni Parlamentar, përkatësisht Parlamenti e miraton ligjin, Në momentin kur ligji është i nënshkruar, të gjitha mundësitë dhe format do t'i përdorim që ai të zbatohet. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, zoti ministër! Urdhëroni zonja Hadri.

TEUTA HADRI – Zoti ministër, desha edhe një herë për të njëjtën kategori të individëve me aftësi të kufizuara, a do t'i bëni, ju pyeta juve, dy ligje, një prej moshës 1 – 18 vjeç ? A do ta bëni edhe ligjin tjetër prej 18 vjeç deri në vdekje. Ju nuk e keni cekur këtu. Nuk është ajo. Është vetëm ndihmë, nuk është ligj i veçantë.

MINISTRI IBRAHIM SELMANAJ – Ligji për persona me aftësi të kufizuara trajton personat me aftësi të kufizuara mbi moshën 18 vjeç të përhershme. Do me thënë është ligj i cili është i zbatueshëm dhe përafërsisht janë 20.000 persona me aftësi të kufizuara që trajtohen përmes këtij ligji. Do me thënë, mbi moshën 18 vjeç ekziston ligji, mungon ligji deri në moshën 18 vjeç.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni zoti Agani..

FERID AGANI – Ju faleminderit, zoti kryetar,

Unë kisha pasur dëshirë që ministri t'i përgjigjet këtij Parlamenti në pyetjen që e bëra në fjalën time. Këtu nuk bëhet fjalë për propozim të Fondit Monetar Ndërkombëtar, që

zbatimi i këtij ligji të fillojë nga viti 2011. Këtu bëhet fjalë për vendimin e Qeverisë nr. 03/257, të 27 qershorit 2007, të nënshkruar nga Kryeministri i Kosovës, në të cilin thuhet se zbatimi i këtij projektligji fillon nga viti 2011. Unë e pyes ministrin a ka logjikë që të miratohet një ligj, i cili do të fillojë të zbatohet nga viti 2011, apo po na sugjeroni që na këtë vendim të Qeverisë mos ta marrim parasysh dhe të procedojmë sipas vendimit të Komisionit Funkcional. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni zoti ministër.

IBRAHIM SELMANAJ – Në marrëveshjen ndërmjet të Qeverisë dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, në letrën e qëllimit të mirë, dikush prej deputetëve e ka lexuar, zonja Mulhaxha me duket, se nuk ka zgjerim të skemave sociale dhe një prej arsyeve që është propozuar në mbledhje të Qeverisë dhe gjithherë në insistimin që ky ligj duhet të procedohet tutje mbi faktin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje edhe është dhënë si propozim vendim në kuadër të Qeverisë. Unë konsideroj, pa e anashkaluar vendimin e Qeverisë, sepse nuk e kam as të drejtën ta them atë, Parlamenti si organ ka të drejtën e vet dhe duhet të bazohemi në momentin kur nënshkruhet nga Përfaqësuesi Special ose Kryetari i Kuvendit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Kandidatja e fundit është Fatmire Mulhaxha – Kollçaku.

FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU – Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Ministri e sqaroi, pjesërisht. Dilema prapë mbetet te vendimi i Qeverisë dhe ky Kuvend duhet të marrë vendim. Vendimin më serioz që do ta marrë është se a do të aplikohet ligji ashtu, siç ka propozuar sponsori, që duhet të fillojë të zbatohet që nga tremujori i fundit i këtij viti. Pra, duhet të jenë mjetet. Është bërë një përlllogaritje aty për tremujorin e fundit 2007. Do të thotë, kjo duhet të vendoset sot edhe në parim. Të mos i lihet Komisionit Parlamentar ky vendim, por në parim të hidhet ky vendim, të mos të pranohet vendimi i Qeverisë. Të pranohet propozimi qysh ka ardhur nga Ministria. Të fillojë implementimi pas miratimit, vetëm me atë kusht. Nëse duam të jemi serioz në Kuvend, duhet ta miratojmë atë propozim. Automatikisht ky vendim të mos hidhet se këtu propozohet që zbatimi i projektligjit të fillojë në vitin 2011, sipas propozimit të Qeverisë, kryeministrit. Do të thotë të procedohet për miratim në Kuvend të Kosovës. Ne nëse nuk e miratojmë këtë vendim, atëherë mund të kalojë në parim dhe të jemi serioz. Nëse mbetet klauzola 2011, t'ia lëmë një qeverie tjetër ta miratojë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Zoti ministër, a keni diçka për të thënë ? Deputetja Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI – Unë mendoj se ligji është akt më i lartë juridik se sa një vendim. Ne nuk po e shqyrtojmë sot vendimin e Qeverisë, por ligjin. Në ligj thuhet se ky ligj hyn në fuqi ditën e miratimit, përkatësisht ditën e nënshkrimit nga PSSP-ja. Qeveria është e detyrueshme ta zbatojë këtë ligj. A do ta zbatojë Qeveria në këtë vit apo jo, ajo i bartë përgjegjësitë e veta. Tash për tash fjala është për ligjin që është akt më i madh, më i lartë, më i fuqishëm se sa vendimi. Edhe ai vendim i Qeverisë në të cilin po thirret deputetja, duhet ta ketë mbështetjen në këtë ligj të cilin po e

shqyrtojmë. Ndërkaq, në këtë ligj askund nuk kthehet se ky ligj do të fillojë të zbatohet në vitin 2011.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Meqenëse nuk ka diskutues të tjerë, tani të votojmë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Në sallë janë 77 deputetë. Votojmë tash.

Për..... 63
Kundër..... 7

Miratohet ligji. Konstatohet se me 63 vota për dhe 7 kundër, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për përkrahjen materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme.

Në bazë të rregullave 23 dhe 35, Kuvendi ngarkon këto komisione:

*-Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si
Komision Funksional dhe Raportues*

*-Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë
Kushtetuese,*

*-Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për
Komunitete.*

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë, ta shqyrtojë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin Raportin me rekomandimet, sipas rregullës 35.6. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 22 shkurt 2007. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet, rekomandimet, si vijon:

-Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për letërnjoftimin ka bazën e vet juridike në Kornizën Kushtetuese.

- Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për letërnjoftimin nuk i cenojnë të drejtat e interesat e komuniteteve.

- Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për letërnjoftimin përmbajnë implikime buxhetore, por duke marrë parasysh rëndësinë dhe qëllimin e këtij projektligji, i rekomandon Kuvendit miratimin e Projektligjit me

amendamentet e propozuara dhe Qeverisë t'i sigurojë mjete të nevojshme buxhetore për zbatimin e ligjit.

Kalojmë në miratimin e amendamenteve:

Amendamenti

Regjia, votojmë tash:

Për 64

Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Për 68

Kundër 1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Për..... 64;

dhe asnjë kundër.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 4

Ka vërejtje deputeti, Nimon Alimusaj. Urdhëroni profesor!

NIMON ALIMUSAJ – Faleminderit zoti kryetar.

Në amendamentin numër 4 që i referohet nenit 2 të Projektligjit thuhet: “Të dhënat biometrike janë të dhëna unike që paraqesin karakteristikat unike të individit dhe shërbejnë për të përcaktuar identitetin nëpërmjet pamjes së fytyrës, pra portretit, shenjave të gishtërinjve, bebëzës së syrit dhe grupit të gjakut.

Unë kujtoj se nuk mund të qëndrojë kjo bebëzës së syrit, sepse këtu kemi sigurisht mjekë dhe mund ta sqarojnë më tepër. Bebëza e syrit nuk ka ngjyrë, ajo duket e zezë e mbyllët tek të gjithë njerëzit dhe nuk identifikohen nëpërmjet bebëzës së syrit. Do të duhej të ishte- ngjyra e syve e jo e syrit, sepse te i njëjti individ, sytë mund të kenë ngjyra të ndryshme. Prandaj, propozoj që amendamenti të jetë kështu: “Të dhënat biometrike janë të dhëna unike që paraqesin karakteristikat unike të individit dhe shërbejnë për të përcaktuar identitetin nëpërmjet pamjes së fytyrës, të shenjave të gishtërinjve, të ngjyrës së syve dhe të grupit të gjakut,”

KRYETARI KOLË BERISHA: Duhet të keni pasur problem me to, derisa i keni mësuar kështu.

NIMON ALIMUSAJ – Po, kam pasur problem me sy.

KRYETARI KOLË BERISHA – Votojmë për amendamentin numër 4 bashkë me propozimin e deputeti Nimon Alimusaj.

Votojmë tash:

Për 72;
Kundër..... 1.
Miratohet amendamenti.

Urdhëroni, zonja Kelmendi!

NEKIBE KELMENDI – Është dhënë përkufizimi i amendamentit 5 - tjetërsimi, që thotë: “nënkupton kalimin e posedimit ose të drejtave të tjera mbi dokumentin e letërnjoftimit, nga një person fizik në personin tjetër fizik ose juridik. Tjetërsimi i letërnjoftimit është vepër penale, zoti Kryetar. Unë mendoj se kjo nuk duhet të rregullohet me ligj fare, që të lejohet tjetërsimi i letërnjoftimit. Ai është dokument personal dhe nuk mund t’i shitet dikujt e fjala tjetërsim - nënkupton shitje.

KRYETARI KOLË BERISHA – Por është fjala për përkufizim e jo për ndërrim ose tjetërsim të dikujt.
Naim Maloku e ka fjalën. Urdhëroni!

NAIM MALOKU – Të nderuar deputetë,
Amendamenti 5 ka të bëjë me përkufizimin. Çka do të thotë tjetërsim? Tjetërsimin e kemi në Projektligjin mbi gjrobat. Në qoftë se një qytetar e tjetërsion letërnjoftimin, pasojnë gjrobat dhe ndjekjet e tjera penale . Kjo ka të bëjë vetëm me shprehjen, ose me përkufizimin e fjalës tjetërsim , që përdoret në projektligj.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni, zonja Nekibe!

NEKIBE KELMENDI – Megjithatë, këtu thuhet:“nënkupton kalimin e posedimit ose të të drejtave të tjera”, do me thënë po ia legalizon.

KRYETARI KOLË BERISHA – Zoti Agani, urdhëroni!

FERID AGANI – Në qoftë se mund të ju ndihmoj pak në këtë situatë. Kemi situata me individë që për një arsye ose tjetër shëndetësore mund të jenë të privuar nga aftësitë për aktivitet vetanak të pavarur dhe në shumë situata anëtar i familjes ose dikush tjetër mund të jetë në situatë që të posedojë lejen e njoftimit dhe ta shfrytëzojë atë. Ndoshta, përpiluesi i Projektligjit ka menduar në këto situata kalimtare. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Megjithatë, unë mendoj se është fjala vetëm për përkufizimin. Urdhëroni, profesor Hamiti!

SABRI HAMITI – Unë besoj që zoti Maloku është marrë shumë më shumë me këtë ligj dhe e di. Problemi është pak që ky përkufizim ka hyrë këtu ku s’ka referencë në tekst edhe hutimi është edhe këtu. Unë e shoh që këta donë ta përkufizojnë një veprim i cili është i dënueshëm. A është kështu, Malok, të lutem shumë? Do me thënë - kush e bën këtë punë, do të dënohet. Atëherë, kjo duhet të shkojë te përkufizimet themelore se është një domosdo për një veprim që është i dënueshëm . Nëse dokumenti i jepet dikujt është i dënueshëm. Unë besoj që edhe ky përkufizim mund të votohet, s’ka problem.

KRYETARI KOLË BERISHA – Profesor Hajredin Kuçi.

HAJREDIN KUÇI – Faleminderit zoti kryetar,

Mendoj që zonja Kelmendi ka plotësisht të drejtë. Këtu është fjala për dispozitë juridike. Në rastin konkret, sipas këtij amendamenti, u lejohej personave të bëjnë tjetërsimin. Mendoj që s'ka nevojë të ekzistojë ky amendament fare, por automatikisht brenda ligjit nënkuptohet ndalimi i tjetërsimit. Mendoj që s'ka nevojë që komisionet funksionale të merren me nocione të tilla që pastaj vejnë dilema. Tjetërsimi është vepër penale jo vetëm i letërnjoftimit, por i çdo dokumenti. Plus, absurdi më i madh është edhe nga personi tjetër juridik. Letërnjoftimi s'mund të tjetërsohet. Unë mendoj që këto janë çështje të ekspertizës së thellë dhe nuk janë më çështje as gjyqësore, as çështje të sigurisë, por të ekspertizës së thellë juridike. Kjo nuk e ndryshon esencën e ligjit dhe nuk është qëllimi ynë t'ia japim ose jo të drejtën diku. Ua lëmë njerëzve ekspertë le ta kryejnë këtë punë, por të mos merremi ne me këtë dhe këtë amendament është mirë që ta heqim fare nga votimi.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni zoti Maloku.

NAIM MALOKU – Në projektligjin të cilin unë s'e kam këtu, por e kemi shqyrtuar me vëmendje, përdoret fjala “tjetërsim” kur është të veprat penale që kryhen, kur një individ e tjetëron letërnjoftimin. Ky amendament ka të bëjë vetëm me fjalën “tjetërsim”, çka nënkupton . Në nenet e tjera, kur është fjala të gjobat, të veprat penale lidhur me tjetërsimin e letërnjoftimit, përdoret fjala “tjetërsim” dhe të ky amendament vetëm qartësohet çka është fjala “tjetërsim”.

KRYETARI KOLË BERISHA – Deputeti Agani e ka fjalën.

FERID AGANI – Zoti kryetar. Unë mendoj se formulimi që e përshkruan përkufizimin “tjetërsim” është shumë i qartë. Këtu flitet jo vetëm për kalimin e posedimit, por për kalimin e posedimit ose të drejtave të tjera. Pra, këtu nuk bëhet fjalë për shkelje penale, ju lutem. Këtu bëhet fjalë për kalimin e të drejtave të tjera mbi letërnjoftimin. Prandaj, unë mendoj se ky përkufizim është futur këtu me qëllim që t'i sqarojë në tekstin ligjor situatat, kur individët janë të kufizuar dhe të pamundësuar që në mënyrë vetanake të shfrytëzojnë letërnjoftimin në vende zyrtare. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Teksti është shumë i qartë. Ai nënkupton kalimin, posedimin, ose të drejtat e tjera mbi dokumentin e letërnjoftimit nga një person fizik në tjetrin .Do të thotë, nuk e lejon, por e përkufizon çka do të thotë “tjetërsimi”, që në një nen tjetër, sigurisht se dënohet. Prandaj, mendoj se duhet të shkojmë me këtë terminologji që është tash. Pra, nënkupton kalimin e posedimit, ose të të drejtave të tjera mbi dokumentin e letërnjoftimit nga një person fizik në personin tjetër juridik. Nëse kjo ndodh, dënohet.

Profesor Muhaxheri e ka fjalën.

YMER MUHAXHERI- Zoti kryetar, mendoj se termi, nocioni “tjetërsim” nuk mund të ekzistojë. Nuk e ka vendin, sepse qarku i konceptit “tjetërsim” është shumë më i madh. Ka implikime dhe përfshin shumë gjëra të tjera. Për atë, ai duhet të hiqet. Vendin e ka fjala “kalim” kur kemi të bëjmë me përcjelljen e disa të drejtave. Kaq.

KRYETARI KOLË BERISHA – Agim Krasniqi e ka fjalën.

AGIM KRASNIQI – Unë desha vetëm të sqaroj pak. Mendoj që nuk e ka vendin ky amendament edhe pse jam anëtar i Komisionit për Siguri edhe e kemi përpunuar këtë dhe kemi punuar në këtë çështje. Pra, nuk është fjala për “tjetërsim”, as për “kalim”. As njëra, as tjetra nuk duhet të ndodhin. Nuk mund të tjetërsohet, e para. E dyta, si mund të kalojë një dokument personal, siç është letërnjoftimi, në duart e dikujt tjetër edhe ai pastaj të shfrytëzohet e të keqpërdoret. Nëse keqpërdorët, janë sanksionet më vonë, janë masat ndëshkimore edhe ato i rregullojnë dispozitat e tjera të këtij ligji. kështu që unë mendoj që ky amendament të mos miratohet, ose thjesht të tërhiqet. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit! Urdhëroni, Gjylnaze Sylja!

GJYLNAZE SYLA – Faleminderit! Zoti kryetar, unë mendoj që nuk e pengon Ligjin definimi i tjetërsimit për arsye se më vonë në amendamentin 9 thuhet: Shtetasi nuk ka të drejtë t’ia japë letërnjoftimin e vet personit tjetër për përdorim apo të përdorë letërnjoftimin e huaj si të vetin. Në qoftë se është përdorur nocioni “tjetërsim”, atëherë duhet ta dimë për çka. Nuk po e shoh që e dëmton ligjin në qoftë se lihet këtu.

KRYETARI KOLË BERISHA – Nafije Berisha e ka fjalën.

NAFIJE BERISHA – Zoti kryetar, unë mendoj që ndoshta asgjë nuk e dëmton Projektligjin edhe nëse ky përkufizim i ri i shtuar largohet fare prej amendamenteve pasi që sponsori nuk e ka parë të arsyeshme në fillim të projektligjit ta vë si përkufizim. Ndoshta nuk është edhe i domosdoshëm, sepse ndoshta në këtë moment mund të bëhet edhe ndonjë gabim sikurse që është bërë gabim, për shembull, me Projektligjin për bletarinë. Atje, fjalën pogaçe e kanë shkruar në përkufizim se ka përbërje të dyllit, kurse unë kur e kam konsultuar literaturën, në pogaçe s’ka asnjë trohë dyllë. Do me thënë, mund të bëhen gabime edhe s’është mirë kur nuk janë njerëzit të sigurt të miratojmë diçka që nuk është e sigurt.

KRYETARI KOLË BERISHA – Atëherë, e heqim amendamentin numër 5. Udhëroni, zoti Maloku!

NAIM MALOKU – Të nderuar deputetë, unë i gjeta në Projektligj dy nene që kanë të bëjnë me shpjegimet. Neni 6.1. citoj: “Shtetasi nuk ka të drejtë t’ia japë letërnjoftimin e tij personit tjetër, apo ta përdorë letërnjoftimin e huaj si të vetin”. Neni 6.2: “Letërnjoftimi i huaj nuk lejohet të keqpërdoret, me qëllim të sigurimit të ndonjë përfitimi apo të drejte”. Te përcaktimi i dënimeve, 21.3 që letërnjoftimin e tij e jep apo e huazon personi tjetër, apo e përdor letërnjoftimin e huaj si të vetin, paragrafi 1 neni 6 etj. Pra, dënohet me gjobë prej 50 - 200 euro. Ky është vetëm si përkufizim. Mund edhe ta tërheqim fare nga projektligji.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni, zoti ministër! Ministri Gjini e ka fjalën.

MINISTRI ARDIAN GJINI – Faleminderit, zoti kryetar, faleminderit deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës! Me qenë se vetëm unë jam prej Qeverisë, po jap një kontribut të vogël këtu.

Përkufizimi shpjegon çka nënkuptojmë me tjetërsim. Edhe nëse, eventualisht, nuk ka term “tjetërsim” në këtë ligj, ne po flasim për tjetërsim dhe këto përkufizime shumë shpesh përdoren si hallka, në të cilat do të ndëlidhen ligjet e tjera, që do t’i referohen këtij ligji. Për shkak se nëse do të ketë vepër penale të tjetërsimit në një rast tjetër, në ligj tjetër që e përkufizon veprën penale, duhet ta ketë një pikë ku i referohet këtij ligji . Siç u tha edhe më përpara, përkufizimi se çka është tjetërsimi, nëse do të ishte debat i Kuvendit, do të ishte krejt në rregull. Mirëpo, në këtë rast kemi të bëjmë me përkufizim dhe ky përkufizim, ju do ta gjeni më së miri, mund të shfrytëzohet si hallkë. Pra, quhet hallkë, në të cilën një ligj tjetër mund të thirret, në rast se kemi të bëjmë me tjetërsim. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Propozohet që të tërhiqet ky nen fare. Hiqet amendamenti numër 5.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Për..... 66;

Kundër..... 1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Për..... 63;

Kundër.... 1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Urdhëroni zoti Luzha..

BERAT LUZHA – Duhet të precizohet më mirë amendamenti. Shtetasi nuk mund të posedojë më shumë se një letërnjoftim, të lëshuar- duhet t’i shtohet, në Kosovë, jo letërnjoftim të Kosovës.

KRYETARI KOLË BERISHA – Zoti Kuçi, urdhëroni!

HAJREDIN KUÇI – Unë mendoj, zoti Kryetar, ndoshta neni ashtu çfarë ka qenë, ka qenë shumë më i mirë, sesa kështu si është propozuar. Pse e them këtë? Shtetasi ka të drejtën, kjo nënkupton që shteti është i obliguar që t’i japë një letërnjoftim çdo qytetari të Kosovës. Ndërsa, në rastin e dytë, qytetari nuk ka të drejtë të ketë më shumë, por shteti nuk është i obliguar. Kështu që neni 4.3. sikur ka qenë: “Shtetasi ka të drejtë të ketë vetëm një letërnjoftim” edhe është prezumim pozitiv për shtetasin, por njëkohësisht i jep të drejtën ose i ndalon të ketë më shumë se një letërnjoftim. Pra, unë mendoj më mirë ka qenë, sesa që është propozuar.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Zoti Maloku, urdhëroni!

NAIM MALOKU – E kemi shqyrtuar këtë nen dhe këtë amendament edhe në Komisionin Parlamentar. Siç ka qenë në ligj, shtetasi ka të drejtën të ketë vetëm një letërnjoftim. Shtetasit që kanë dy shtetësi, e do të ketë shumë dhe ka shumë të tillë në Kosovë, pra dhe do të ketë, do të vijë Ligji për shtetësinë, është në përgatitje, në hartim e sipër. Ky Kuvend do ta shqyrtojë - votojë atë projektligj. Pra, ka raste edhe brenda këtij Kuvendi, ka deputetë që i kanë dy letërnjoftime. E kemi miratuar amendamentin – “Shtetasi nuk mund të posedojë më shumë se një letërnjoftim”. E pranojmë propozimin e zotit Berat Luzha “të lëshuar në Kosovë”. Ne e kemi menduar që kuptohet –“një letërnjoftim të Kosovës”, të lëshuar në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – E hedhim në votim amendamentin me propozimin e zotit Berat Luzha.

Votojmë tash:

Për..... 50,

Kundër..... 11

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Për..... 60;

Kundër.... 1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 10

Votojmë tash:

Për..... 68;

Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 11

Votojmë tash:

Për..... 60;

Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 12

Votojmë tash:

Kamber Kamberi e ka fjalën, Urdhëroni, zoti deputet!

KAMBER KAMBERI – Kam një vërejtje të vogël, sepse më duket se është i pakuptimtë ky formulim. Pra, duhet të jetë: “letërnjoftimi përmban fotografinë dhe të dhënat biometrike të bartësit të dokumentit”, jo të dhënavë biometrike.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni zoti Kuçi.

HAJREDIN KUÇI – Faleminderit Kryetar! Mendoj që zoti Kamber ka të drejtë, sepse këtu “përmban fotografinë e të dhënave” është gabim. Pra, unë pajtohem me atë që e propozoi dhe mendoj se duhet të bëhet një dallim.

KRYETARI KOLË BERISHA – E hedh në votim amendamentin numër 12 me përmirësimet që u dhanë.

Votojmë tash:

Urdhëroni, profesor Hamiti e ka fjalën!

SABRI HAMITI - Meqë unë as që e kam studiuar këtë nen shumë, por duke diskutuar dy kolegë, po e shoh që kuptimi e tjetërsion kuptimin e parë, nuk e plotëson. Gjuhësisht këta e kanë rindërtuar, por e kanë gjymtuar mandej, se në anën e majtë e keni edhe punën e nënshkrimit, që në anën e djathtë s’ekziston hiç. Keni kujdes! Krahasoni edhe një herë e mos ta votojmë pa u marrë vesh. Kaq.

KRYETARI KOLË BERISHA – Po, urdhëroni zoti Kuçi!

HAJREDIN KUÇI – Faleminderit, Kryetar! Unë mendoj se vërejtja e zotit Kamber dhe ajo e imja nuk kanë qenë në kuptimin e përmbajtjes gjuhësore, por në kuptimin e normës juridike. Edhe unë po e them se nëse dikush më pyet mua, më mirë ka qenë se sa është ndryshuar. Ky është mendimi im që unë do ta mbështes ashtu çfarë ka qenë, jo ashtu siç është ndryshuar.

KRYETARI KOLË BERISHA – E hedh në votim amendamentin 12.

Votojmë tash:

Për..... 16;

Kundër .. 37.

Nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 13

Votojmë tash:

Për..... 57;

Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 14

Votojmë tash:

DEPUTETI MAHIR JAGCILAR- Është votuar tash, amendamenti ka kaluar, unë mendova paraprakisht të flas.

KRYETARI KOLË BERISHA – Është votuar.

Për..... 46;

Kundër... 10.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 15

Votojmë tash:

Për..... 41;

Kundër.... 1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 16

Votojmë tash:

Për..... 55;

Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 17

Votojmë tash:

Për..... 54;

Kundër... 2.

Miratohet amendamenti.

Urdhëro, zoti Kuçi, por ne votuam tash.

HAJREDIN KUÇI –Faleminderit, zoti Kryetar! Unë pajtohem me rezultatin e votimit, por dua ta them një sqarim. Letërnjoftimi është dokument obligativ për secilin qytetar të Kosovës. Në këtë rast nëse themi ashtu çfarë ka qenë, lëshimi i letërnjoftimit bëhet pa pagesë. Pra, të mos kemi arsyetim se qytetari për shkak të pagesës, nuk mund ta kenë letërnjoftimin. Ashtu çfarë ka qenë në ligj, mendoj qëllimi i ligjit, sponsori i ligjit ka qenë i qartë. Sido që do të votoni, unë do ta respektoj.

KRYETARI KOLË BERISHA – Kalojmë në amendamentin 18.

Votojmë tash:

Për..... 55;

Kundër.... 4.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 19

Votojmë tash:

Për 57;

Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 20

Votojmë tash:

Për..... 53;

Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 21.

Urdhëroni, zoti Kuçi!

HAJREDIN KUÇI – Unë jam prej atyre që shpeshherë tentojnë të kryhet sa më shpejtë votimi i ligjit, por i kuptoj edhe të tjerët. Po në amendamentin 19 thuhet: “nënshkrimi, në harmoni me standardet ndërkombëtare”. Për gjurmët e gishtërinjve bën të thuhet “në harmoni me standardet ndërkombëtare”. Nënshkrimin ne e kemi sipas standardeve tona. Unë mendoj se këto janë lëshime të vogla në dukje, por në të ardhmen mund të kemi telashe. Për nënshkrimin duhet të kemi parasysh se në Kosovë ka njerëz analfabet, A kemi nevojë që ta vëmë nënshkrimin këtu, apo jo?

KRYETARI KOLË BERISHA – Zonja Kelmendi, urdhëroni!.

NEKIBE KELMENDI – Juridikisht nuk quhen imazhet e gjurmëve të gishtërinjve, por shenjat e gishtërinjve. Këto janë vijat papilare që janë individuale. Tek 7 miliardë njerëz nuk janë njësoj. As te 10 gishtat e dorës të një njeriu nuk janë njësoj. Prandaj, quhen shenjat e gishtërinjve, e jo imazhe.

KRYETARI KOLË BERISHA – A mund ta konsiderojmë të votuar me këto vërejtje që u dhanë? Ju faleminderit!

Kalojmë në amendamentin 21.

Votojmë tash:

Për..... 54;

Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 22

I kemi dy propozime. Propozimi i Komisionit Funkcional dhe ai i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Fjalën e ka zoti Maloku.

NAIM MALOKU – Mendoj se në këtë amendament mund të inkorporohet edhe amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe Financa se ka të bëjë vetëm në amendamentin 22, neni 21.1. Fjala “prej 30 ditësh” të zëvendësohet me fjalën “deri 30 ditë”. Pra, mund të inkorporohen bashkë këto dy.

KRYETARI KOLË BERISHA – Atëherë, votojmë për amendamentin, në këto dy versione.

Votojmë tash:

Për..... 52:

Kundër..... 3.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 23

Votojmë tash:

Për..... 56;

Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti.

Votojmë për tekstin në tërësi..

Votojmë tash:

Në sallë janë 72 deputetë.

Për..... 63;

Kundër..... 5.

Miratohet Projektligji, përkatësisht amendamentet e propozuara.

Kalojmë në pikën e gjatë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 14 dhjetor 2006. Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet, si vijon:

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Kalojmë në miratimin e amendamenteve një nga një.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Për..... 61;

Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Për..... 54;

Asnjë kundër.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Për..... 55;

Kundër..... 1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Për..... 56;
Asnjë kundër.
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 5

Votojmë tash:
Për..... 54;
Kundër..... 1.
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 6

Votojmë tash:
Për..... 50;
Asnjë kundër.
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 7

Votojmë tash:
Për..... 53;
Asnjë kundër.
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 8

Votojmë tash:
Për..... 55;
Kundër..... 3.
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 9

Votojmë tash:
Për..... 59;
Kundër..... 2
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 10

I kemi dy propozime. Urdhëroni! Zef Morina e ka fjalën.

ZEF MORINA – Mendoj që amendamenti numër 10, përkatësisht neni 6.1. duhet të ndryshohet dhe të ketë këtë kuptim: Ndërtimet pa leje, që i plotësojnë kushtet për dhënie e lejes për legalizim, sipas këtij ligji dhe ligjeve në fuqi, duhet të paguajnë taksën për marrjen e lejes për legalizim në vlerë prej 20% -jo 100% ,të rritur nga taksat, rregullat e lejes së ndërtimit të përcaktohen nga kuvendet komunale. Arsyeja- pse? Të gjithë e dimë që planet rregullative në të gjitha komunat e Kosovës kanë filluar të përgatiten pas vitit 2005 .D.m.th. që nga viti 99 deri në vitin 2005 nuk ka pasur plane rregullative dhe asnjë organ komunal nuk ka mund t'u lëshojë leje ndërtimi investitorëve që kanë pasur nevojë të ndërtojnë. Ne të gjithë e dimë që mbi 35% të punëtorëve janë në industrinë e ndërtimit. Sikur tani t'i dënojmë ne ata investitorë ose punëmarrës që kanë ndërtuar objektet pa leje, atëherë do të shkonte automatikisht në barrën e vet qytetarëve që do t'i

blejnë ato objekte. Përndryshe, në asnjë vend në botë nuk ka objekte pa leje. Objekte ose ka me leje, ose s'ka fare. Mendoj, për shkak se nevojiten mjete, ndoshta për arsye të ndryshme të zhvillimeve të komunave, atëherë mund të jetë një taksë prej 20%, jo të dyfishohet. Po marr si shembull Prishtinën, që lejen e ndërtimit për një metër katror e ka më të shtrenjtë se Cyrihu. Standardi i Kosovës edhe standardi i zviceranit është 1: 100. 50 euro është leja e ndërtimit për një metër katror dhe nëse tash ai objekt që është ndërtuar i dyfishohet, do me thënë, kushton 100 euro, ndërsa objekti për t'u ndërtuar kushton 200 euro. Kjo vërtet është e pakuptimtë. Mendoj se dhe kërkoj nga deputetë që kjo të ndryshohet. Vërtet po flas në kuptimin logjik dhe profesional.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit!
Ministri Gjini e ka fjalën.

MINISTRI ARDIAN GJINI – Faleminderit, zoti Kryetar, edhe një herë! Unë i falënderoj njerëzit, deputetët që kanë punuar në këtë amendament, në Komisionin. Arsyeja pse është kërkuar një vlerë e tillë është shumë e qartë. Nëse do të ishte 20 për qind, siç kërkon deputeti i respektuar Morina, nuk do të kishte kurrfarë arsyeje që dikush të presë një vit për ta marrë lejen, sepse lejet marrin kohë, për shkak të procedurës. Nëse ne do ta kishim taksën e dënimit të vogël, unë mund t'ju them se nuk do të presë askush që të marrë leje ndërtimi, por do të fillojnë të ndërtojnë pa leje. Qëllimi i ligjit nuk është t'i dënojë njerëzit. Qëllimi është, përpos tjerash, t'ju pengojë ndërtimet pa leje të cilat po vazhdojnë.

Çështja tjetër, është e vërtetë që është 100% e rritur, do të thotë për 50 euro më tepër, mirëpo mos harroni se nuk ka banesë në Prishtinë, që shitet për më pak se 600 euro metri katror. Për shembull, shkojnë edhe më tepër përmbi 1000 euro. Edhe për çka po flasim ne, prapëseprapë në vlerë të shitjes është një shumë e vogël, 200 euro është vlera e ndërtimit, është e vërtetë. Është mbi 600 euro vlera e shitjes, e ju mund ta merrni me mend vet se për çka po flasim tani. Qëllimi i ligjit është t'ju parandalojë ndërtimet pa leje, jo të kujdeset për ata që kanë ndërtuar pa leje. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI – Faleminderit, i nderuari Kryetar! Absolutisht pajtohem me këtë që e tha ministri Gjini. Si kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, që ka një amendament, u bëj thirrje kolegëve të mi që të pajtohen të shkojë propozimi i Komisionit FunkSIONAL, e jo i Komisionit për Buxhet dhe Financa, sepse është shumë i ashpër dhe paraqet dënime shumë të mëdha. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Zonja Nekibe, urdhëroni.

NEKIBE KELMENDI – Këtu u përmend se asnjë komunë nuk e ka të rregulluar planin hapësinor, përkatësisht planin urbanistik prej vitit 1999 e tutje. Mirëpo, mos harroni se Prishtina si Prishtinë, si qytet e ka pasur të rregulluar planin urbanistik prej vitit 1972 deri në vitin 2000. Komuna është dashur ta respektojë atë plan urbanistik dhe nuk do të kishte ardhur në kaos nëse do të ishte respektuar ai plan deri në nxjerrjen e planit të ri urbanistik, por janë ndërtuar vende e pa vende, tash le të paguhet. Një metër katror tash për tash qysh është materiali ndërtimor i lirë dhe teknologjia e punës ka përparuar, një shtëpi ndërtohet për 6 muaj me makina, e tjera. Kostoja e ndërtimit është diku rreth 250

– 300 euro, kurse shitja bëhet 1000 euro . Le t'i paguajnë edhe taksat se diçka duhet të marrë edhe shteti e jo vetëm për veti.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Berat Luzha e ka fjalën.

BERAT LUZHA – Zoti Kryetar, këtu amendamenti është në 2 pika. Më duket se shumica nuk e kanë lexuar edhe pikën e dytë. 100% të taksave më shumë se vlera e taksave të zakonshme është vetëm për ndërtimet që nuk kanë karakter të banimit, nuk janë shtëpi familjare. Të gjitha ndërtimet që kanë karakter biznesi, ose karakter të shitjes, i paguajnë 100%, kurse shtëpitë familjare nuk paguajnë taksa më shumë se sa taksat e zakonshme, për shkak se është marrë parasysh se shumica dërmuese e atyre që kanë ndërtuar shtëpi familjare i plotësojnë kushtet dhe nuk kanë pasur mundësi, se nuk kanë dhënë leje kryesisht as komunat në kohën kur e kanë ndërtuar këtë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Shaban Halimi.

SHABAN HALIMI – Faleminderit, zoti Kryetar! Lidhur me amendamentimin e këtij projektligji që faktikisht duhet të bëhet ligj, unë kam qenë kryetar i Grupit punues të emëruar nga Komisioni Funksional. Ne kemi pasur ekspertë nga Fakulteti Teknik i Arkitekturës, nga kuvendet komunale me përvojë urbanistike në këtë drejtim dhe për këtë ligj. Lidhur me amendamentim të këtij ligji kemi pasur, së paku, tri debate publike me grupe të interesit për ta amendamentuar në mënyrë sa më profesionale. Pikërisht amendamenti 10 për nenin 6 që ka fjalën, ka qenë amendament ose nen, i cili më së tepërmi ka marrë kohë në këtë drejtim. Në ligjin e parë në parim ka qenë i propozuar dyfishi për ndërtimet, do të thotë pa leje, për ndërtimet familjare, kurse për ndërtimet biznesore katërfishi. Në këtë drejtim do të thotë në konsultim me të gjitha grupet e interesit kemi ardhur në përfundim se për ndërtimet pa leje të karakterit biznesor të shkohet 100% nga taksa e rregullt, kurse për ndërtimet familjare të cilat sipas ligjit të ndërtimit konsiderohen ndërtime të cilat kanë 450 metra katrorë hapësirë të përdorshme, ato të mbesin në kuadër të taksave të rregullta. Unë mendoj se edhe Komisioni për Financa dhe Buxhet tërhoqi amendamentin e vet, mbet pranë Komisionit Funksional. Unë mendoj se ky amendament duhet të shkojë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit! Rifat Krasniq.

RIFAT KRASNIQ – Faleminderit, zoti kryetar! Edhe unë desha t'i sqaroj ato fjalë që zotit Berati dhe zoti Shaban Halimi i kanë sqaruar. Këtu duhet ta dimë se janë 100% dënim për bizneset a 450 metra katrorë për ata s'janë. Për atë arsye ky amendament është i mirë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Zoti Zharku e ka fjalën.

DEPUTETI LUTFI ZHARKU – Faleminderit, zoti Kryetar! Në parim e përkrah fuqishëm ministrin Gjini për fjalët e thëna. Në Komision ne e kemi shqyrtuar krejt atë edhe veç e kemi bërë një përcaktim më të mirë të gjobave. Qeveria ka propozuar dy fish deri katër fish, kurse ne e kemi përcaktuar trefishin për objektet banimi, kurse pesë fish për objektet komerciale. Unë mendoj se duhet propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa duhet të shkojë ashtu siç është dhënë. Thjeshtë e kam një qëndrim personal,

ndoshta është pak ekstrem, por ai që e ka thyer ligjin dhe ai që ka ndërtuar ka pasur para të ndërtoj pa leje duhet të këtë para të paguaj taksa pesë fish e dhjetë fish.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit!

Votojmë propozimin e Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 11

Votojmë tash:

Për..... 48;

Kundër..... 2.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 12

Votojmë tash:

Në sallë janë 62 deputetë.

Për..... 50;

Kundër..... 2.

Miratohet amendamenti

Amendamenti 13 në fakt 12

Votojmë tash:

Për..... 46;

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 13

Votojmë tash:

Për..... 49;

Kundër..... 4.

Miratohet amendamenti.

Lus deputetët që nuk janë në sallë, të kthehen. Ju lutem zini vendet, Alush, ju lutem zini vendet. Sa deputet i kemi tash? Në sallë janë 62 deputetë. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 14

Votojmë tash:

Për..... 54;

Kundër..... 2.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 15

Votojmë tash:

Për..... 55;

Kundër..... 3.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 16

Votojmë tash:

Për..... 56;

Kundër.... 2.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 17

Votojmë tash:

Për 57;

Kundër.... 1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 18

Votojmë tash:

Për..... 55;

Kundër.... 2.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 19

Votojmë tash:

Për..... 57;

Kundër.... 2.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 20

Votojmë tash:

Për..... 56;

Kundër.... 3.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 21

Votojmë tash:

Për..... 59;

Kundër 1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 22

Votojmë tash:

Për..... 56

Kundër... 3.

Kalon amendamenti.

Në sallë kemi 67 deputetë.

Amendamenti 23

Votojmë tash:

Për..... 60;

Kundër..... 2.
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 24.

Votojmë tash:

Për..... 63;
Kundër..... 2.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 25

Urdhëroni, zonja Nekibe!.

NEKIBE KELMENDI – Këtu në amendamentin 25, kur fjala për lejen e përdorimit, është fshirë pothuaj se krejt teksti ligjor dhe ka mbetur vetëm “objektet e papërfunduara, të cilat pajisen me leje të legalizimit, duhet të marrin edhe lejen e përdorimit sipas ligjit për ndërtim”. Në tekstin e ligjit të sponsoruar, në paragrafin 2 ka qenë: “Leja e përdorimit të jepet pas pranimit teknik”. Këtu thuhet kontrollit teknik. Duhet të jetë: “pranimi teknik për secilin objekt”. Nuk duhet të na ndodh që të ndërtohen objektet do si do edhe në na ndodh Adana, të rrënohen me një tërmet të vogël 40 mijë shtëpi. Duhet të bëhet së pari pranimi teknik i objektit, sipas procedurave të parapara me Ligjin për ndërtimtari, e më pastaj të lëshohet leja e përdorimit të shtëpisë. Prandaj, nuk duhet të fshihet paragrafi 2 i këtij neni.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Ministri Gjini e ka fjalën.

MINISTRI ARDIAN GJINI – Faleminderit, edhe një herë, zoti Kryetar! E falënderoj deputeten Kelmendi. Edhe ky nen, do të thotë neni 25 dhe neni 26, prapë janë në ndërlidhje me Ligjin për ndërtim, për shkak se do të ishte një situatë e vështirë ligjore nëse do të jepej leja e ndërtimit, nëse nuk ka pranim teknik të objekteve. Edhe nëse do të dukej neni 26 si nen i tepërt për shkak se një pjesë e këtij neni rregullohet me Ligjin për ndërtim, prapëseprapë është një hallkë e cila i lidh dy ligjet dhe i bën të aplikueshëm ndërmjet veti për shkak se në momentin kur do të legalizohet objekti, dikush do të pyet përpos konditave të tjera, edhe për çka legalizohet. Nuk do të ketë komuna të cilat e marrin obligim legalizimin e një objekti, i cili edhe mund të shembet pas një tërmeti të vogël. Do të thotë, unë i propozoj Kuvendit që t’i mbajë nenet 25, 26 dhe 27. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Propozohet që të fshihen amendamentet 25, 26 dhe 27 dhe të mbetet teksti që ka qenë më parë në ligj.

Votojmë tash:

Për mbetjen e tekstit që ka qenë më parë në ligj për të tri nenet. Fshihen amendamentet. Mbetet teksti që ka qenë. Duhet të tërhiqen amendamentet. Propozuesi i Komisionit duhet t’i tërheqë këto amendamente. Urdhëroni, zoti Luzha!

BERAT LUZHA – Zoti Kryetar, Komisioni i ka hequr për shkak se këto çështje rregullohen me Ligjin për ndërtimin, prandaj nuk ka nevojë në dy ligje të shkojnë të njëjtat gjëra. Për atë shkak janë hequr, jo për diçka tjetër.

KRYETARI KOLË BERISHA – Çka propozoni tash ju?

BERAT LUZHA – Të mbeten kështu amendamentet, në mënyrë që të respektohet Ligji për ndërtim për këto çështje që kanë të bëjnë këto nene këtu.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëro, zonja Nekibe.

NEKIBE KELMENDI – Duhet t'i ketë edhe këto formulime.

KRYETARI KOLË BERISHA – Atëherë, e hedhim në votim amendamentin numër 25.

Votojmë tash:

Nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 26

Votojmë tash:

Nuk miratohet amendamenti. Mbetet teksti i ligjit.

Amendamenti 27

Votojmë tash:

Nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 28

Urdhëroni, zoti Gjini, ministër.

ARDIAN GJINI – Faleminderit edhe një herë! Ajo çka kemi menduar me amendamentin 28, i cili sipas propozimit këtu është fshirë është se do të ballafaqohemi me rastin në të cilin ose ka filluar ose do të fillojë një ndërtim pa leje dhe mund të ketë raste në të cilat kalkulimi i investitorit do të jetë i tillë që do t'i kushtojë më pak të vazhdojë të ndërtojë pa leje se sa ta presë legalizimin. Ajo që po tentojmë të bëjmë është që në momentin që ligji hynë në fuqi, nëse do të ketë shumë shpejtë vendime për ndërtim pa leje të tentojmë që të kemi gjopa të sakta të menjëhershme që të mund t'i parandalojmë edhe ato. Ky ka qenë i vetmi qëllim pse është futur amendamenti 28 të cilin Komisioni Funkcional ka propozuar që të fshihet. Faleminderit! Unë propozoj që të votohet ashtu si ka qenë. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Amendamenti 28

Votojmë tash:

Për 22;

Kundër..... 33.

Nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 29

Votojmë tash:

Urdhëroni, zoti Morina!

ZEF MORINA – Pikërisht nëse dëshirojmë t'i ndalojmë ndërtimet pa leje mendoj se duhet të jetë neni e të fshihet amendamenti. Ajo që tha ministri Gjini plotësisht pajtohem, sepse pas hyrjes në fuqi ligjit askush nuk duhet t'i fillojë ndërtimet pa leje. Nëse ai fillon ndërtimet, d.m.th. do të ndëshkohet nga 1000 deri 15 000 euro, nëse dëshirojmë t'i ndalim. Pse atëherë të fshihet ky nen?

KRYETARI KOLË BERISHA – Zoti Luzha, urdhëroni!

BERAT LUZHA – Vetëm një sqarim. Ky ligj ka të bëjë vetëm për ato ndërtime që janë kryer ose janë në ndërtim e sipër. Për ato që ndërtohen pas miratimit të këtij ligji, nuk vazhdon ky ligj. Vazhdon vetëm ligji i ndërtimit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju jeni për mbetjen e

Amendamenti 29

Votojmë tash:

Për 27;

Kundër..... 33.

Nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 30

Votojmë tash:

Për 39;

Kundër..... 12.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 31

Votojmë tash:

Për..... 40;

Kundër.... 12.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 32

Votojmë tash:

Për..... 52;

Kundër.. 6.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 33

Votojmë tash:

Për..... 48;

Kundër..... 7.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 34 dhe i fundit.

Votojmë tash:

Për..... 39;

Kundër... 9.

Lus deputetët që të përgatiten për votim të tekstit në tërësi.

Votojmë tash:

Në sallë janë 68 deputetë.

Për..... 50;

Kundër.... 5.

Miratohet ligji.

Konstatohet se me 50 vota “për” dhe 5 “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Të kalojmë në pikën 7, ose të shkojmë në pauzë. Ejani të shkojmë të pimë nga një kafe, por me kusht që të kthehemi prapë të gjithë në sallë.

Vazhdimi i seancës pas pauzës

KOLË BERISHA – Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Debat lidhur me ndërtimet ilegale kolektive nga ana e Qeverisë së Serbisë në Veri të Mitrovicës

Në pajtim me Rregulloren e Punës, Grupi Parlamentar i LDD-së ka kërkuar debat lidhur me ndërtimin ilegal të banesave kolektive nga Qeveria e Serbisë në lagjet veriore të qytetit të Mitrovicës.

Për ta përgatitur sa më mirë këtë debat, Kryesia e Kuvendit e ka ngarkuar Qeverinë, respektivisht Ministrinë e Ambientit dhe të Planifikimit Hapësinor që ta përgatisë një informatë si material bazë për debat. Ministria e ka dërguar një shkresë, e cila u është shpërndarë deputetëve, me të cilën e njofton Kuvendin e Kosovës se nuk ka informata lidhur me ndërtimin ilegal të banesave në lagjen veriore të Mitrovicës dhe kërkon të shtyhet debati derisa Ministria t’i sigurojë informacionet e duhura lidhur me këtë çështje. Ndërkohë është siguruar materiali dhe sot mund të fillojmë me debat.

Ftoj përfaqësuesin, parashtuesin e mocionit, Ramadan Kelmendin, ta marrë fjalën.

RAMADAN KELMENDI - Ju faleminderit! I nderuari Kryetar, të nderuar ministra prezentë, kolegë të çmuar deputetë, të pranishëm të tjerë që janë shumë pak ose aspak,

Po e hapi debatin në Kuvend sipas propozimit të Grupit Parlamentar të LDD-së, lidhur me ndërtimet ilegale të banesave kolektive në lagjet veriore të Mitrovicës, të financuara nga Qeveria e Serisë, natyrisht, duke i falënderuar të gjithë nënshkruesit dhe përkrahësit e kësaj kërkesë si dhe të gjithë ata që do të japin kontributin me propozime konkrete lidhur me këtë çështje mjaft të hapur dhe të ndjeshme. Vetë fakti se kjo çështje është një ndër çështjet jashtëzakonisht të rëndësishme për Kosovën në tërësi pas statusit, na obligon që vërtet me një vëmendje shumë të madhe, jo për hir të asaj popullate të vogël që ka mbetur në veri, por për hir të konceptit të shtetit të Kosovës dhe të tërësisë së saj territoriale, të jemi në nivel të detyrës dhe të japim propozime konkrete

për të cilat dhe me të cilat qytetarët e asaj pjese dhe të tërësisë tjetër të Kosovës, do të kenë koncept të qartë lidhur me atë se çka po ndodhë në Veriun e Kosovës.

Mitrovica është problem artificial dhe vërtet është i tillë, problem i cili të gjithëve na është i njohur pak a shumë. Na kujtohet fare mirë se problemi i Mitrovicës të gjithëve na preokupoi gjatë fushatave zgjedhore dhe të gjithë, dhe kryesisht udhëheqësit e subjekteve politike premtuan se për 24 orë do ta zgjidhin këtë problem. Por, vërtet, a ndodhi kjo? Nuk do koment. Mitrovica tani e tutje, jo vetëm që nuk është zgjidhur, por gjithnjë e më shumë është aktualizuar dhe është problem me të cilin as vendorët, e as ndërkombëtarët nuk merren sa duhet. Mitrovica mbetet në vetëdijen si mollë sherri për konfliktet politike dhe etnike me qëllim të përmasave të bllokimit të proceseve në diskutimin e statusit final të Kosovës. Për këtë edhe jemi dëshmitarë. Ajo që më së shumti i bren të gjithë qytetarët e pjesës Veriore të Kosovës janë edhe deklaratat e njerëzve eminentë duke filluar nga ato që kërkojnë vijën ndarëse buzë lumit Ibër, duke kërkuar nga ato që kjo pjesë e Kosovës të falet dhe duke kërkuar nga ata që kjo pjesë e Kosovës të gëzon një autonomi substanciale etj. etj.

Deputetë të nderuar, jo vetëm se është problem politik, por tani Mitrovica është shndërruar edhe në problem të decentralizimit të pushtetit lokal, problem ekonomik, sepse atje është Trepça, problem etniko-kombëtar me përmasa edhe fetare, problem demografiko-spastrues, problem juridik dhe jo funksionues i pushtetit të Kosovës, problem pronësor, problem fetar, i lëvizjes së lirë dhe i pasigurisë së qytetarëve, e i cili dëshmohet edhe me fakte që kanë ndodhur mbrëmë nga rrahja e qytetarëve në fshatin Boletin nga njerëzit të cilët nuk dihet, nuk di se Ministria e Punëve të Brendshme a i ka këto shënime apo jo, ndonëse është publikuar në mjetet e informimit. Mitrovica sipas strukturës së saj përbënte një hapësirë ku mbi 89% të popullatës ishin shqiptarë, ndërsa në veriun mbi 78.26% dhe nga ajo pjesë u dëbuan mbi 23.800 qytetarë shqiptarë duke mos llogaritur këtu boshnjakët, turqit, ashkalinjtë, romët, egjiptianët etj. Të shpërngulur të gjithë me dhunë nga se serbet pas luftës dhe ata pak shqiptarë të pambrojtur me asnjë aspekt që ende përjetojnë 1100 peripeci, askush nuk kujdeset për ta. Unë sot do të përqendrohem vetëm në ndërtimin ilegal të ndërtesave kolektive të investuara nga Qeveria e Serbisë në pronat e shqiptarëve, qëllimi i të cilëve është tejet i dukshëm për të gjithë ne, të cilat bëhen me lejen e pushtetit vendor dhe mosndërhyrjen e pushteti Qendror mbi bazat e dokumenteve të vitit 1972 dhe të vendimeve të komunës inekzistente të Zveçanit, natyrisht, të përkrahur edhe nga strukturat rajonale, të UNMIK-ut edhe ato komunale të Mitrovicës, duke tejkaluar edhe parashikimet e dokumentit të Ahtisarit, i cili e pësoi atë që tashmë jemi dëshmitarë. E vërteton edhe fakti se Kuvendi i Komunës së Mitrovicës dhe Qeveria e Kosovës me shkresën që e kemi marrë, jo vetëm se nuk kanë dhënë pasqyrën reale mbi atë që po ndodhë në Veri, por nuk kanë bërë as përpjekjen maksimale për ta dëshmuar të vërtetën e cila është mjaft e hidhur për ata që e njohin dhe dëshirojnë ta njohin. Dhe nëse ne nuk dëshirojmë ta njohim, a është çështje e jona se nuk e duam tërësinë territoriale në bazë të Rezolutës për të cilën edhe ne kemi votuar këtu. Çka është duke ndodhur në Veriun e Mitrovicës realisht, në pika të shkurtra.

Nën një, në lagjet veriore të Mitrovicës, që nga lagja e Doktorëve e deri në fund të lagjes të Boshnjakëve apo lagja Lumbardhi, Qeveria e Serbisë po financon ndërtimin e gjashtë ndërtesave kolektive për vendosjen e jo familjarëve, por të ardhacakëve dhe të

rojeve të urës. Vërtetoni, zotërinj, kjo është fakt, sepse rojet e urës tani banojnë në to. Qëllimi i kësaj strategjie hegjemoniste është për të forcuar vijën ndarëse mbi bazat etnike mbi lumit Ibër dhe pjesës së gjelbëruar, tre, për të bërë presion të vazhdueshëm edhe mbi pak ata shtëpi edhe shqiptarë atje për t'i lëshuar vatrat e tyre, duke ju ofruar mundësi blerëse enorme. Për ta ndërruar tërësisht strukturën etnike të popullatës të veriut të Mitrovicës, pikërisht tani kur po paraqiten dilema dhe probleme për ardhmërinë e Kosovës dhe për statusin e saj final. Qeveria e Serbisë për çdo metër katrorë dhe hapësirë të banuar apo afariste përmes matrapazëve shqiptarë, me plotë gojën e them të argumentuar dhe avokatëve të mjerë shqiptarë, ofron çmime enorme vetëm për ta nxitur shqiptarët për të ikur. Ndonëse institucionet tona vendore dhe qendrore, nuk kanë mundësi në aspektin financiar pjesërisht për të ndihmuar, por ende nuk kanë marrë asnjë veprim konkret për stimulimin e qëndrimit të mëtutjeshëm të tyre në shtëpitë dhe në trojet stërgjyshore. Ndërtimi i banesave kolektive serbe po bëhet pikërisht në zonën e sigurisë, e cila me të gjitha normat ndërkombëtare trajtohet si zonë e ndaluar për çdo lloj ndërtimi kolektiv dhe individual dhe shqiptarët atje nuk kanë mundësi të ndërtojnë, përveç të disa kokëfortëve.

Bazuar në dokumentacionin e prezantuar, ky ndërtim kolektiv është tipik i karakterit ilegal me prapavijë politike. Ky ndërtim i dedikuar vetëm për serbët, në këtë moment jo vetëm se është politikisht i dëmshëm, por edhe krijon provokime ndëretnike dhe mund të nxisë konflikte, pasojat e të cilave ne nuk i dëshirojmë, por pasojat të cilat do të na kaplojnë të gjithëve nëse sot, nesër, dhe nëse ne nuk marrim masa urgjente, dhe masat janë në duart tona.

Ndërtimi kolektiv që e bën Qeveria e Beogradit nuk është i natyrës urgjente për t'i strehuar të pastrehët, sepse ka shumë vende më të përshtatshme për të ndërtuar banesa kolektive dhe atë në jugun e Mitrovicës kudo dhe në hapësirë shumë më të përshtatshme. Ndërtimi kolektiv që po e bën Qeveria e Beogradit, është i natyrës së përfitimit nga momenti aktual. Ndërtimi kolektiv në veriun e Mitrovicës nuk e ka pëlqimin e komunitetit shqiptar, boshnjakë, romë, egjiptianë, ashkalinj e të tjerë. Këtë e vërtetojnë edhe protestat e shumta demokratike dhe tolerante, por ato nuk dhanë rezultate, sepse hasën në vesh të shurdhët në të gjitha nivelet e organizimit të shoqërisë sonë, duke filluar nga pushteti lokal e deri te ky qendror. Ata të gjithë së bashku nuk kërkuar kurrë pëlqim që fqinjët e tyre për fqinjësinë dhe pushtetin të pengojnë ato, por ishte vullneti i imponuar nga ndërkombëtarët dhe në veçanti nga përkrahja e strukturave komunale për këtë ndërtim. Ndërtimi individual i banesave në pronat e tyre për shqiptarët, romët, ashkalinjët, boshnjakët pengohet dhe pamundësohet çdo ditë me arsyetime ironike se serbët irritohen, se serbët frikohen, se mbi serbët bëhet presion dhe analog kësaj, kjo nuk vlen për shqiptarët. Ndërtimi kolektiv është në kundërshtim të plotë me Ligjin mbi ndërtim, 2004/15 i shpallur me 14 tetor 2004 në Rregulloren e UNMIK-ut 2004/37. Ky ndërtim kolektiv është po ashtu në kundërshtim me Planin hapësinor...(Ndërprerje e diskutimit nga ana e teknikës).

Deputetë të nderuar,

Që nga fillimi i ndërtimit të këtyre banesave kolektive të Qeverisë së Serbisë, e kjo është para dy muajsh, dhënies së pëlqimit për ndërtim nga kryeshefi i ekzekutivit të Mitrovicës, qëndrimi jokëmbëngulës dhe mosvënia në rend të ditës nga Qeveria e Kosovës për ta trajtuar këtë që nga deklarata e lartcekur, në këtë zonë janë shitur 21

shtëpi të shqiptarëve me çmime enorme, derisa Serbia për një banesë që kushton 32.000 euro, 380.000 euro, Qeveria jonë nuk ka ndarë asnjë. Bazuar në shumë fakte, unë i kam propozimet këtu që kërkoj të më lejohen dhe të aprovohen si të tilla dhe nëse nuk aprovohen si të tilla, Kuvendi i Kosovës e ka autorizimin dhe mandatin ta formojë një komision dhe të dalë para këtij Kuvendi për ta votuar apo për t'i hedhur, për ta parë ata banorë dhe ajo pjesë e Kosovës se vërtet a e kemi me vëmendje dhe a e kemi me qëllim të mirë të ruhet tërësia territoriale e Kosovës, sepse parmbremë në emisionin e lajmeve serbe ata kërkojnë nga Liqeni i Gazivodës, Zubin Potoku, Bubi Potoku, Radisheva, Tërnovci, Vushtrria, Obiliqi e deri për buzë lumit Llap konsiderohet sipas Serbisë Kosovë Veriore, dhe i dini ambiciet i shtrinë për ta fituar atë që dëshirojnë, e ajo është kompleksi i Trepçës. Këtu është serioziteti i kësaj teme dhe bazuar në shumë fakte të tjera, unë propozoj këto qëndrime që t'i miratojë Kuvendi i Kosovës, dhe nëse nuk i aprovon, të formojë komision për t'i aprovuar, qoftë në grupet parlamentare, apo në komision ad-hoc që do të krijohet këtu për to.

Nën një, deri në zgjidhjen përfundimtare të statusit të qytetit të Mitrovicës sipas procesit të decentralizimit, i cili ka shumë pak gjasa për t'u realizuar, posaçërisht në zonën e lartcekur, zonë e quajtur e sigurisë të ngrihet gjendja e tanishme, të mos vendoset askush në ato banesa kolektive dhe në veçanti nëse vendosen, të vendosen familje serbe, sepse për serbët po i ndërton Qeveria e Beogradit,

Nën dy, të sigurohet dhe të garantohet lëvizja e lirë e të gjithë qytetarëve veri-jug dhe jug-veri. T'i mundësohet secilit qytetar, pa dallim, të kthehet në pronën, shtëpinë dhe banesën e vet dhe kjo posaçërisht vlen për ne shqiptarët. Të gjitha gjykatat e Kosovës mos të bëjnë transaksione pronëso- juridike deri në plotfuqishmërinë e dokumentit të Ahtisarit, gjegjësisht zgjidhjes përfundimtare të Kosovës. Të bëhet regjistrimi i gjendjes faktike të popullatës, të pasurisë familjare sipas gjendjes dhe dokumentet para luftës për ta dëshmuar të vërtetën juridike dhe etnike të popullatës atje. T'ju mundësohet qytetarëve që të gjitha dokumentet duke filluar nga leja e njoftimit, pasaportat, certifikatat dhe dëshmitë e ndryshme të deklarojnë vendbanimin e tyre dhe jo vendbanimet e qëndrimit si refugjatë kudo në Kosovë dhe jashtë saj. Të formohet fond i veçantë me të cilin do t'u mundësohet, gjegjësisht do të stimulohet qëndrimi i mëtutjeshëm i banorëve pak të mbetur atje në Veriun e Mitrovicës për ta ruajtur atë masë dhe atë popullatë në Veri. Të lejohet ndërtimi individual në themelet e shtëpive të djegura të shqiptarëve, romëve, turqve, boshnjakëve e të tjerëve dhe të gjithë atyre që kanë pronësi, por që kanë pronësinë para luftës.

Në buxhetin e konsoliduar të Kosovës të rritet buxheti për qytetin e Mitrovicës, gjegjësisht i cili do t'i dedikohet pjesës veriore të këtij qyteti. U jam mirënjohës atyre që kontribuojnë për këtë. Nuk kontribuojnë për ata qytetarë që kanë mundësi të pasurohen, por kontribuojnë për Kosovën. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Ftoj ministrin Gjini ta marrë fjalën.

ADRIAN GJINI – Ju faleminderit, zoti Kryetar,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Unë e falënderoj deputetin Kelmendi që e ka sjellë këtë çështje në Kuvend të Kosovës për t'u debatuar, është një çështje e rëndësishme për Kosovën, është një çështje e rëndësishme posaçërisht për njerëzit të cilët jetojnë dhe kanë jetuar atje. Sidoqoftë, sjellja ose tkurrja e problemit në aspektin e ndërtimeve ilegale, realisht ikë prej esencës së këtij problemi. Ajo që pjesa e ekzekutivit, e cila quhet Ministri e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor mund ta bëjë sot, është që t'ju sjellë një pasqyrë të evidentimit të ndërtimeve të cilat kanë ndodhur atje, të cilat realisht janë ilegale si ndërtim. Mirëpo, ajo që po them unë, është se këtu nuk kemi të bëjmë me fenomenin ose me një problem se ato ndërtime janë ilegale në kuptimin e ilegalitetit të ndërtimit, mirëpo ka të bëjë me aspektet të cilat vetë zoti Kelmendi i nxori këtu, janë aspekte të cilat mund të quhen si një presion për atë pjesë të popullsisë shqiptare që ka mbetur atje që të largohet. Nëse do ta kishim tkurrë problemin dhe do të kishim fol për ndërtimet ilegale në Veri të Mitrovicës, atëherë nëse e përmendim faktin se kemi të bëjmë me një numër prej 8 ose pak më shumë se 8 objekte, dhe e krahasojmë me komunat e tjera se sa objekte ka, atëherë e relativizojmë edhe problemin, kështu që ne si Ministri e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk kemi tentuar që ta sjellim dhe ta shndërrojmë këtë problem në problem në problem të ndërtimeve ilegale, mirëpo që t'ju ndihmojmë juve si Kuvend i Kosovës, qoftë në krijimin e komisioneve, qoftë në marrjen e hapave të tjerë, në mënyrë që ky problem të trajtohet si problem ashtu si është, e jo vetëm si problem i ndërtimeve ilegale. Ajo që ne e kemi gjetur në terren, përkundër vështirësive që të marrim informacione, është se në Lagjen e Boshnjakëve i kemi diku 6 objekte të ndërtuara me 120 banesa, 6 objekte kolektive, se i kemi 2 objekte të tjera me etazh P+4 dhe P+6 me 36 banesa, të cilat janë ndërtuar në lagjen "7 shtatori". Ne e dimë se në Veri të Mitrovicës funksionon një sistem jo formal për Kosovën, jo legal paralel, ne e dimë këtë, sidoqoftë atje ekziston një Zyre e UNMIK-ut, e cila quhet Zyrë për urbanizëm dhe e cila merret me çështje të urbanizmit atje.

Nëse shikohen ligjet të cilat janë në fuqi sot, ose Rregulloren 2001/3, këto objekte janë ilegale, si ndërtim i tillë janë ilegale, objekte të cilat nuk janë ndërtuar konform ligjeve të cilat i ka aprovuar ky Kuvend i Kosovës dhe të cilat janë promolguar më vonë, do të thotë të cilat janë në fuqi në Kosovë, kështu që nëse duam t'i trajtojmë si ndërtime ilegale, mund t'i trajtojmë si ndërtime ilegale. Në të njëjtën kohë, nëse trajtohen si të tilla, atëherë është kompetencë e komunës së Mitrovicës që të merret drejtpërsëdrejti me to, përderisa nuk shkon në shkallë të dytë. Mirëpo, prapë se prapë ju e dini se Komuna e Mitrovicës e ka paksa të vështirë, të mos themi të pa mundshme që të merret drejtpërdrejt me atë që është duke ndodhur. Këto janë disa informacione të shkurta dhe qëllimi pse po i japim të këtilla, fillimisht është se është vështirë të marrim informacione të plota dhe, e dyta, nuk po tentojmë që ta shndërrojmë këtë debat në debat për ndërtimet ilegale për shkak se nuk është, është debat për diçka tjetër. Unë do të jem me ju për çfarëdo pyetje tjetër që të keni, do tentoj ta jap kontributin tim me gjithë atë që kemi mbledhur në Ministri, mirëpo prapë se prapë po them se ky është debat për diçka tjetër, jo konkretisht për ndërtime ilegale. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Në emër të LDK-së, Ilmi Ahmeti. Urdhëroni!

ILMI AHMETI – Ju faleminderit, zoti Kryetar!
I nderuari Kryetar,

Të nderuar ministra,
Deputetë të nderuar,

Tetë vjet pas mbarimit të luftës në Kosovë, institucionet e përkohshme të qeverisjes Kosovës nuk po arrijnë të shtrijnë pushtetin në tërë territorin e Kosovës. Fatkeqësisht, as UNMIK-u në shumë sfera të jetës nuk e arriti të ketë pushtetin në pjesën Veriore të Kosovës, e sidomos në Veriun e Mitrovicës. Si pasojë e mungesës së pushtetit demokratik, do me thënë e mungesës së ligjshmërisë, po lindin probleme sikur ky që po e debatojmë sot, i krijuar nga politika e Serbisë, e cila me ndërtimet ilegale që po i bën në Veriun e qytetit të Mitrovicës, po bën presion me të vetmin qëllim që shqiptarët të shpërngulen nga shtëpitë dhe banesat e veta. E përcaktuar për paqe, rend, siguri, për lëvizje të lirë të njerëzve dhe të mallrave, për të drejta individuale dhe kolektive të të gjithë qytetarëve, përfshirë të drejtën edhe në pronën dhe në patundshmëri, Lidhja Demokratike është kundër çdo forme të presionit që ka për qëllim shpërnguljen dhe kërkon që forma të tilla të presionit të ndërpriten menjëherë. Për të realizuar pastrimin etnik të veriut të Mitrovicës, politika serbe nuk po zgjedh mjete. Fillimisht, pas lufte u pengua kthimi i shqiptarëve në shtëpitë dhe në banesat e tyre në veri të qytetit. Ata pak shqiptarë që arritën të kthehen, asnjëherë nuk patën siguri. Një rebelim i bandave serbe në mars të vitit 2000 shpërnguli dhunshëm pothuaj se të gjithë shqiptarët nga veriu i qytetit. Ata që mbeten, mbeten kryesisht në lagjet që shtrihen buzë lumit Ibër, si lagja e Boshnjakëve, lagja e Doktorëve dhe lagja “7 shtatori”, lagje këto pothuaj se kompakte me popullatë shqiptare, të cilat po atakohen me format të presionit të cilat u thanë në fillim, pra me ndërtime të ndërtesave shumëkatëshe për banim kolektiv të financuara nga Qeveria e Serbisë, nëpërmjet investitorëve privat serbë për të vendosur familjet serbe të ardhura edhe nga jashtë Kosovës, gjë që po rritë pasigurinë e shqiptarëve dhe të tjerëve jo serbë për të qëndruar në shtëpitë e tyre.

Blerja e pronave dhe ndërtimet vetëm në këto lagje buzë rrjedhës së lumit, zonë të cilën UNMIK-u e quan zonë sigurie, po bëhen për qëllime politike e jo për qëllime afarizmi, prandaj këto ndërtime edhe e kanë tensionuar situatën dhe si rrjedhojë kemi reagime të qytetarëve të këtyre lagjeve. Këto ndërtime për banim kolektiv po bëhen pa asnjë plan urbanistik. Pa plan rregullativ dhe në kundërshtim të plotë me Planin hapësinor urbanistik të qytetit të Mitrovicës. Administrata lokale e UNMIK-ut nuk u konsultua fare me Kuvendin Komunal të Mitrovicës për ndërtimin e këtyre ndërtesave dhe nuk mori kurrfarë pëlqimi, bile as që kërkoi një gjë të tillë. Deklaratat e kësaj administrate se këto ndërtime po i bëjnë afaristët serbë dhe se po bëhen në bazë të një plani urbanistik të qytetit të viteve të 60-ta nuk qëndrojnë.

Ne e dimë mirë se nga ishte i orientuar ndërtimi i qytetit në ato vite. Mendoj se Qeveria e Kosovës, Kuvendi Komunal i Mitrovicës, në bashkëpunim të plotë me UNMIK-un, duhet të veprojnë me qëllim të parandalimit të veprimeve të tilla në mënyrë që me ndërtime të arrihet të zgjidhen çështjet e banimit, e jo çështjet politike, siç po ndodhë. Ka raste kur pronarë të ligjshëm nën kërcënime kanë qenë të detyruar t'i shesin pronat, e ku viktimë janë shqiptarët dhe etnitë e tjera jo serbe. Me qëllim të parandalimit të shitjeve të tilla, UNMIK-u duhet të zbatojë Rregulloren nr. 2001/17 mbi regjistrimin e kontratave për shitblerje të patundshmërive në zona të veçanta gjeografike të Kosovës, sidomos në rastet kur shitjet mund të qojnë drejt prishjet së sigurisë dhe kur fondet janë të dyshimta. Kërkesat e vazhdueshme të shqiptarëve për trajtim të barabartë në

ndërtime nuk po përfillen nga administrata e UNMIK-ut. Edhe pse ka pasur donacione për ndërtim të shtëpive të shqiptarëve në themelet e shtëpive të djegura dhe të rrafshuara, nuk u lejua asnjë ndërtim me arsyetimin se për implementim të ndërtimeve nga donacionet duhet pëlqimi i komunitetit serb. Ky pëlqim mungon dhe nuk do të jepet kurrë. Ndërsa, për ndërtime të serbëve nuk kërkohet pëlqim të shqiptarët.

Administrata e UNMIK-ut nuk iu përgjigj kërkesës së Kuvendit Komunal të Mitrovicës që të mos ngutet me këto lloj ndërtimesh. Pse kjo ngutje dhe pse ndërtime vetëm në vijën ndarëse të qytetit ku po ndërtohen mbi 100 banesa vetëm për serbë, ndërsa shqiptarëve nuk iu lejohen as ndërtimet individuale private të shtëpive me arsyetimin se serbët nuk ndihen të sigurt. Shtrohet pyetja: Si na qenkan të sigurt serbët të ndërtojnë mu në mes të lagjeve të banuara tërësisht me shqiptarë.

Deputetë të nderuar,

Lidhja Demokratike e Kosovës kërkon që kriteret për ndërtim në tërë territorin e Kosovës dhe për të gjithë të jenë të njëjta. Të hiqet dorë nga ndërtimet për qëllimet politike, sikur këto që u thanë, dhe ndërtime të tjera që janë bërë, si ai në buzë magjistrale të Ibrit, mu në vendin ku lidhet ruga e fshatit Zhazhë, e cila lidhet në këtë magjistrallë, do të thotë është bërë një ndërtim mu në udhëkryqin ku lidhet kjo rrugë me magjistrale.

Qeveria e Kosovës vazhdimisht ka ndarë dhe ndanë mjete nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe kërkon edhe donacione për të ndërtuar shtëpi për të kthyerit, e sidomos për serbët, ndërsa Qeveria e Serbisë po e pengon kthimin me ndërtime të tilla, duke ndërtuar vetëm në vijat ndarëse të Kosovës. Çështjet si kjo që po debatohet, dhe çështjet të lidhen me veriun e Kosovës, kërkojnë angazhimin e të gjithëve, të të gjitha institucioneve të Kosovës, të të gjitha subjekteve politike, duke i stimuluar qytetarët të qëndrojnë në shtëpitë dhe në pronat e tyre. Sepse, statusi i Kosovës kam bindjen se do të zgjidhet mbi bazën e tri parimeve kryesore të grupit të kontaktit dhe se nuk do të ketë ndarje, siç thonë disa politikanë dhe shkruajnë disa mjete të informimit në Kosovë, me çka po e rrisin pasigurinë e popullatës shqiptare dhe nxisin edhe më tepër shitjen e pronave në Veri të qytetit të Mitrovicës. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Përfaqësuesi i PDK-së. Urdhëroni, zoti Hyseni!

HYDAJET HYSENI – Zonja dhe zotërinj deputetë,
I nderuari ministër,
I nderuari zoti Kryetar,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe si njeri që kam pasur rastin e fatin për të kaluar një pjesë të jetës sime në Mitrovicë, tok me njerëzit e saj të mrekullueshëm, sa të varfër e të përvuajtur, aq edhe të vyeshtë, fisnik dhe bujar, t'i bashkëngjitemi shqetësimit të shtruar me të drejtë në këtë debat lidhur me ndërtimet ilegale, të cilat ministri theksoi të mos vlerësohen vetëm si ndërtime ilegale, me të drejtë. Por ne e kemi kuptuar këtë nismë ashtu siç edhe është shkruar në tekstin, si nismë për të diskutuar për ndërtimet ilegale të banesave kolektive,

që ka një dimension nga Qeverisa e Serbisë, ndërtime ilegale të një qeverie që është jashtë Kosovë në lagjet veriore të qytetit të Mitrovicës dhe pasojat që prodhon kjo. Mendoj se kështu, siç është shtruar, edhe do të duhej shqyrtuar, dhe, për më tepër, duke pasur parasysh se e gjithë kjo është vetëm pjesë e revanit të ri të politikës së ndryshimit të përbërjes etnike dhe të kolonizimit të ri të Kosovës dhe të pjesëve të saj.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës kundërshton me forcë dhe denoncon ndërmarrjet e palejueshme si prirje të rrezikshme të drejtuara kundër përpjekjeve të të gjithë veprimtarëve dhe njerëzve të vullnetit të mirë për normalizimin e plotë të gjendjes në këto pjesë të Kosovës dhe përgjithësisht në Kosovë e më gjerë, për ndërtimin e përbashkët e të një të ardhmeje të lirë, të pavarur, demokratike, pluraliste e tolerante, prosperuese e evropiane.

Grupi Parlamentar i PDK-së angazhohet për qasje parimore të përgjegjshme, por edhe të kujdesshme, të pjekur e të balancuar të situatave dhe të problemeve të kësaj natyre, duke mos lejuar si injorimin dhe nënvlerësimin e fenomeneve të këtilla, që për fat të keq, e gjejmë te qëndrimi i Qeverisë, ashtu edhe ekzagjerimin dhe politizimin e tyre në një ambience edhe ashtu të stërpolitizuar dhe tejet delikate. Lidhet kjo çështje edhe me Ligjin që miratuar sot, edhe me debatin që kishim dje, lidhet edhe me procesin që po ndodhë në Kosovë. Në pamje të parë mund të duket si diçka e vogël, e zakonshme, e pasherrë, ndërtohen objekte banimi për të kthyerit, të shpërngulurit dhe të zhvendosurit, siç ndërtohen edhe gjetiu në Kosovë. Politika e kthimit në Kosovë, e banorëve të saj, të shpërngulur që duan të kthehen dhe të jetojnë në Kosovë, është politikë gjerësisht e përkrahur në Kosovë. Këtë politikë në parim askush nuk e konteston dhe deri këtu nuk ka asgjë të keqe. Nuk do të kishte vërtet asgjë të keqe po të ishte fjala për një ndërmarrje të zakonshme humanitare e gjithëpërfshirëse. Por siç dihet e siç po shihet, fjala është për diçka tjetër, diçka që të kujton planet e elaboratet e Qubriloviqit dhe të autorëve të tjerë të strategjive gjenocidale të inxhinieringut entik kundër popujve jo serbë, veçanërisht kundër shqiptarëve. Të kujtojmë vetëm ndonjë fakt, Mitrovica matanë Ibrit para luftës së fundit dhe në vijimësi ka qenë e populluar me shumicë shqiptare. Tani popullata shqiptare atje është simbolike. Dhjetëra mija shqiptarë u dëbuan nga vatrat e tyre në mënyrë të organizuar, sistematike dhe institucionale, pa asnjë arsye, madje pa asnjë pretekst dhe duke zbatuar me përpikëri instruksionet e elaborateve të Qubriloviqit me shokë. Në funksion të këtij synimi u likuiduan në mënyrë mizore intelektualë e veprimtarë të shquar si Mehë Uka, Latif Berisha, Agim Hajrizi e sa e sa të tjerë dhe për këtë ende askush nuk ka dhënë llogari. Dhjetëra mijëra të dëbuar me dhunë, jo vetëm që nuk janë ndihmuar që të kthehen në vatrat e tyre në përputhje me politikën e miratuar nga institucionet e Kosovës, dhe prania ndërkombëtare në Kosovë, si dhe sa e sa konventa dhe rezoluta e dokumente universale ndërkombëtare, por për më tepër edhe kthimi i tyre individual pengohet e pamundësohet në mënyrë të organizuar dhe me të gjitha mjetet. Arsye e vetme është përkatësia e tyre kombëtare. Nuk lejohet në shtëpitë ose trojet e tyre i atyre që kanë jetuar brez pas brezi në Mitrovicë, që kanë lindur e janë rritur aty, kurse planifikohen dhe realizohen planet për vendosje pikërisht në këto lagje, të ish të shpërngulurve ose edhe të ardhësve të tjerë nga viset e ndryshme edhe jashtë Kosovës, por me përkatësi ekskluzivisht jo shqiptare.

E gjithë kjo ndodhë në pjesën e ndarë me dhunë të qytetit e cila është përfshirë në planet për copëtimin e ndarjen e mëtejshme etnike. E gjithë kjo financohet dhe praktikisht

realizohet nga Beogradi zyrtar, i cili as që e fsheh oreksin për aneksimin dhe deshqiqtarizimin e plotë të kësaj pjese të Kosovës. E gjithë kjo bëhet nga qarqe politike e strategjike të cilat kanë dëbuar nga trojet e tyre në Preshevë, Bujanoc, Medvjege, Beograd e gjetiu me dhjetëra mijëra shqiptarë e për kthimin e të cilëve, jo vetëm që nuk bëhet asnjë përpjekje, po për më tepër, ka plane e projekte për pengimin dhe pamundësimin e kthimit të tyre në vatrën e tyre. Si e tillë, kjo ndërmarrje nuk ka absolutisht asgjë të përbashkët me donacionet e vendeve të ndryshme humanitare e paqedashëse në funksion të normalizimit të gjendjes në një shoqëri postkonflikti. Pavarësisht si kamuflohet e si pagëzohet, emri i saktë i kësaj ndërmarrjeje është kolonizim dhe spastrim etnik. Pavarësisht nga petku i ri, kjo është vazhdimësi e politikave të Millosheviqit dhe të paraardhësve të tij.

Nëse planet dhe politikat tashmë të njohura gjenocidale të Beogradit nuk befasojnë askënd, nuk mund të mos befasojë prirja për tolerimin e kësaj politike që i ka kushtuar aq shumë, jo vetëm Kosovës dhe popujve për rreth, por jo më pak edhe vetë Serbisë dhe popullit serb. Për më tepër, nuk mund të mos habit fakti se në këtë ndërmarrje të dënueshme dhe ndërmarrje të tjera të ngjashme, sipas të gjitha gjasave, shfrytëzohen edhe mjete dhe fondacioneve dhe të qendrave të ndryshme financiare, humanitare e ndërkombëtare. Të marrësh pjesë, qoftë edhe në mënyrë të tërthorët, në financimin e projekteve të tilla, do të thotë të marrësh përgjegjësinë edhe për pasojat që do të rrjedhin nga projektet e këtilla. Edhe soldateska vrastare e Millosheviqit ka qenë forcuar, e armatosur duke shfrytëzuar ndihma e kredi nga fondacionet e ndryshme ndërkombëtare, e madje edhe nga qeveritë, që më vonë u detyruan të përdorin avionë e raketa, por edhe të shpenzojnë para të mëdha për ta ndaluar harangën e kuçedrës shoviniste të çartur e të azdisur edhe nga forca e tepruar që e kishte siguruar. Është më e mirë që e keqja të parandalohet me kohë se sa të shërohet pasi të marrë hov. Gjeneratori i të keqes në Ballkan ka qenë në vijimësi politika dhe filozofia e politika gjenocidale e shovinizmit serbomadhi, e spastrimit etnik, të zhbërjes së popujve të tjerë dhe të dominimit, politikë kjo që, për fat të keq, ende nuk ka marrë dënimin e duhur ndërkombëtar.

Plane e projekte si ky i fundit në Mitrovicë, prezantohen si plane e projekte për të mirën e qytetarëve serbë të Kosovës dhe të serbëve në përgjithësi. Por, siç ka dëshmuar sa e sa here përvoja, projekte e plane të tilla me të vërtetë janë jo vetëm antishqiptare, por janë thellësisht edhe antiserbe. Ato, jo vetëm që nuk kanë ndihmuar serbët Kosovës dhe serbët në përgjithësi, por i kanë dëmtuar ata seriozisht, e kanë dëmtuar seriozisht edhe bashkëjetesën dhe perspektivën e përbashkët në Kosovën e re. Planet dhe projektet e tilla i vështirësojnë dhe i dëmtojnë seriozisht edhe përpjekjet që bëhen në Kosovë për pajtim, integritet e bashkëjetesë, dhe për ne kjo është një arsye plotësuese pse e kundërshtojmë këtë projekt. Megjithatë, është mirë që shumica shqiptare nuk lejon që logjikës shoviniste dhe eskluvizmit etnik t'i përgjigjet po me të njëjtën gjuhë. Përkundrazi, qasja parimore, inkluzive dhe pajtuese është përgjigja më e mirë ndaj planeve dhe projekteve të paperspektivë të inxhinieringut etnik.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, mbështet rekomandimet e propozuara dhe angazhohet që ato bashkë me rekomandimet që do të dalin nga ky debat, të harmonizohen dhe të miratohen si dokument i përbashkët i këtij Kuvendi që e obligon Qeverinë që të mos mjaftohet vetëm me konstatimin e gjendjes, të mos lejojë

që të bëjë sehir, por të ngritët në nivelin e përgjegjësisë që ka, së paku aq sa e ka, le ta bëjë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Në emër të AAK-së, Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit!

I nderuari zoti Kryetar,
Të nderuar ministra,
Deputetë të nderuar,

Diskutimi im i sotëm është i bazuar në të dhënat nga Ministria e Planifikimit Hapësinor, por më shumë është i bazuar në të dhënat që i ka marrë në takimet me qytetarët në Veri të Mitrovicës, me përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare dhe me zyrtar të Kuvendit Komunal. Prandaj, që në fillim dëshiroj t'i falënderoj të gjithë për bashkëpunim. Edhe pse debati i sotëm ka të bëjë me ndërtimet ilegale, kolektive nga Qeverisa e Serbisë në Veriun e Mitrovicës, ai nuk mund të trajtohet si i veçantë, i ndarë nga problemi i Mitrovicës në tërësi.

Çështja e Mitrovicës është komplekse dhe është problem politik, por edhe i sigurisë, ekonomik dhe social. Statusi i pazgjedhur politik i Kosovës ndikon në moszgjidhjen e problemit të Mitrovicës, kurse kjo thellon krizën ekonomike dhe sociale. Liria e lëvizjes është e kufizuar dhe posedimi ilegal i pronës së banimit po rritë tensionet. Tetë vite pas luftës në Kosovë, në Veriun e Mitrovicës ende nuk është siguruar një ambient i sigurt ose sundim i ligjit. Strukturat paralele vazhdojnë të ekzistojnë dhe veprojnë të papenguara. Moszgjidhja e statusit të Kosovës, prolongimi dhe zvarritja si dhe prononcimet e disa diplomatëve ndërkombëtarë për ndarjen e Veriut të Mitrovicës po rrisin frikën dhe pasigurinë, sidomos në mesin e shqiptarëve. Kjo po ashtu po ndikon që ata t'i shesin pronat e tyre, të cilat po blihen nga Qeveria e Serbisë.

Koncepti i Qeverisë së Serbisë, me blerjen e pronave dhe me ndërtimet është i bazuar në ndarjen etnike me krijimin e kufirit etnik, që është koncept i gabuar mesjetar. Derisa koncepti i Qeverisë së Kosovës është qasja multikulturore dhe multietnike që është koncept evropian, prandaj duhet investuar në te.

Te qëndruar deputetë,

Me qëllim të kuptimit më të mirë të problemit të pronës dhe të ndërtimeve në Veriun e Mitrovicës duhet rikujtuar fillimin e tij, si proces që nga koha kur PSSP, zoti Shtajner ka formalizuar marrëveshjen me Qeverinë e Serbisë më 25 nëntor 2002. Në Mitrovicë u krijuan dy administrata në veri dhe jug. Që atëherë Qeveria e Serbisë ka filluar t'i blejë banesat e shqiptarëve me tendencën për ta bërë komunë në vete. Qeveria e Serbisë blerjet i bën nëpërmes investitorëve privat, kurse ana formale juridike realizohet në gjykatat paralele dhe ato të UNMIK-ut, të cilat i mbyllin sytë duke i lejuar ndërtimet. Ndërtimet po bëhen kryesisht në lokalitetet e banuara me shqiptarë. Siç e shpjegoi ministri Gjini, UNMIK-u nuk ka vepruar sipas Rregullores 2001/3, por kryesisht në bazë të rregullativave të viteve të 60-ta. Mënyra e veprimit të Qeverisë së Serbisë është se në njërën anë bën presion, dhe në anën tjetër paguan çmime të larta për banesa e shtëpi. Derisa presioni është bërë me frikësimet si hedhja e bombave, ajo është duke u bërë edhe nga njëherë heshtazi në formë të kërcënimeve dhe të frikësimeve verbale.

Serbët mbështeten nga Beogradi ku bëhet transferi i drejtpërdrejtë nga buxheti i Serbisë për Veriun e Mitrovicës. Me qenë se nuk ka transparencë dhe llogaridhënie, shkalla e korrupsionit është e lartë. Pos kësaj, deri sa në Jug të Mitrovicës nga buxheti i komunës për Administratën e UNMIK-ut ndahen 14,3% e në disa raste edhe deri 29.2%, në Veri ku të hollat vijnë nga Qeveria e Serbisë, 99% ndahen për Këshillin Nacional Serb dhe për administratën lokale, kurse për UNMIK-un vetëm 1%. Ky është tregues i qartë se sa e limituar është influenca e UNMIK-ut në veri.

Gjatë luftës në Veri janë djegur 123 shtëpi të shqiptarëve, të cilëve nuk u lejohen ndërtimet për shkaqe sigurie. Ne administratën e udhëhequr tërësisht nga serbët, 100 nga 170 të punësuar, vetëm një është shqiptar. Prandaj, papunësia është e madhe dhe kushtet socialo-ekonomike janë të këqija. Pasiguria është, po ashtu, e lartë. Nuk ka sundim të ligjit. Në Veri po zbatohen ligjet e Serbisë dhe jo të Kosovës. Policia dhe gjykatat nuk janë aktive, nuk ka sistem efektiv të shkatërrimit të ndërtimeve ilegale. Banorët shqiptarë dhe serbë nuk janë të barabartë. Për serbet rryma është falas, uji dhe tatimet nuk paguhen. Kjo nuk vlen për shqiptarët. Asnjë njësi e kontrollit qeveritar për tatimet nuk është bërë në pjesën serbe. Veturat lëvizin pa tabela ose me tabela të Serbisë. SHPK është në numër të vogël dhe rrethi ku punojnë është i kufizuar. Fëmijët shqiptarë kryesisht mësojnë në shkollat në jug të Mitrovicës. Për shkak të lidhjeve të limituara të transportit, lëvizjen e kanë të vështirësuar. Nuk ka bashkëpunim të Veriut dhe Jugut të Mitrovicës. Bashkësia Ndërkombëtare nuk është duke punuar në ndërmjetësim. Të gjithë këta tregues, qartë demonstrojnë se shkalla e pronës dhe e problemit të kthimit në Mitrovicë duhet të adresohet.

Të nderuar deputetë,

Zgjidhja e statusit ndikon zgjidhjen e problemit të Mitrovicës, e me këtë edhe të pronës dhe të ndërtimeve. Së voni Qeveria i ka ndarë 150.000 euro ndihma për veriun, kurse nga komuna më herët janë ndarë 30.000 euro. Problemi është kompleks dhe zgjidhja kërkon qasje multilaterale. Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës propozon këto masa:

1. Formimi i një trupi institucional për informimin e saktë mbi gjendjen dhe përcjelljen e informatave në institucionet lokale dhe qendrore të Kosovës.
2. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitutional në mes të Komunës, të Qeverisë, të Kuvendit, por edhe të Bashkësisë Ndërkombëtare. Kjo duhet të bëhet në tri fusha të rëndësishme: në siguri, ekonomi dhe punësim. Qeveria e Kosovës të ndajë fondin për rindërtim dhe të ndërtojë objekte banimi kolektiv për të varfrit.
3. Hapat konkret duhet të ndërmerren në drejtim të vendosjes të rendit dhe të ligjit:
 - a) regjistrimi i tabelave të Kosovës, të automjeteve në Veriun e Mitrovicës,
 - b) regjistrimi i bizneseve,
 - c) mbledhja e tatimeve, pagesa e rregullt e rrymës, ujit dhe e shërbimeve të tjera publike,
 - d) zbatimi i ligjeve dhe i rregulloreve në fuqi, duke përfshirë respektimin e plotë për të drejtat pronësore dhe përkrahjen për kthim.

4. Për rritjen e sigurisë duhet të shtohet numri i anëtarëve të SHPK-së që patrollojnë në këmbë dhe lëvizin më shpesh, ashtu që qytetarët t'i shohin.
5. Të kushtëzohet direkt Beogradi nga donatorët ndërkombëtarë që ta ndërpresin mbështetjen financiare të strukturave paralele. Strukturat paralele duhet të shpërbëhen.
6. Të zbatohen standardet për Kosovën si në pjesët e tjera të Kosovës, sidomos në fushën e sundimit të ligjit, të sigurisë për të gjitha komunitetet, monitorimi i kufirit me Serbinë dhe shërbimet publike efikase, të funksionojë institucioni i auditorit të përgjithshëm,
7. Ministria për kthim të sigurojë qarkullimin më të shpeshtë të autobusëve, sidomos për bartjen e fëmijëve në shkolla dhe në rastet e sëmundjeve,
8. Të vizitohen dhe të inkurajohen rregullisht banorët nga përfaqësuesit e institucioneve, të zhvillohet bashkëpunimi Kuvend, Qeveri, Komunë qytetarët,

Të nderuar deputetë,

Këto janë kërkesat e qytetarëve shqiptarë në Veri të Mitrovicës. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zonja deputete! Nëse nuk gabohem, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Reformiste ORA, deputeti Gazmend Muhaxheri. E keni fjalën.

GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit, zoti kryesues,

Mënyra se si është thirr ky debat tregon se sa efikase e kemi edhe Kuvendin, po edhe Qeverinë. Ky debat i ngjanë një vajtimi ose një rekuemi për Mitrovicën, i thirrur për të shprehur mllefën dhe për të qarë për pamundësinë e veprimit karshi halleve dhe problemeve që i ka qyteti i Mitrovicës. Detyra e atij që është në pushtet, është që të veprojë. Kam qenë në një vizitë vitin e kaluar së bashku me shefin e Grupit Parlamentar dhe kryetarin e Partisë zotin Veton Surroi. Kemi vizituar shkollën, ambulancën dhe i kemi parë problemet e shqiptarëve në Kodrën e Minatorëve. Prej atje është përcjellë një rekomandim, të cilin Qeveria e Kosovës e ka marrë dhe ka ndarë në korrik të vitit 2006 mjete për ndërtimin e shkollës. Tash jemi në gusht të vitit 2007, nxënësit atje ende vitin e ardhshëm do të shkojnë në shkollë në kontejnerë. Me mjetet që janë ndarë për atë shkollë, po të kishte pasur një qeveri efikase, do të ishte ndërtuar një shkollë bile së paku dy klasëshe. Kjo Qeveri ka ndarë miliona për fshatin Hade, vetëm për banorët e fshatit Hade 280 banorë, i ndanë në vit 1.600.000 euro. Kur është interesi privat i dikujt dhe kur Qeveria ka interes material, atëherë është efikase në veprim, ndërsa kur është problemi shumë më i madh, por nuk ka interesa private të qeveritarëve, atëherë negjim.

Nuk është ndërmarrë asnjë veprim që banorëve të Mitrovicës së Veriut, të cilët nuk mund të kthehen në shtëpitë e tyre, t'u lehtësohet pak barra, t'u sigurohen materiale siç u janë siguruar banorëve të fshatit Hade, i cili gjendet në mes të Kosovës, ka mundur të pres problemi i tyre edhe 5 vjet dhe të mos zgjidhet, por problemi i Mitrovicës është problem aktual dhe i takon Qeverisë dhe e ka mbështetjen edhe te sponzorizuesit e këtij debati që të marrë hapa konkret. Nuk mundet Kuvendi të marrë hapa konkret, por i takon Qeverisë që në bazë të planit të vet ose në bazë të rekomandimeve që i merr, të ndërmarrë hapa konkret për të ndihmuar në zgjidhjen e problemit të banorëve të

Mitrovicës, e sidomos të atyre që për halle të ndryshme detyrohen t'i shesin shtëpitë e tyre.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar 6+, deputeti Mahir Yagcilar.

MAHIR YAGCILAR – Ju faleminderit zoti kryesues,

Sayın Meclis Başkan vekili, sayın bakanlar ve değerli milletvekilleri

6+ Parlamenter Grubu, Mitroviça kentinin kuzey semtlerinde toplu konutların kaçak inşaatının engellenmesi ile ilgili tartışmayı desteklemektedir.

Dolayısıyla Mitroviça sorunu, Kosova'nın en ciddi sorularından birini oluşturmaktadır. Bu sorunun halledilmesi hepimizin temel amacı olmalıdır. Tüm vatandaşlara normal ve güvenli bir yaşamın sağlanması şarttır. Maalesef son zamanlarda kuzey Mitroviça'nın Boşnak mahalesinde yaşayan Türk ve Boşnak topluluğuna mensup vatandaşlara karşı da tahrik ve baskı olayları sıklaşmıştır. Genelde göçe yönelik baskılar, tehditler ve diğer rahatsız edici olaylar yaşanmaktadır. Bu durum karşısında ister topluluk olarak ister de parti düzeyinde UNMIK, AGİT, KPH ve KFOR' a mektup göndererek sesimizi duyurduk. Kaçak toplu konut inşaatı, nüfus strüktürünün değiştirilmesi ve bütün vatandaşların güvensizliğine yönelik belirgin bir sorun olduğundan dolayı tedbirlerin alınması gerekir.

Bundan dolayı bütün tarafları, yasa dışı girişimler ve kaçak konut inşaatından caymalarını ve aynı zamanda daha toleranslı bir tavır takınarak, vatandaşlar arasında güvensizliğe neden olabilecek her çeşit baskılardan uzak durmaları çağrısında bulunuyoruz.

Yetkili Bakanlık, yasalara aykırı olan kaçak inşaatların önlenmesine yönelik incelikli bir rapor ve önlemlerden oluşan bir önerge hazırlamasını istiyoruz.

Prensipte önerici tarafından sunulan sonuçları destekliyoruz, ancak, bugünkü tartışmalardan çıkan yapıcı önerilerin de nihai raporla kapsanması gerektiğini düşünüyoruz.

İlginize teşekkürler.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Haxhi Merxha e ka fjalën.

HAXHI MERXHA – Ju faleminderit, zoti kryesues, ju përhëndes Juve dhe ministrat që janë këtu me ne, po ashtu të gjitha zonjat dhe zotërinjtë që kanë mbetur deri në fund të kësaj mbledhjeje,

Po më vjen shumë keq kur po flitet për një problem të madh të Kosovës, sidomos për Veriun e Mitrovicës, këtu nuk kemi forum. Një nga një po e marrin çantën e po dalin jashtë, e askush nuk po u thotë ngadalë se ti je kah merr rrogën e deputetit, edhe mëditjen. Mirëpo, tash kanë mbetur këtu ata që janë të disiplinuar, që gjithmonë

mbesin këtu edhe janë të dëgjueshëm. Kjo është për të vajtuar Mitrovicën, por edhe këtë Parlament është për ta vajtuar qysh njëri - tjetrin nuk po e dëgjojmë, por po ikim. Nga Grupi im kam mbetur vetëm dhe nuk po di çka të flas, se ai që është përgatitur, i ka marrë sendet me veti dhe ka ikur. Mirëpo, prapë jam një shenj i tyre këtu. Vërtet, ajo që e thanë parafolësit e mi të shtynë ta vajtosh Mitrovicën e Veriut, kurse ne në Parlament nuk po mund të durojmë disa orë, që jemi të paguar, që marrim mëditje, që kemi emrin e deputetit. Po më vjen çudi, mirëpo le të jetë në nderin e tyre që e kanë lënë Parlamentin e kanë shkuar. Faleminderit prej këtyre që janë këtu dhe që janë të durueshëm. Faleminderit për dëgjim!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Emriush Xhemajli.

Zonja deputete, Besa Gaxherri, Grupi i juaj Parlamentar është paraqitës i mocionit dhe do ta ketë fjalën prapë në fund në emër të Grupit Parlamentar dhe, normalisht, deputetët që paraqiten për fjalë sipas radhës. Ju faleminderit!

EMRUSH XHEMAJLI - Zotëri kryesues, zotërinj ministra, kolegë deputetë dhe deputete,

Lëvizja Popullore e Kosovës përshëndet këtë debat për Mitrovicën dhe në veçanti angazhimin e zotit Ramadan Kelmendi dhe të Grupit të tij Parlamentar për t'u zhvilluar ky debat dhe për angazhimin e tyre që të sjellin sa më tepër të jetë e mundur fakte, të dhëna lidhur me gjendjen në terren. Gjithashtu, janë propozuar edhe rekomandime. Unë i mbështesë të gjitha pikat e rekomandimeve që janë propozuar nga nismëtarët e debatit lidhur me pronat dhe ndërtimet, lëvizjen e qytetarëve në të dy anët e Mitrovicës, kthimin, ofrimin e shërbimeve komunale dhe administrative për qytetarë, pa dallim, dhe evidentimin e banorëve.

Ky debat për Mitrovicën, gjithashtu, po përputhet me kohën kur janë shpeshtuar zërat ndërkombëtar, por edhe vendor për ndarjen e Kosovës, përkatësisht për marrjen e një pjese të territorit të saj nga ana e Serbisë. Për Kosovën nuk është prioritet rregullimi i vijës kufitare, por dihet, prioritet është pavarësia e vendit. Për rregullimin e vijës kufitare bisedojnë shtetet, shtetet që janë të pavarura dhe të pranura ndërkombëtarisht, jo ata që nuk kanë pavarësi ose që kanë konteste. Për Kosovën, deklaratat për ndarje i bëjnë për, mendimin tonë, ose ata që kanë qëllime djallëzore në Ballkan, ose ata që janë naiv në politikë. Pavarësisht nga qëllimet e mira a të këqija, sido që të jetë, thirrja për ndarje është thirrje për luftë. Përpjekja për ta ndarë një territor kompakt, vetvetiu në terren sjellë lëvizje që konfrontohen, lëvizje që qojnë në më të keqen. Ndarja, por edhe Mitrovica si term, fatkeqësisht, në vazhdimësi, por edhe tash po përdoren si një instrument iluzioni për t'u krijuar përshtypje se Kosova gjoja e ka zgjidhur çështjen dhe ka mbetur gjoja vetëm Mitrovica, vetëm kufijtë, vetëm zona kufitare. Me demok, kjo do të thotë që pjesa tjetër është bërë e mëvetësishme, kjo vetvetiu po krijon një lloj iluzioni. Kosova në çfarëdo varianti nuk ka territore të Serbisë brenda vetvetes. Përkundrazi, Serbia mban jo vetëm Medvegjën, Bujanovcin, Preshevën që janë pjesë të Kosovës, por Serbia mban edhe territoret, që dihet, të Sanxhakut të Nishit që janë spastruar

Për mendimin tonë, pasi është fjala për Mitrovicën, për Veriun, për tentativat për ndarje, duhet të theksojmë se Serbia tash e ka shansin e fundit historik për ta njohur Kosovën në këta kufij që është. Nëse në vazhdimësi refuzon, mund të vijë një ditë që ne do të jemi ata që nuk do t'i pranojmë kufijtë e Serbisë në Verilindje të Kosovës dhe do të kërkonim të na kthehen trojet tona të grabitura. Kjo mua më duket si diçka që nuk është ndoshta politikë e ditës, ose në kuadër të politikës zyrtare, por duhet të mbajmë në mend se situatat politike shpejt kanë defiluar nëpër Kosovë që nga viti 1981 dhe në këtë vrap do ta kenë edhe në të ardhmen. Unë edhe njëherë i shpreh mirënjohje Grupit Parlamentar të LDD-së, që e ka bërë debatin dhe kërkoj që të vihen në votim kërkesat, përkatësisht rekomandimet e tyre.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zoti deputet. Hapet debati. Deri më tani ishin: paraqitësi i mocionit, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, pastaj shefat e grupeve parlamentare dhe deputeti Emrush Xhemaili, në emër të partisë që e përfaqëson. Për debat janë të paraqitur 14 deputetë dhe hapim debatin, pra, sipas radhës. Fjalën e ka deputeti Ibush Jonuzi.

IBUSH JONUZI – Ju faleminderit!

I nderuari kryesues,
Ministra të pranishëm,
Të respektuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Debati që po bëhet sot për ndërtimet ilegale në Komunën e Mitrovicës, e me theks të veçantë në pjesën veriore të Mitrovicës, është shqetësim për të gjithë ne. Ndërtimi ilegal i banesave kolektive nga Qeveria e Serbisë në lagjet veriore të Mitrovicës paraqet një shqetësim të madh në mesin e të gjithë njerëzve edhe tek vet ata që banojnë aktualisht atje. Këto ndërtime ilegale bëhen nëpërmjet fondeve të dyshimta, të cilat deklarohen se janë nga Qeveria e Serbisë. Jemi në një kohë e cila shumë shpejt pritet të formalizohet edhe juridikisht. Ndërtimi ilegal bëhet zakonisht vetëm në pikat më strategjike të lagjeve veriore që tregon se blerësit nuk janë të interesuar për qytetarët, por ato zona t'i kontrollojnë përmes banuesve që do të futeshin aty, e që ata banues faktikisht janë jo rezident, por pjesëtarë të formacioneve të ndryshme keqbërëse serbe. Një prej raste do të ishte edhe ndërtimi i kishës ortodokse serbe që është provokim i drejtpërdrejtë ndaj popullatës shumicë në Kosovë, nga se ndërtimi i kishës ortodokse u bë mbi varrezat e përbashkëta shqiptare, boshnjake, turke e të të tjerëve. Ndërsa, xhamia në vitin 1999 u dogj tërësisht e pastaj u rrafshua me ekskavator, në mënyrë që t'i humbet çdo gjurmë e një objekti fetar mysliman. Pra, manastirin ortodoks serb e ndërtuan vetëm e vetëm për qëllime politike që të ndërrohet struktura e atyre lagjeve. Nëse lejohet ndërtimi në ato lagje, së pari do t'iu lejohet ndërtimi i shtëpive të djegura gjatë luftës 1999. Të gjitha ato shtëpi kanë pasur leje ndërtimi, megjithëse të gjithë ishin të gatshëm të ktheheshin në pronat e tyre të shenjta e legale, por institucionet vendosëse nuk lejuan këtë. Kemi rastin kur u penguan ndërtimet në lagjet “Kroi i Vitakut”, e është edhe më absurde kur nuk u lejua që të kthehet popullata përkundër vullnetit që edhe nëpër tenda të jetojnë në trojet e veta. Shembulli më i mirë është ndërtimi i shtëpive në Frashër, fshat me popullatë të përzier, por ndërtimi u bë për popullatën serbe, pastaj ndërtimi i banesave për romët në lagjen e romëve, si dhe të boshnjakëve dhe të komunitetit hashkalijë në

lagjen “2 Korriku”, të gjitha këto në lagjet jugore të qytetit të Mitrovicës. Shpresojmë në të ardhmen e afërt, në të njëjtën mënyrë do të jetë në tërë qytetin e Mitrovicës.

Të vetëdijshëm për buxhetin e vogël të Kosovës, por mendoj se është detyrë dhe obligim i Qeverisë së Kosovës, që të ndihmohet Mitrovica me një buxhet të veçantë, sepse e ka efektin e vet social dhe atë politik. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Ftoj deputetin Sabri Hamiti, ta marrë fjalën.

SABRI HAMITI - Ju faleminderit zoti kryesues,

Unë për vete tash jam në dilemë, pasi dëgjova paraqitjet e grupeve parlamentare, sepse ashikare prej paraqitësit të temës e deri te i fundit, nuk janë duke folur për temën që është shtruar në rend dite. Ju lutem shumë, tema thotë saktësisht: Debat lidhur me ndërtimet ilegale të banesave kolektive nga Qeveria e Serbisë në Veriun e Mitrovicës, dhe ju e dini shumë mirë që kjo temë është shtyrë dy herë në Kuvend për mungesë të një qëndrimi dhe të një materiali dokumentues qeveritar. Në anën tjetër, edhe ky material dokumentues qeveritar, që na është dhënë, është tepër i dobët, do të thosha gati virtual, dhe do të thosha i palejueshëm, një material që vjen në emër të Qeverisë, ku thuhet: Kemi disa informata të paverifikura. Unë mendoj që ky parlament është tepër serioz që të flasë për një temë duke pasur parasysh emocione dhe duke pasur parasysh informata të paverifikuara, siç thuhet qoftë nga ana e Qeverisë, qoftë nga paraqitësi i një teme të këtillë.

Mendoj se sot nuk e kemi temë politike Mitrovicën dhe nuk mund të flasim, së paku LDK-ja nuk është e përgatitur dhe nuk do të flas politikisht për Mitrovicën sot. Nëse ky Kuvend do të flas politikisht për Mitrovicën, le të thirret mbledhje tjetër. Unë e di që reflekton çdo element që diskutohet për Veriun edhe politikisht, por ky formulim mbi ndërtimet pa leje kolektive që janë 6 shtëpi, nuk është temë që të shtrohet sot problemi i Mitrovicës që nga projekti politik, sociologjik, social etj. Prandaj, mendoj se ne jemi gjithmonë shumë më serioz nëse e trajtojmë problemin si që e shtrojmë e jo problemin në konteste krejt tjera. Për vete nuk do të flisja politikisht sot për Mitrovicën, sepse nuk do të ishim serioz që të flasim për një temë kaq të madhe me një kuorum që i numëron numrat a mbërrin 60, me një kuorum i cili nuk është në gjendje të votojë sot as rekomandime. Pra, unë nuk dua t’ia marrë të drejtën askujt, le të flasë kush si të dojë, por unë mendoj që duhet për të qenë serioz, për të kaluar përtej emocionalitetit. Unë i kuptoj deputetët e Mitrovicës, unë i kuptoj sepse ata e ndiejnë më thell këtë problem dhe, fundi i fundit, kanë nevojë para zgjedhësve të tyre të tregojnë se çka bëjnë në Kuvend për Mitrovicën. Por unë mendoj që kjo temë, me këtë referencë qeveritare që e kemi përpara dhe me paraqitjen e Ramadan Kelmendit që është, megjithatë politike 90%, kjo temë kështu nuk mund të shtrohet sot dhe të marrë përfundimet e vërteta. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zoti deputet. Unë dua t’ju njoftoj se në sallë janë 46 deputetë. Sipas Rregullores, ne kemi kuorum vetëm për debat, por nuk kemi kuorum për të votuar ose për t’i votuar rekomandimet, apo çfarëdo përfundimi nga ky debat. Për fjalë janë të paraqitur edhe 12 deputetë. Minimumi, zoti Krasniqi, mund ta

kërkoni fjalën, por unë ju kuptova, minimumi sipas Rregullores është 40 deputetë, por unë thashë se në sallë janë 46 deputet, prandaj kemi kuorum për të vazhduar debatin. Për fjalë është lajmëruar Remzije Nimani, pra janë edhe 11 deputetë pas saj. Fjalën e ka Remzije Nimani. Ne kemi kuorum për debat. Në qoftë se tërhiqen deputetët prej debati, unë jam i obliguar ta vazhdoj debatin. Në fund nuk do të kemi kuorum dhe nuk kemi kuorum për të marrë vendime. Remzije Nimani e ka fjalën.

REMZIJE NIMANI – I nderuari kryesues i Kuvendit,
Të nderuar ministra,
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të debatosh për Mitrovicën është njësoj si të debatosh për Kosovën, sepse statusi i Kosovës është i lidhur me Mitrovicën. Nga Ministria për Planifikim Hapësinor na është prezantuar një raport i shkurtër për ndërtimin ilegal të objekteve të banimit kolektiv në anën veriore të qytetit të Mitrovicës. Konform kësaj, kolegë të nderuar, ne e kemi përpara këtë Raport të shkurtër të sjellë nga ministria përkatëse. Sipas mendimit tim, raporti është mjaft i shkurtër dhe nuk pasqyron të dhënat e mjaftueshme për një shqyrtim më të thellë të kësaj problematike, për tendencat dhe qëllimet e Qeverisë serbe lidhur me realizimin e programit të saj për spastrimin etnik të shqiptarëve nga kjo pjesë e qytetit. Qeveria serbe dëshiron dhe është duke punuar me paramendim dhe në pajtim me platformën thellësisht të rrezikshme dhe të caktuar, sipas mendimit tim, për ndarjen e Kosovës.

Në kohë të fundit jemi dëshmitar të paraqitjes në skenë gjithnjë e më tepër nga ana e analistëve ndërkombëtarë, të opsionit për ndarjen e Kosovës. Disa mendojnë se ndarja kishte për qenë opsioni më i preferuar dhe më real që do të zgjidhte çështjen e Kosovës njëherë e përgjithmonë. Serbia është duke luajtur në këtë kartë me pretendim që në rast të mospjekjes së saj në ruajtjen e Kosovës në suaza të saj, atëherë ta aktivizojë planin për ndarjen e saj. Këto qëllime perfide, na kujtohen të gjithëve, i pat deklaruar haptas dhe edhe babai i kombit serb Dobrica Qosiqi, në paraqitjen e tij, e këtë plan e vazhdoi edhe Millosheviqi. Në këtë drejtim pat punuar edhe ish kryeministri serb Zoran Gjingjiqi. Në këtë drejtim, mendoj se jemi duke punuar shumë pak ose aspak për t'iu kundërvënë këtyre aspiratave të rrezikshme të Qeverisë serbe. Nuk kemi kurrfarë strategjie të ndërtuar, ne kemi rënë në gjumë të thellë. Qeveria serbe punon me ngulm, ndërton në këtë pjesë dhe kryen lloj-lloj veprimesh pa u penguar nga askush. Ne dhe faktori ndërkombëtar i kemi mbyllur sytë para të gjithëve. Kjo pjesë e Kosovës praktikisht është e ndarë nga tërësia e Kosovës. Administrata paralele serbe punon në mënyrë autonome, atje kryhen të gjitha veprimet e Qeverisë serbe në mënyrë të pavarur, duke filluar nga arsimi fillor, i mesëm dhe i lartë, e gjithë veprimtaria zhvillohet sipas planeve dhe të programit të Qeverisë së Serbisë. Shëndetësia dhe spitali rajonal i Mitrovicës është tërësisht i shkëputur nga shëndetësia e Kosovës. Organet e Kuvendit Komunal të Mitrovicës kanë bërë përpjekje aq sa kanë pasur mundësi që të parandalojnë këtë dukuri, por në nivelin qendror është bërë pak. Qeveria e Kosovës nuk hartuar strategji të duhur për t'i blerë objektet dhe shtëpitë e serbëve apo të shqiptarëve në pjesën veriore, kurse Qeveria serbe e realizon këtë edhe në vendet më strategjike të qytetit. Në funksion të kësaj është duke u punuar edhe në ndërtimin e objekteve ilegale në këtë pjesë të Mitrovicës. Shqiptarët në Veri të Mitrovicës nuk kanë të drejtë dhe nuk lejohet të ndërtojnë shtëpitë e tyre, të shkatërruara nga lufta e fundit dhe të kthehen në

vendet e tyre. Qeveria serbe stimulon ndërtimin. Shqiptarët i shesin shtëpitë, banesat dhe pronat e tyre. Gjithë kësaj i vjen era ndarje. Ky është sinjal që të zgjohemi nga gjumi, sepse një ditë do të bëhet vonë dhe do të na mallkojë historia, bijtë dhe bijat tona. Nuk guxojmë që të lejojmë kurrësi që të dobësohemi, por të qëndrojmë stoik në rrugën dhe në kauzën tonë kombëtare.

Kërkesat tona janë legjitime dhe të drejta. Këto janë momentet vendimtare për fatin e Kosovës dhe të Mitrovicës bashkë me Kosovën. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zonja deputete! Ka kërkuar fjalën, për një propozim, deputeti Agim Krasniqi. E ke fjalën Agim.

AGIM KRASNIQI – Ju faleminderit, zori kryesues,

Unë vetëm paraprakisht pa e marrë fjalën dhashë, do të thotë bëra një reagim. Për një temë kaq serioze, kaq të rëndësishme, të debatohet në Parlamentin e Kosovës ku ka më pak se 50% të deputetëve, do të thotë edhe numerikisht ka më pak se 50, nuk do të kishte kuptim. Për të mos devaluuar dhe marginalizuar këtë temë kaq të rëndësishme, kaq serioze, propozoj që kjo të vazhdohet në një seancë tjetër, se përndryshe nuk ka kuptim të vazhdohet kështu. Të paktën kisha lutur edhe sponsorizuesin, përfaqësuesin e LDD-së që ta marrë fjalën dhe ta japë propozimin e vet, përndryshe kështu nuk do të kishte kuptim të vazhdohet seanca.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zoti deputet! Unë jam i detyruar të punoj në bazë të Rregullores së Punës së këtij Kuvendi. Kuorum për debat kemi dhe fjalën e ka deputeti Nexhat Rexha.

NEXHAT REXHA - Ju faleminderit, zoti kryesues,

Unë konsideroj se ne që diskutojmë, paraprakisht jemi përgatitur për të diskutuar. Se a është çështja serioze të pjesëmarrësit dhe deputetët, është çështje krejt tjetër. Problemi i Mitrovicës është preokupim i çdo qytetari të Kosovës, i cili e vështron këtë qytet në aspektin historik, duke e njohur problematikën në të gjitha ndërrimet e sistemeve politike para dhe pas Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore. Po kjo gjendje u krijua edhe pas përfundimit të Luftës së Kosovës të vitit 1999. Duke i parë në praktikë këto ambicie qëllimkëqija që lidhen me Mitrovicën, e që ndërlidhen me fatin e tanishëm dhe të ardhshëm të Kosovës, politika serbe ka arritur përmes kanaleve diplomatike të ruaj dhe përdorë për vete këtë karrem për ta penguar ndërtimin e vendit tonë. Ndërtimi dhe financimi i tri ndërtesave kolektive për vendosjen e serbëve ardhacakë nga viset e ish Jugosllavisë, për ne nuk është çështje e panjohur. Kjo metodë kamufluese vazhdohet nga elaboratet famëkëqija nga Akademia serbe për konolizimin e Kosovës dhe këto projekte vetëm e ndërrojnë ngjyrën sipas motit, ndërsa brendia e problemeve për okupim nuk ndryshon fare.

Në Mitrovicë, në këto 8 vjet, politika e Beogradit ka instaluar institucionet e saja para syve të bashkësisë ndërkombëtare, të cilat u kanë shërbyer interesave politike duke joshur njerëzit e saj që punojnë dhe veprojnë në këto institucione ilegale. Për ne dhe faktorin ndërkombëtar, atë progresiv që vepron në Kosovë, këto veprime janë të

papranueshme. Nëse ndalemi vetëm në funksionimin e bankave të Serbisë në pjesën veriore të Mitrovicës, shohim se shumë qytetarë të Kosovës janë detyruar përmes matrapazëve të ndryshëm të tërheqin një pjesë të parave të tyre, të cilat ia kishte bllokuar

Serbia me vite të tëra për interesa të saja. Sa shumë keqpërdorime janë bërë te këta qytetarë, institucionet e Kosovës as që dinë për këto keqpërdorime, sepse edhe po të donin të dinin, nuk e kanë këtë mundësi. Kjo është dëshmi për ne dhe për faktorin ndërkombëtar, se për këto vite edhe më tej nuk po kthehet dokumentacioni i qytetarëve tanë në Kosovë, por ai edhe më tej po keqpërdoret nëpër qendra të ndryshme të Serbisë. Këto dhe çështje të tjera burojnë nga strategjia e politikës serbe, duke vepruar përmes grupeve paramilitare për të vazhduar pasiguri të qytetarët shqiptarë, boshnjakë, romë, egjiptas e të tjerë, dhe si rezultat i kësaj pasigurie, qytetari ynë i kësaj pjese të Kosovës edhe pas 8 vjetësh nuk mund të kthehet i lirë në shtëpinë e tij. Këto ndërtime pa leje ndërrojnë strukturën e popullatës për të krijuar pengesa të paparashikueshme për këta banorë dhe për të ardhmen e Kosovës.

Kuvendar të nderuar, është obligim yni dhe i bashkësisë ndërkombëtare që të veprojmë në harmoni me konventat ndërkombëtare. Të ndalim këtë proces antinjerëzor me dimensionin e një politike që është dëshmuar në grabitjen e tokave tona, duke i përdorur shantazhet më perfide nëpër qendrat e ndryshme diplomatike, pa i zgjedhur mjetet në dëm të popullit të Kosovës. Në fund, konsideroj se brenga e Mitrovicës është brengë e të gjithë qytetarëve që ia duan të mirën Kosovës. Ky okupim i kësaj pjese të Mitrovicës kërkon angazhim dhe ndërgjegje për një unitet stabil dhe zgjidhje të drejtë, për sot dhe nesër. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zoti deputet. Fjalën e ka Sala Berisha Shala. Dua t'ju njoftoj se në sallë janë 56 deputetë, andaj vazhdojmë debatin. Urdhëroni, zonja deputete!

SALA BERISHA SHALA – Ju faleminderit, zoti kryesues,

Se sa jemi të përgjegjshëm dhe të ndërgjegjshëm në lidhje me një çështje shumë të rëndësishme, shihet edhe nga prezenca këtu. Ishin disa arsyetime se a ka apo nuk ka sipas Rregullores kuorum për të debatuar, apo për të marrë rekomandime. Nuk është hera e parë që i ikim rendit të ditës në bazë të një arsytimi që u tha më herët për pika të caktuara. Dua t'ua rikujtoj se dje kishim për debat një çështje rreth procesit politik për zgjidhjen e statusit të Kosovës, ndërsa debati u fokusua në Grupin Negociator. Bile ishte për zgjedhjen, nuk ishte për zgjidhjen po për zgjedhjen, e kështu me radhë. Jemi mësuar të debatojmë jashtë formulimit të pikës së rendit të ditës, sikur ne e kuptojmë se për çka është fjala.

Me fjalë tjera, po e përsëris edhe njëherë, se sa jemi të ndërgjegjshëm kombëtarisht e njerëzisht dhe se sa jemi të përgjegjshëm institucionalisht, flet edhe prezenca e deputetëve, por edhe prezenca e Qeverisë këtu në këtë sallë. Mendoj se këtu është dashur të jetë komplet Qeveria ose së paku, përveç ministrit të Planifikimit Hapësinor, të jetë ministri i Drejtësisë, se në këtë rast ka shkelje të rëndë të drejtësisë ministri i Mirëqenies Sociale, se në lidhje me këtë rast kemi jashtëzakonisht raste sociale, e kështu me radhë, të mos i përmend që gjithë ministrat në fjalë. Ishte shumë i drejtë konstatimi i

ministrit të Planifikimit Hapësinor se tkurja e kësaj teme vetëm në debatimin për ndërtimet ilegale, nuk e plotëson qëllimin e debatit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke u nisur nga thënia tashmë jo e panjohur se pavarësia e Kosovës mund të jetësohet çdo ditë, nëse ne jemi ata që çdo ditë me gjakftohtësi, sinqeritet dhe përkushtim institucional do të punonim dhe të vepronim për interesin e përgjithshëm të Kosovës dhe zgjidhjen e statusit të saj. Po çka në të vërtetë institucionet qeveritare po bëjnë që Kosova të pavarësohet çdo ditë, në çdo hap e në çdo pëllëmbë të saj. Me keqardhje njerëzore dhe institucionale mund të konstatohet se kjo Qeveri as kriterin minimal nuk e ka plotësuar në përgatitjen për jetësimin e pavarësisë së Kosovës. Këtë e dëshmon më së miri edhe situata apo gjendja aktuale e qytetit të Mitrovicës. Për më keq, institucionet tona qeveritare nuk krijuan asnjë platformë, asnjë program ekonomik, asnjë program social, madje asnjë program humanitar për Mitrovicën dhe shqiptarët që kanë jetuar me shekuj në pronat e tyre në pjesën veriore të qytetit. Këta qytetarë të shpërndarë anekënd Kosovës, jetojnë në kushte tepër të rënda deri në mjerim dhe paguajnë qira anekënd Kosovës, ndërsa pronat e tyre janë mbushur me kriminel lufte.

Shtroj pyetjen, së pari për çështje tepër elementare. A e di Qeveria sa banorë të asaj pjese janë shpërndarë e tretur? A e di Qeveria se në çfarë kushtesh jetojnë këta qytetarë të Kosovës? A i ka takuar ndonjëherë në mënyrë të organizuar për t'u njohur me hallet e tyre, a po i takon vetëm gjatë fushatave zgjedhore, duke ua kërkuar votën me premtime boshe? Çfarë bëri në këtë rast niveli komunal dhe ai qendror për qytetarët e saj? Këtyre qytetarëve të Kosovës, që sot janë shpërndarë anekënd Kosovës dhe në diasporë, iu është mohuar dhe vazhdon t'i u mohohet ende e drejta elementare njerëzore për të jetuar në lagjet dhe në pasurin e tyre shekullore.

Po jua përkujtoj një shembull. Banorët e lagjes “Lugina e doktorëve” kanë kërkuar të kthehen në shtëpitë e tyre me ngulm që nga viti 2003. Vullneti i tyre as që është përfillur. Ndërsa, heshtazi Qeveria është pajtuar dhe vazhdon të pajtohet me këtë gjendje të mjerë edhe sot. Asnjë veprim politik, asnjë iniciativë institucionale me faktorin UNMIK nuk është ndërmarrë për ta siguruar lirinë elementare të lëvizjes në pjesën veriore. Liria e lëvizjes për Qeverinë e Kosovës ishte një standard, ndërsa, si duket, Qeveria këtë standard e ka kuptuar njëanshëm, lirinë e lëvizjes e ka kuptuar vetëm lirinë lëvizjes së serbëve, por jo edhe të qytetarëve të tjerë jo serbë. Qëndrimi i Qeverisë ishte aq injorues dhe vazhdon të jetë deri në mospërfillje, sikur ia kanë falur këtë zonë forcave militare dhe paramilitare serbe, sikur ua ka kanë falur këtë zonë bizneseve dhe kontrabandës më të errët. Mbi bazën e këtij biznesi dhe kontrabande, grupet e caktuara kriminale pasurohen skajshmërisht dhe kryejnë spastrim etnik me ndihmën e Qeverisë dhe të institucioneve të Beogradit. Dhe ne sot nuk kemi nevojë të debatojmë këtu se Qeveria e Beogradit ndërton, bën ndërtime ilegale. Çka bëri Qeveria jonë? Qeveria e Kosovës nuk ka buxhet, nuk gjen donatorë për ndërtuar së paku një shtëpi në asnjë lagje të pjesës së banuar me shqiptarë. Trojet dhe pronat e lagjes “Kroi i Vitakut”, “7 shtatori”, Lagja e Doktorëve, Lagja e Minatorëve, momentalisht janë shndërruar në lagje fantazmë. Do të ishte shumë patriotike, shumë njerëzore të bëhet trajtimi institucional i kësaj problematike, sesa të humbet kohë me caktim datash për shpallje apo festim të pavarësie, që kjo më tepër është një propagandë i një fushate paraelektorale. Kjo

propagandë u hynë në punë vetëm atyre që nuk dinë apo nuk kuptojnë çka është atdheu dhe shteti.

Kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë disa herë me radhë, sipas arsytimit të ministrit, në mungesë të informacioneve. Dhe këtu sot e kemi një raport tepër të shkurtër, tepër të varfër. Më lejoni ta citoj një pasus, ku në mes tjerash thotë: “Ka pasur disa reagime nga qytetarët e këtyre lokaliteteve tek institucionet e UNMIK-ut, por ende nuk ka ndonjë ndryshim”. Në qoftë se mbetet zgjidhja e problemit të këtyre qytetarëve, para së gjithash në vullnetin e reagimeve individuale, atëherë i ka marrë pusi edhe çështjen edhe ata qytetarë. Çfarë reagimi pat Qeveria në këtë rast të UNMIK-u? Në fund, shpresoj që ky debat të prodhojë rekomandime të cilat e obligojnë Qeverinë dhe e nxisin UNMIK-un që këtë problem sinjerisht ta shqyrtojë, që të zgjidhet ashtu që qytetarëve t’u lejohet ndërtimi dhe kthimi në pronat e tyre që të jetojnë të lirë ngase edhe ata janë qytetarë tanë, edhe ata janë qytetarë të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputeti Fetah Berisha, le të përgatitet deputeti Fadil Geci.

FETAH BERISHA – Ju faleminderit, zoti Kryesues,

Para se t’i them dy tri fjalë, të cilat i kam përgatitur e të cilat nuk do t’i them krejt, është e dhimbshme që sot në këtë parlament pjesa më e madhe e deputetëve mos të marrin pjesë për pikën më të dhimbshme të shtetit tonë që po mundohemi ta formojmë. A është e mundshme që sot të shikohet dhe të devalvohet ky Parlament, pra kjo pikë e rendit të ditës, e cila flet për Mitrovicën, për Mitrovicën tonë të dhimbshme, për Mitrovicën tonë më të pasur. Unë personalisht e përgëzoj zotin Ramadan që ka marrë iniciativën e ta paraqes në rend të ditës këtë pikë shumë të ndjeshme dhe shumë të dhimbshme për ne. Prandaj, të nderuar deputetë, Mitrovica vazhdimisht dhe gjithmonë historikisht ishte pjesë e pandashme kurrë e Kosovës. Den baba den. Po Mitrovica tani është e ndarë, është e ndarë artificialisht, themi ne, por nuk dihet ende se si kjo u nda, dhe janë enigmatike edhe përpjekjet e vendorëve dhe të ndërkombëtarëve për ta bashkuar dhe të cilën nuk mundën kurrë.

Të nderuar deputetë,

Mitrovica ka shumë probleme sot, duke filluar nga ato ekonomike, politike, juridike, kombëtare, etj. Etj. Por, me theks të veçantë, atje mungon lëvizja e lirisë dhe e sigurisë. Pra, Mitrovica është problem politik dhe ma merr mendja se po bëhet edhe problem diplomatik. Në atë pjesë atje janë koncentruar strukturat e ndryshme paralele serbe, atje vepron MUP-i i Serbisë, atje veprojnë paramilitarët e bandat e ndryshme gjoja se janë roje të urave. Këto veprojnë me qëllime që ta rrëmbejnë pjesën më të pasur të nëntokës shqiptare. Prandaj, vërtet Kosova pa Mitrovicën, siç thoshte një shkrimtar, është shteti i pa shpirt. Po ashtu duhet shtruar pyetja: A është Trepça, përkatësisht a është Mitrovica ajo që mban peng pavarësinë e Kosovës, apo është pavarësia e Kosovës ajo që e mban peng Mitrovicën? Këtu kur flitet për ndërtimet kolektive në Mitrovicën veriore, kurrë nuk mund të largohet nga tema e Mitrovicës së ndarë. Prandaj, historikisht dihet se trojet shqiptare janë tkurrur aq shumë nga katër vilajetet, nga 120.000 kilometra katrorë në 10.000 kilometra katrorë. Kjo është e dhimbshme. Prandaj, ka shtete në Evropë, ka kombe në Evropë të cilat jetojnë pakicë e atyre në shtetet fqinje,

por kështu një truall i copëtuar, siç është trolli shqiptar, siç është Kosova e kufizuar me etnitetin e vet, nuk ka edhe një shembull në Evropë e në botë. E ne, sot e dje, e ishalla nuk ndodh që edhe nesër të hezitojmë të flasim për Mitrovicën.

Faktori ndërkombëtar kur caktoi tri parimet, nuk ka ndryshim të kufijve, nuk ka kthim prapa në vitet '99, nuk ka bashkim të Kosovës me një vend tjetër, ka bërë me dije se ndarja e Kosovës nuk është opsion, prandaj ne nuk dyshojmë në këtë, por megjithatë, ne jemi këtu edhe për gjëra të tjera. Prandaj, ndërtimi i banesave kolektive në veriun e Mitrovicës me investimet e Qeverisë serbe kanë qëllime strategjike për ta ndërruar strukturën etnike edhe në atë pikë të vockël të tyre që u kanë mbetur, mendojnë ata. Regjimet serbe në vazhdimësi kanë bërë spastrimin etnik të trojeve tona, prandaj disa herë Kosova është kolonizuar, çka flet edhe me rastin e Lagjes së Doktorëve, ku shqiptarëve nuk u lejohet rindërtimi i shtëpive të shkatërruara nga lufta, ndërsa minoritetit serb i lejohet ndërtimi pa leje, legal ilegalisht për ardhacakët që do të vijnë aty. Prandaj, ata vazhdimisht punojnë me kokën e Beligradit, ashtu si ju thonë atje, të cilët janë detyrimisht dhe vazhdimisht kundër pavarësisë së Kosovës.

Ministri tha se nuk janë ndërtime ilegale. Zotëri ministër, a është konsultuar Kuvendi Komunal i Mitrovicës për këto ndërtime? Unë mendoj se jo. A bëhet presion tek shqiptarët t'i shesin trojet e veta atje lart? Unë mendoj se po. Ka pushtet paralel dhe struktura paralele në Mitrovicën e Veriut, apo jo? Unë mendoj se po. Shqiptarët i shesin pronat e veta, pse i shesin? Banesat janë për ardhacakët, jo për banim sipas nevojës dhe jo ndërtim humanitar. Pra, problemi është politik, pastrim etnik dhe kolonizim i serishëm i Kosovës. Prandaj, unë mendoj se Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me Kuvendin Komunal të Mitrovicës, të bëjnë një material, ta analizojnë çështjet, të na paraqesin fakte, t'ia paraqesin këtij Kuvendi përpara e pastaj ky Kuvend të del me një qëndrim. Sot, Ramadan Kelmendi, sipas meje, ka bërë mirë që e ka iniciuar këtë temë, të cilën e ka aprovuar edhe Kryesia e Kuvendit, por këtë herë është dashur ta iniciojë Qeveria e Kosovës dhe të na paraqesë një dokument me faktologji të plotë. Kjo çështje është shumë e dhimbshme. Të bëhet kolonizimi i një pjese të trollit tonë, para syve tanë, ani nga një pjesë shumë e vockël e minoritet serbë në Mitrovicë, kjo është e padurueshme dhe e tmerrshme. Kjo çështje duhet analizuar e shqyrtuar shumë më seriozisht zotërinj. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zoti deputetë! Fjalën e ka deputeti Fadil Geci, le të përgatitet deputetja Nekibe Kelmendi.

FADIL GECI – Ju faleminderit!

I nderuari zoti Kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë, ministra,

Mitrovica është një plagë e rëndë e Kosovës, e cila tash e tetë vjet po e pretë ndihmën dhe shërimin e saj nga institucionet e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare. Por, fatkeqësisht, as institucionet e Kosovës, e as Bashkësia Ndërkombëtare nuk po bëjnë asgjë në shërimin e kësaj plaje. Mendoj se sa më shumë që po kalon koha, kjo plagë po bëhet edhe më e rëndë.

Të nderuar deputetë,

Më duhet t'ju rikujtoj se Mitrovica sikur dikur ka qenë pasuria më e madhe e Kosovës. Mitrovica ka qenë edhe qyteti që e ka dridhur në themel ish sistemin komunist të Jugosllavisë. Kanë qenë minatorët e Trepçës së Mitrovicës që kanë nxjerrë mineralet më të çmueshme të Kosovës, por edhe që kanë shembur edhe themelet e krijesës artificiale të quajtur Jugosllavi.

Por, cila është gjendja e Mitrovicës sot? Si deputetë i kësaj zone më duhet të konstatoj me keqardhje se Mitrovica sot është qyteti më i anashkaluar i Kosovës, është qytet që është ndarë në dy pjesë dhe fatkeqësia më e madhe është se në ndarjen e qytetit kanë gisht edhe shqiptarët, madje edhe përfaqësuesit e institucionieve të Kosovës, duke përfshirë këtu edhe Grupin Negociator.

Ndarja e Mitrovicës ka ndodhur pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe kanë qenë forcat militare serbe që janë pozicionuar në anën veriore të qytetit dhe kanë ushtruar dhunë mbi shqiptarët e mbetur matanë Ibrit. Kjo dhunë dhe ky pastrim etnik që po ndodhë edhe sot, zotëri Hamiti, atje shqiptarët po i shesin tokat e tyre dhe Qeveria e Serbisë po ndërton banesa kolektive për kolonët serbë. Madje këto banesa po ndërtohen mu në lagjen ku jetojnë shumica shqiptare. Po shtohet pyetja, çka po bëjnë pushtetarët lokal dhe qendror që të ndalin këtë pastrim etnik të shqiptarëve të shpërngulur nga veriu e qytetit. Përgjigja është fare e thjeshtë – asgjë. Madje, çka është më e keqja, vetë Ekipi Negociator i Kosovës e ka legjitimuar ndarjen e qytetit të Mitrovicës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Me propozimin e planit Rexhepi dhe Lutfi Haziri është bërë ndarja legjitime e Mitrovicës në dy njësi komunale, siç po thonë ata, apo në dy komuna, siç është realiteti. Këtë propozim e ka miratuar Ekipi Negociator i Kosovës, çka është edhe më e keqja, këtë propozim të Ekipit Negociator të Kosovës e ka pranuar edhe Ekipi Negociator serb nga Beogradi. Pra, liderët tanë e kanë ndarë Mitrovicën në dy pjesë dhe pjesën Veriore ua kanë dhuruar serbëve. Shtrohet pyetja: Me çfarë morali politik e institucional kanë fytyrë këta liderë të lartpërmendur që të flasin për qytetin e Mitrovicës? A i kanë konsultuar organet komunale të rajonit të qytetit të Mitrovicës dhe popullatën shqiptare që jeton në pjesën veriore kur kanë dhënë propozimin për ndarjen e qytetit? Përsëri përgjigja është e qartë se as Rexhepi, as Haziri, as Kryetari Sejdiu nuk e kanë marrë pëlqimin e Kuvendit Komunal dhe të regjionit të Mitrovicës dhe as të deputetëve, as të këshilltarëve të atij regjioni, që e kanë dhënë për ndarjen e qytetit të Mitrovicës.

Të nderuar kolegë, unë ju ftoj që të jeni më të sinqertë dhe më serioz në çështjen e Mitrovicës. Kjo plagë e hapur kërkon ndihmën tonë. Atje është pasuria e Kosovës, atje është Populli i Kosovës që po mbahet i pushtuar tash e 8 vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë. Prandaj, si deputet i kësaj zone kërkoj që Mitrovica, që Qeveria e Kosovës të kërkojë urgjentisht ndaljen e ndërtimit të objekteve të Qeverisë serbe në lagjen ku jetojnë shqiptarët në pjesën veriore të Mitrovicës, që të kthehet pasuria e uzurpuar apo e blerë me dhunë të të gjithë atyre shqiptarëve që kanë jetuar deri më tash në pjesën Veriore të Mitrovicës, apo që këtë pasuri ta blejë Qeveria e Kosovës, që të formohet një Komision i veçantë ndërministror për qytetin e Mitrovicës në të cilin do të përfshihen edhe përfaqësuesit e Lagjes së Boshnjakëve të pjesës Veriore të Mitrovicës, që të hapen shkollat dhe të gjitha institucionet e tjera përcjellëse të Kosovës edhe në atë pjesë të qytetit, që të kërkohej një siguri më e madhe dhe një prani e përhershme e KFOR-it në

ato lagje ku jetojnë popullata shqiptare, boshnjake e të tjera, dhe në fund, të shpallet i pavlefshëm plani për ndarjen e qytetit të Mitrovicës në dy komuna.

Të gjitha këto masa duhet të ndermirren sa më parë, përndryshe në Kosovë nuk do të ketë paqe e qetësi përderisa Mitrovica të jetë e ndarë dhe e copëtuar. Ju faleminderit, zoti Kryesues!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi, le të përgatitet deputetja Flora Brovina.

NEKIBE KELMENDI – Nga Grupi Parlamentar i LDK-së është kërkuar që sot në rend dite të vihet Ndërtimi ilegal i banesave kolektive nga ana e Qeverisë në lagjet Veriore të qytetit të Mitrovicës. Të reduktohet çështja e Mitrovicës në trajtimin e ndërtimit pa leje të 6 objekteve të banimit karshi problemit shumëdimensional politik edhe të sigurisë të Mitrovicës, për mendimin tim është çështje e devalvimit të çështjes së Mitrovicës.

Çështjes së Mitrovicës duhet t'i qasemi nga të gjitha dimensionet, nga të gjitha aspektet dhe duhet t'ia kushtojmë një ditë të tërë, në mos edhe dy ditë të tëra në këtë Kuvend të Kosovës, sepse ka çka të flitet për Mitrovicën, jo prej se kanë filluar të ndërtohen këto shtëpi pa leje, këto objekte pa leje, por edhe për shumë sende të tjera. Megjithatë, unë konsideroj se, nëse kemi ndërtime pa leje në Veriun e Mitrovicës, sot e miratuar ligjin, le të zbatohet edhe në atë pjesë, le të bëhet legalizimi i atyre banesave, le të paguhet ato që duhet paguar edhe shqiptarët këndej lumit Ibër dhe gjithandej Kosovës dhe në këtë mënyrë të zbatohet Ligji në tërë territorin e Kosovës. Kjo mund të arrihet me ndihmën e Shërbimit Policor të Kosovës, por edhe të Administratës së UNMIK-ut, e cila nuk mund ta heqë përgjegjësinë nga vetja edhe për ndarjen e qytetit të Mitrovicës, siç është tani, por edhe për diskriminimin që bëhet me rastin e moslejimit të rindërtimit të shtëpive të rrënuara gjatë luftës në Veriun e Mitrovicës, në lagjet e përmendura nga parafolësit e mi.

Mua më brengos më së shumti çështja e shitjes së shtëpive të shqiptarëve, boshnjakëve, turqve e të tjerëve në Veriun e Mitrovicës, të cilat blihen nga ana e Qeverisë serbe për qëllime të spastrimit etnik të asaj pjese të Kosovës. Gjithashtu, më brengos edhe qasja diskriminuese e HABITAT-it me rastin e zgjidhjes së çështjeve banesore në Veriun e Mitrovicës, ku në gishta të një dore mund të numërohen banesat që janë liruar e në të cilat shqiptarët kanë pasur qoftë të fituar të drejtën banesore, qoftë të drejtën pronësore. Kjo më brengos dhe për këtë ishte dashur të kemi të dhëna të mjaftueshme, material të mjaftueshëm që të mund të diskutojmë në mënyrë kualitative, të mjaftueshme, konstruktive, etj. Të diskutohet sot në bazë të një dokumenti, i cili në një pasus të vetin thotë: “sipas disa informatave të pakonfirmuara”, më duket se është qesharake dhe jo serioze. Kur të kemi material të bollshëm, duhet të diskutojmë edhe për këtë çështje, por ky material nuk mjafton që të humbin energji, të diskutojmë për një çështje aq të rëndësishme, siç është çështja e Veriut të Mitrovicës. Unë nuk do të flas më shumë, sepse ju thashë se nuk kam brumë, nuk kam material në bazë të cilit do të diskutoja, por gjithsesi ndërtimi pa leje atje duhet të trajtohet njësoj si ndërtimi pa leje këtu.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka zonja Flora Brovina, le të përgatitet deputeti Mazllom Kumnova.

FLORA BROVINA – Dola këtu para jush vetëm për të treguar seriozitetin e temës të cilën kështu e kam kuptuar. Këtu pati vërejtje se çështja e ndërtimit të objekteve kolektive në Mitrovicë nuk është çështje politike, por është ndërtim pa leje si çdo kund tjetër. Unë kujtoj dhe besoj se një shumicë ndan mendimin me mua se nuk ka temë apolitike në Mitrovicë, sidomos kur ndërtohen objektet kolektive në pjesën që tanimë shumë kohë të gjatë jeton pa ne.

Kjo apati politike më shqetëson. Ka shumë apati dhe indiferencë, qëndrim indiferent ndaj çështjeve që janë shumë të rëndësishme për Kosovën. Ka shumë mos guxim politik, edhe kjo më shqetëson, gjithashtu. Flitet për një pjesë të territorit tonë, flitet për Mitrovicën të ashtuquajtur të Veriut, dhe kjo nuk është problem i një kolegut tonë, kolegut Ramadan Kelmendi, i cili shpeshherë çështjen e Mitrovicës e sjellë në parlament dhe ne sillemi në mënyrë shumë indiferente. Kjo është çështje e të gjithë neve, në veçanti të institucioneve tona dhe këto probleme që në dukje na duken shumë të vogla, nesër na dalin të mëdha dhe, tepër të mëdha.

I bashkohem pra reagimit kundër ndërtimit të objekteve kolektive pa leje në Veri të Mitrovicës, të cilat ndërtohen pa planin urbanistik dhe jashtë ligjeve të ndërtimit sado që nuk i konsideroj fare të tilla, por i quaj ndërtime politike, sepse të tilla dhe janë. Këto objekte banimi nuk i ofrohen tregut për shitje. Kjo shihet qartë se janë objekte me qëllime politike dhe me tendencë të ndryshimit të strukturës etnike dhe janë presion kundër qytetarëve tjerë jo serbë, pra shqiptarëve dhe të tjerëve. Ato i ndërton një shtet tjetër që është në armiqësi me ne, i cili ka tendenca territoriale pikërisht këtu, në Mitrovicë, pra. I bashkohem reagimit të qytetarëve të 23 mijë qytetarëve të dëbuar që nuk u kthyen asnjëherë në qytetin e tyre të veriut, në shtëpitë e tyre në këtë pjesë të Kosovës tani e tetë vjet pas qeverisjes së UNMIK-ut dhe të institucioneve tona që patën shumë gabime sa i përket qasjes së këtij problemi dhe mbrojtjes së territorit të Kosovës.

Mitrovica nuk u nda vet, ajo u lejua të ndahet. Aty gjithashtu u lejuan rojet e urës, ato asnjëherë nuk u shporrën dhe nuk u dëbuan plotësisht. Siguria asnjëherë nuk ishte e plotë në këtë vend. Prandaj, kjo indiferencë më shqetëson jashtëzakonisht edhe sot kur kjo temë kaq e rëndësishme nuk u vu në pikën numër një, por u vu në fund të debatit, kur na mungon edhe kuorumi dhe çuditë në qoftë se ju nuk shqetësoheni për këtë. Këtu mungon Qeveria, mungojnë ministrat. Më lejoni që t'i përhëndes dy ministrat që qëndruan këtu dhe më vjen mirë që të paktën ata ndoshta i përcjellin shqetësimet tona.

Mendoja se pas këtij debati shumë serioz ne më në fund mund të nxjerrim konkluzione dhe do të kontribuoja në nxjerrjen e këtyre konkluzioneve, por po e shoh që kjo ndoshta nuk është e mundur. Mendoja, të propozoja formimin e një komisioni vëzhgues që të mundësohet qoftë edhe me ndërmjetësimin e UNMIK-ut dhe të KFOR-it të shkojë të vëzhgojë situatën në terren. Ne e dimë situatën e Qeverisë dhe sa e zotëron ajo Mitrovicën e Veriut, por neve si Parlament, si institucion më i lartë i Kosovës të vëzhgojmë dhe të sjellim raportin pas kësaj vizite si komision dhe pastaj dhe edhe konkludimet adekuate të cilat do t'i votonim në Parlament. Këtë raport të votuar mund t'ia dorëzonim pastaj UNMIK-ut, KFOR-it dhe Qeverisë tonë, t'ia dorëzonim edhe Grupit të Unitetit i cili do të ketë në të ardhmen shumë punë me Mitrovicën edhe me këto objekte të ndërtuara pa leje. Do t'ua dorëzonim edhe ndërmjetësuesve të bisedimeve dhe

të aktualizonim çështjen e ndërtimeve të tilla të një Qeverie, e cila është në kontest me neve, do me thanë që çështja e ndërtimeve të tilla të jetë një problem edhe temë për debat në bisedimet që do të shtrohen. Pse jo, kur Serbia në këtë kohë kaq delikate të vendosjes së statutit të Kosovës bën ndërtime të tilla dhe mos bëftë asgjë tjetër, atëherë shqetëson popullatën e cila duhet të kthehej në këtë kohë në shtëpitë e veta.

A nuk ju duken këto ndërtime kolektive si një derë e vogël ku hyhet drejt ndarjes së Kosovës. Pse lejohet kjo, pikërisht në këtë moment kaq delikat? Seriozisht mendoj se ata që mbrojnë tezën dhe e mbrojnë domosdo, duhet ta mbrojnë territorin unik të Kosovës, duhet të mendohen më mirë se a janë duke e mbrojtur plotësisht tërë territorin e Kosovës. Ju Faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputeti Mazllom Kumnova, le të përgatitet deputeti Xhevat Bislimi.

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA – Zoti kryesues, shkurtimisht unë, meqë u tha mjaft këtu. Mendoj që kemi bërë mirë që kjo çështje është ngritur në debat dhe po trajtohet sot. Për Mitrovicën shumë pak kemi debatuar si Kuvend dhe shumë më pak kemi bërë për të zgjidhur problemin më të ndjeshëm politik në Kosovë.

Mirëpo, kam rezerva se problemi nuk është adresuar drejt si temë e debatit. Problemi nuk bën të klasifikohet si problem i ndërtimeve pa leje. Përkundër kësaj, unë mendoj se në këtë debat duhet të ishte e gjithë Qeveria, siç e thanë edhe disa parafolës, dhe jo vetëm ministri Gjini dhe ministri Kuçi, sepse si problem i adresohet gjithë Qeverisë. Ai është problem politik dhe si i tillë duhet edhe të debatohet. Adresa më e saktë është UNMIK-u, sepse është kompetencë e tyre dhe Administrata e UNMIK-ut ka lejuar këtë situatë, e cila është në kundërshtim dhe me konventat dhe dokumentet ndërkombëtare. UNMIK-u ka qenë mospërfillës, me një qëndrim indiferent ka stimuluar këtë veprim të Qeverisë serbe në territorin e Kosovës, një rikolonizim i mjedisve të caktuara në Kosovë me një prapavijë, kuptohet, politike, strategji e njohur serbe e pastrimit etnik të territorit. Pa dyshim, problemi është i rëndë dhe kërkon angazhim të institucioneve tona që të zbatojmë ligjet tona në gjithë territorin e Kosovës. Por, mbi të gjitha të kërkohej përgjegjësi e Administratës së UNMIK-ut për shkelje të Rezolutës 1244 dhe të akuzohet për mbështetje të pastrimit etnik. Mua më duket se ky duhet të jetë edhe përfundim i këtij debati, të akuzohet UNMIK-u për mbështetje të pastrimit etnik në territorin e Kosovës. Si institucione kemi përgjegjësi ndaj qytetarëve të goditur, jo vetëm shqiptarë, por edhe të komuniteteve të tjera, përveç serbëve, kuptohet, në Mitrovicë. Prandaj, nga ky debat duhet të dalim me veprime konkrete. Faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Faleminderit zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi, le të përgatitet deputetja Besa Gaxherri.

XHEVAT BISLIMI – Faleminderit, zoti kryesues!
Kolegë deputetë, ministra,

Për Kosovën Veriore, për Mitrovicën, janë bërë shumë shkrime, janë bërë këngë, ka pasur edhe vajtime, dhe kjo është ana emocionale e çështjes. Por besoj që të gjithë ne pajtohemi se Mitrovica dhe Kosova Veriore janë çështje e pastër politike. Këtu dikush e

përmendi edhe Kuvendin se është vonuar, s'është bërë debat etj. etj. Unë mendoj që Kuvendi e ka pjesën e vet të përgjegjësisë dhe pikërisht për arsye se nuk e ka shtrënguar Qeverinë ose edhe qeveritë paraprake që, o të ndërmarrin masa, o ta vendosin kontrollin në tërë territorin e Kosovës dhe të japin dorëheqje ose të shkarkohen. Në këtë pikë konsiston përgjegjësia e këtij Kuvendi dhe këtë përgjegjësi sigurisht do ta ketë gjithmonë. Por, siç e dimë tashmë, siç u pa edhe dje, ky Kuvend është shndërruar në një instrument të shefave politikë dhe, si i tillë, kaq e ka forcën. Kjo po duket edhe sot me praninë e krerëve të institucioneve që nuk denjojnë të marrin pjesë në këtë debat.

Ne nuk mund t'i inkurajojmë qytetarët shqiptarë që të qëndrojnë në Veri të Kosovës me debate, me deklarata, me vajtime, me recitime, e të tjera. Përdërisa Kryeministri i Kosovës nuk mund të shkel në pjesën Veriore të Kosovës, përdërisa ministri i Brendshëm nuk mund të shkel në pjesën Veriore të Kosovës dhe asnjë ministër tjetër. Ne të gjithë jemi dëshmitarë se spastrimi etnik është bërë në mënyrë sistematike dhe brutalisht nga Qeveria serbe dhe paramilitarët e saj. Kjo ka ndodhur nën ombrellën e UNMIK-ut dhe të KFOR-it, të cilët kanë toleruar spastrimin etnik të Veriut të Kosovës dhe vendosjen e asaj pjese nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Qeverisë serbe. Kërkush nuk po e pranon, po të gjithë e ndjejë, të gjithë e dinë se atë pjesë e kontrollon drejtpërdrejtë Qeveria e Beogradit dhe jo Qeveria e Kosovës. Ndarjen e Mitrovicës dhe të Kosovës e ka legalizuar edhe plani i Ahtisarit me miratimin, me pëlqimin e Grupit Negociator që i patëm dje dhe na shiten dëngla, aq sa na mërzhiten gati.

Të gjithë jemi dëshmitarë se në Kosovën Veriore hyn, del për kafe, për tubime, për muhabete, për dasma, për protesta cilido zyrtar i Beogradit, nga Koshtunica, Tadiqi, Çoviqi e Çoviq të tjerë, por nuk mund të shkel asnjë zyrtar i Kosovës dhe kjo nuk do koment. Anëtarët e Grupit Negociator dhe krerët e institucioneve të Kosovës kanë bërë një vizitë njëherë, por jo për tokë, me helikopter të KFOR-it dhe e kanë parë prej lart atë pjesë të Kosovës.

Unë jo rastësisht propozova dje që Kosova në rrethana që po kalon dhe në fazën që po hynë pas dështimit të miratimit të planit të Ahtisarit në Këshillin e Sigurimit, duhet të mendojë seriozisht për një Qeveri të shpëtimit kombëtar. Kjo ide, siç e patë, ngjalli reagime edhe primitive të ndonjë ministri a deputeti. Unë i kuptoj reagimet e tyre, sepse me krijimin e një Qeverie të Shpëtimit Kombëtar do t'u hiqej torta nga goja shumë ministrave dhe t'u hiqeshin shumë miliona që sot i përfitojnë në mënyrë të paligjshme, siç dëshmojnë edhe auditorët dhe raportet e tyre të këtyre ditëve.

Prandaj, nuk po dua t'ju lodh shumë sepse të gjithë e dini, çështja e Mitrovicës nuk zgjidhet as me debat, as me këngë, as me vjersha, as me vajtime. Është, në fund të fundit, çështje e pastër e raportit të forcave. Në qoftë se kjo Qeveri, që unë dyshoj shumë, është e zonja të marrë përsipër ta vendos kontrollin atje, ne mund ta përgëzojmë, po unë dyshoj shumë që kjo Qeveri s'ka për ta bërë edhe për shumë kohë, përveç në qoftë se e çon dikush për dore, ndonjë forcë e madhe, po s'besoj që dikush do të rrezikojë për Kosovën në qoftë se nuk rrezikon shqiptari i Kosovës, Qeveria e Kosovës. Në këtë kontekst, po e përmend edhe njëherë që Kosova, ky Kuvend duhet të mendojë seriozisht për një Qeveri të Shpëtimit Kombëtar e jo për zgjedhje, sepse Kosova kërkon zgjidhje e jo zgjedhje. Nga Kosova Veriore, nga fati i Mitrovicës do të varet në një shkallë të lartë fati i Kosovës. Mos mendon dikush se do të ketë stabilitet në Kosovë dhe në rajon në qoftë se i hyhet

ndarjes së kufijve, lëvizjes së kufijve tjera e të tjera, siç ka pretendime dhe siç në njëfarë mënyre de fakto ka ndodhur. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zoti deputet! Para se të vazhdojmë me debatin, pasi që po përmendet shumë mosprezenca dhe interesimi, më lejoni një statistikë edhe për transkript. Grupet Parlamentare janë të interesuara, si vijon: LDK-ja 29, PDK-ja 10, AAK-ja 5 deputetë, ORA 3, 6+ 2, Integrimi 1 deputet, LDD-ja 4 deputetë, PSHDK-ja 1 dhe LPK-ja 1 deputet. Qeveria në këtë debat ka dërguar ministrin funksional që në bazë të mocionit është kërkuar, dhe ministri i Punëve të Brendshme, Blerim Kuçi, i cili përcjell debatin dhe do të merr sigurisht konkludime në bazë të debatit që është duke u zhvilluar. Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri, le të përgatitet deputeti Mark Krasniqi. Ju lus të mos përmendni më interesimin dhe mosinteresimin e deputetëve, në transkript do të evidencohet kjo. Faleminderit! Deputetja Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI – Faleminderit, zoti kryesues,
Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtet pas këtij diskutimi nuk mbeti shumë për të thënë dhe në bazë të kësaj shohim se nuk është që nuk jemi të informuar, të gjithë deputetët jemi shumë mirë të informuar për gjendjen në pjesën Veriore të Kosovës. Mendoj se nuk është dashur të thuhet më shumë, por po e lexoj edhe njëherë: Ndërtimi pa leje i banesave kolektive nga Qeveria e Serbisë në pjesën Veriore të Mitrovicës, për të kuptuar se sa rëndësi ose sa dimensionale i duket dikujt kjo pikë e rendit të ditës për të qenë më serioz edhe për të diskutuar.

Unë mendoj se me këtë secili e sheh që vërtet këtu ka në radhë të parë cenim të territorit të Kosovës dhe nuk do koment sa peshë politike ka. Nuk mund të ngushtohet debati rreth ndërtimit pa leje, absolutisht. Prandaj, unë e thashë edhe në fillim, nuk mund të them gjëra më të reja se sa u thanë, megjithatë shumë shkurt do të tentoj ta përmbylli fjalimin tim.

Institucionet e Kosovës, po them edhe unë, është dashur dhe duhet që çështjen e Mitrovicës ta marrin si problem nacional, si problem shumë serioz. Ndërtimet kolektive, nuk do koment, janë tërësisht politike, por mendoj se Qeveria serbe në shumë procese edhe veprime është disa hapa para nesh, fatkeqësisht, shpesh të ndihmuar dhe të përkrahur nga personat e administratës së UNMIK-ut dhe njëkohësisht duke e shfrytëzuar pëpërgjegjësinë e institucioneve të Kosovës. Çka është më e papranueshme, këto objekte po ndërtohen, natyrisht, pa aplikuar as për leje ndërtimi, as për dokumentacion tjetër adekuat për ndërtim në institucionet relevante të Kosovës. Shtrohet pyetja, çfarë ka bërë Qeveria e Kosovës për pronën e dëmtuar të shqiptarëve në këtë pjesë të Kosovës? Pajtohem me ministrin, e thashë edhe më parë që kjo temë nuk duhet kuptuar si problem i ndërtimeve pa leje. Fatkeqësisht, po shihet se edhe këtij problemi ne si institucione të Kosovës nuk kemi ndërmend t'i qasemi seriozisht dhe ashtu si duhet. Nuk çuditëm aq shumë për këtë, sidomos pas seancës së ditës së kaluar, pra të ditës së djeshme, në të cilën u diskutua statusi i Kosovës, dhe kjo temë është e ndërlidhur drejtpërdrejt me statusin e Kosovës, ky Kuvend debatoi 10 orë të plota dhe atë seancë e mbylli pa e marrë asnjë vendim si trup më i lartë i këtij shteti. Andaj, nuk befasohem dhe mendoj se Qeveria e Kosovës, përveç veprimeve politike që ishte dashur dhe duhet t'i marrë, është dashur dhe

duhet të ndaj buxhet të veçantë për renovim të pronave të dëmtuara të shqiptarëve, madje nga Ministria për Kthim, sepse edhe këta qytetarë, përveç që janë shqiptarë, janë qytetarë të Kosovës. Dhe, krejt në fund, pyes çka duhet të bëjë më shumë Qeveria e Serbisë që ne të reagojmë politikisht.

Ju lutem, kolegë të nderuar deputetë. Në fund unë kisha pasur dëshirë t'ju ftoj që t'i votojmë rekomandimet të cilat i propozon Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, por shihet se ne këtu nuk e kemi përbërjen e kuorumit për të votuar dhe unë nuk e di qysh do ta mbyllim këtë seancë apo këtë pikë të renditë të ditës. Unë po pres nga ju, zoti kryesues, çfarë zgjidhjeje do të gjeni dhe nuk po më pëlqen që po të duket shumë lehtë që do ta bëjmë zgjidhjen e kësaj çështje, Megjithatë, jemi mësuar, bile fatkeqësisht edhe Kuvendi në kohë të fundit, institucioni që ka qenë më serioz dhe që duhet të jetë më serioz, t'ju mësojmë gjërave kështu, pra edhe këtyre gjërave që janë shumë kruciale, siç është çështja e Mitrovicës, çështja e statusit të Kosovës, por, fatkeqësisht, ne nuk jemi në nivel të detyrës. Faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Deputeti Mark Krasniqi e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Ymer Halimi.

MARK KRASNIQI – I nderuari kryesues,
Të nderuar ministra dhe deputetë,

Problemi i Mitrovicës është problem i madh për fatin e Kosovës. Unë mendoj se sot ne diskutojmë kot këtu, se çdo diskutim e ka njëfarë qëllimi dhe e ka njëfarë shprese se do të merret diçka në lidhje me atë diskutim në qoftë se e meriton. Mendoj se Mitrovica e meriton një vendim të këtij Parlamenti, dhe jo vetëm njëherë, por shpeshherë deri sa të mbushen veshët e faktorit ndërkombëtar se kjo lojë kuptohet ku e ka qëllimin. Qëllimi është ndarja e Kosovës. Njëherë sërbiethanë se ka qytete, jo vetëm Mitrovica, po ka edhe shumë qytete që ndahen, që lumi i ndanë. Ka, është e vërtetë, por tash me qenë se u prek pulsi i shqiptarëve nga ana e Serbisë se si po reagojmë ne deri në brigjet e këtij lumi të Ibrit, tash po e kalojmë edhe Ibrin se u pajtuam ne gati, u pajtuam me qenë se nuk luftojmë për të drejtat tona sa duhet dhe si duhet. Prandaj, mendoj se edhe diskutimi im, por edhe të gjitha diskutimet e tjera janë të kota, kot po flasim ne këtu. Ky është një problem jashtëzakonisht i madh. Prandaj, duhet këtu të jetë jo vetëm plotë salla, të gjithë deputetët, por të jetë edhe krejt Qeveria këtu dhe të marrim një vendim, një qëndrim që të reagojmë shumë ashpër ndaj UNMIK-ut, ndaj atyre... Ne kot themi, le ta zgjedhin komuna e Mitrovicës këtë problem ose le të reagojë ose të bëj diçka. Asgjë s'mund të bëjë kryetari, as komuna e Mitrovicës. Pak mund të bëjmë edhe ne, por në qoftë se ngulim këmbë gjithmonë si duhet, do të bëjmë shumë. Prandaj, unë në këtë pjesën tjetër të diskutimit tim po e rezervoj qysh tash për një seancë që do të jetë këtu më shumë meritore dhe më efikase. Vetëm këtë desha të them se Serbia po mat vetëm pulsionë si po reagojmë deri këtu. Serbia, duhet ta dimë të gjithë dhe mos ta heqim kurrë prej mendjes, Serbia nuk ndalet deri në Durrës. Është politikë shekullore kjo e Serbisë, brigjet e Adriatikut janë qëllimi i politikës së Serbisë prej Krushevcit e deri këtu, e deri sot, prej vitit 1878 e këndej Serbia po depërton kah Jug. Hitleri e ka pasur politikën e vet Drang nef Ostel - Depërtimi në Lindje, Serbia e ka Drang nef syd - Depërtimi në Jug, dhe nuk do të ndalet kurrë në qoftë se ne nuk i bëhemi pengesë dhe nuk i bëhemi front i fuqishëm. Faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – I fundit për fjalë është paraqitur deputeti Ymer Halimi.

YMER HALIMI – Ju faleminderit, kryesues,

Vërtet është shterë fjala me të madhe për Mitrovicën, por ndjeva për obligim që nga fjala ime që e kam përgatitur t’i nxjerr vetëm tre pasuse dhe t’ua referoj juve. Për Mitrovicën dhe rreth Mitrovicës ka shumë çka te thuhet se vërtet sot ajo përfaqëson diçka ma shumë se një qytet. Por, kur flitet për Mitrovicën, çdo njërit që merret me politikë duhet t’i bie ndërmend se sa i rëndë është ndëshkimi i historisë kur nuk kryhet veprimi i duhur në çastin e duhur. Mendoj në çastet e Mitrovicës për 9 vjet rresht.

Përgjigjen e kësaj e kam të thjeshtë, mendimin e gjeniut Cvajg, që thotë ”Janë çaste më të çuditshme në histori ..., kur fija e fatit bie ne duar të papërgatitura dhe këta njerëz nuk i gëzohen fatit te historisë, por merren me diçka tjetër”. Ne nuk iu kemi gëzuar fatit të historisë, jemi marrë me diçka tjetër, prandaj jemi këtu ku jemi. Dhe, për të mbyllur këtë çast, po e citoj thënien e urtë latine: “ Të mençurit e kërkojnë fajin te vetvetja, ndërsa ata që s’janë plot, te fqinji”. Ne e njohim Serbinë, i njohim faktet e saj tashmë 100 vjet. Ajo ka të drejtë të veprojë me idenë e vet, ne kemi të drejtë të veprojmë me idenë tonë. Prandaj, e besoj, në vazhdim keni mundësinë ta lexoni diskutimin tim në transkript.

Nuk mund ta bëjë klasa politike veprimin e duhur politik kur institucionet e shtetit i ka mbushur me partizanë fanatikë të vet, bile edhe Kuvendin, dhe e shuan për një kohë konceptin e administratës profesionale e të mirëfilltë për shtetin.

Këta nuk iu kundërvunë strukturave të caktuara burokratike te UNMIK-ut, të cilat penguan proceset demokratike. Fatkeqësisht, nuk mund te veprojnë ata politikan qe janë futur nga vijat anësore dhe kanë arritur ne majë të ekzekutivit te shtetit, e janë pa bagazh intelektual, pa bagazh nacional e politik. Këto i kemi në çdo segment te shtetit.

Ju lutem, si ka mund të heshtën këto veprime nga segmentet e shtetit, apo nga ministri i Pushtetit Lokal. Ndërsa, sot me nënshkrimin e disa deputetëve kjo vije në Kuvend.

Së pari, si nuk u është mundësuar banorëve jo serbë që t’i riparojnë shtëpitë në kohën e duhur. Nëse dikur ishin vështirësitë për t’u kthyer, atëherë kur këto vështirësi u hoqën, pse nuk veproi Qeveria që këta njerëz t’i mbështes që të kthehen në shtëpi te tyre dhe të bëjnë jetë normale për aq sa u lejojnë mundësitë!? Kjo është përgjegjësi edhe e këtij Kuvendi.

Pastaj, Qeveria serbe nuk blen prona serbe edhe pse ka ofertë për blerje, por blerjen e bën nga shqiptarët, kryesisht. Po shihet sheshazi qëllimi politik. Ku është ekzekutivi ynë. Hesht! Duhet te hesht. Pse? Duket e thashë më lart.

E pranoj si normale shitblerjen ndërmjet individëve, apo kompanive për ndërtim për qëllime komerciale, pa marrë parasysh kush e bën, serbi apo shqiptari. Por, kështu është e papranueshme dhe më pastaj do të këtë probleme serioze.

Vërtet, nëse popullata serbe ka vështirësi për çështje banimi në këtë pjesë, e mendoj se Qeveria e Kosovës është dashur ta merr obligim që i takon.

Por, ky testim serb dhe neglizhenca e institucioneve të Kosovës janë koordinuar dhe kanë ecën mirë duke e stimuluar një kah të vetëm.

Megjithatë, nuk duhet të shqetësohemi shumë se ende ka kohë për veprim.

Prandaj, Kuvendi sot duhet të dalë me një qëndrim të qartë, që blerja e pasurisë së banorëve jo serbë në veriun e Mitrovicës nga Qeveria serbe të ndërpritet. Është veprim demokratik dhe politikisht i pranueshëm.

Nëse, aludohet në ndërtimin pa leje, si prishje e planit urbanistik, kjo nuk do koment, se do të ishte çudi të ruhej plani urbanistik, kur dihet kaosi që mbretëron në tërë Kosovën, e veçmas në Prishtinë.

Për ironi, ndoshta sjellja e kundërshtarëve na vetëdijeson si të sillemi me shtetin tonë. Sot, Qeveria e Kosovës edhe pas tetë vjetësh nuk ka troje të caktuara për ndërtimin e objekteve ministrore, e shpenzon miliona euro për qira. Ndërkaq, Kuvendi Komunal i Prishtinës, partive u jep me bollëk troje, madje në pozicion prestigjioz.

Deputetë të nderuar, Mitrovica ka marrë peshën e vet, kjo nuk është më enigmë. Atje shqiptaret duhet të kthehen dhe duhet t'i ndihmojë Qeveria. Është çasti i duhur e i mundshëm, dhe politikisht i drejtë.

Në anën tjetër, mendoj, askënd nuk duhet gjykuar aq, siç pretendohet në media, për përdorimin e pasurisë së vet në formën e vet. Ka shkuar koha e apeleve kuazi-patriotike deri sa ne vetë e grabisim pronën e shtetit.

Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Paraqitja me shkrim e fjalës së deputetit Ymer Halimi hyn në transkriptin nga ky debat. Një minutë e ka kërkuar deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI – Do të përpiqem sa më shpejtë. Unë edhe njëherë ritheksoj që gjithfarë teme për Mitrovicën mund të diskutohet, por edhe njëherë e theksoj, për t'u bërë ky Kuvend veprues, serioz, atëherë e shtron problemin e Mitrovicës si problem politik e statusor. Nëse nuk është shtruar në këtë formë, edhe kjo bisedë qysh është bërë sot, natyrisht, tenton të shkojë kah ajo temë, po tema nuk është shtruar si e tillë. Edhe njëherë po them, për ata që i mbanë kujtesa kuvendore, e këtu janë disa nga legjislatura e parë, në mes tyre është edhe Ramadan Kelmendi. E di shumë mirë programin e famshëm të Shtajnerit, kush e ka aktualizuar në këtë Kuvend dhe pse ka mbetur vetëm. Mirë u pafshim në diskutime statusore dhe politike, nëse i kërkojmë dhe nëse jemi të zotët t'i diskutojmë. Unë e kuptoj që ku dhemb, flitet me zemër të plasur. Kuvendi i Kosovës kur flet për tema të mëdha, duhet të përgatitet të marrë qëndrime, që unë i quaj racionale politike. Faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Ministri Ardian Gjini e ka fjalën.

MINISTRI ARDIAN GJINI – Faleminderit zoti kryesues!
Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,

Nuk do t'ju marr më shumë se një minutë, ose pak më tepër. Ju falënderoj të gjithëve për debat. Ajo që thashë në fillim, ka qenë droja se debati do jetë kështoj dhe ka qenë problem i Ministrisë së Mjedisit të përgatis material për temën qysh është shtruar duke ditur që do të hapen tema të tjera. Ajo çka bën Ministria e Mjedisit kur përmenden ndërtimet pa leje është: e identifikon objektin, e kemi identifikuar e keni në material, e identifikon lokacionin ku është objekti, edhe atë lokacion e keni. Materiali, kemi thënë edhe vetë që është vështirë i konfirmueshëm, detaje të pakonfirmueshme për shkak se

është vështirë të konfirmohet pronari, është vështirë të konfirmohet beneficuesi material i saktë, dhe po e dini pse. Edhe këto janë probleme tjera. Dy çështje të tjera, nuk kam thënë që janë ndërtime legale, kam thënë eksplicit që janë jo legale, ndërtime ilegale, ndoshta nuk jam dëgjuar. Kam pasur shumë kujdes çka po them, janë jo legale. Dhe çështja tjetër është Hada. Për Haden keni marrë vendim, ju të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës për Haden ka marrë vendim Kuvendi që t'i zhvendos. Ky është problem tjetër, do të thotë, nuk mund të akuzohet Qeveria me një goditje të ulët kësisoj dhe të thotë pse po jepni mjete për Haden, s'po jepni për Mitrovicë. Ky është vendimi juaj, nuk është vendim që ka ardhur prej dikujt tjetër dhe nëse përgatitet materiali për Mitrovicën, atëherë me siguri Qeveria duhet të jetë complete për shkak se çështjet nuk janë vetëm të Ministrisë. Jo, janë të Ministrisë së Brendshme, janë të Ministrisë së Drejtësisë, janë të policisë, janë të KFOR-it, janë të UNMIK-ut dhe të gjithë duhet t'i sjellin informacionet, përndryshe nuk mund të jenë të plota në asnjë rast tjetër. Faleminderit shumë!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Ramadan Kelmendi. I keni 5 minuta në dispozicion.

RAMADAN KELMENDI - I nderuari Kryetar, nuk e kam fortë traditë të dal këtu, por më shtynë disa diskutime që e vunë në dyshim shtruarjen kësaj teme këtu në Kuvend. Kjo temë është vë në dyshim edhe nga institucionet e të gjitha niveleve në Kosovë dhe pikërisht vënia e tillë në dyshim na ka sjellë në një situatë të cilën e kemi sot. Të dhënat e paraqitura nga propozuesi janë më se të sakta, janë të vërteta dhe ajo është gjendje shumë reale. Problemi i Mitrovicës është bërë shumë herë përpjekje të shtrohet këtu në Kuvend, është penguar në të gjitha procedurat dhe po pengohet dhe sot është penguar, për vlerësimin tim. Ajo që është me rëndësi duhet thënë: I falënderoj të gjithë pjesëmarrësit në diskutim të cilët e përkrahën propozimin për zgjidhjen e këtij problemi. Problemi i Mitrovicës, siç u pa dhe u tentua të reduktohet vetëm në ndërtimet individuale, por me një fjalë shumë të madhe, ndërtimet kolektive nga Qeveria e Serbisë në një territor të një shteti tjetër këtu është poenta. Problemi i Mitrovicës nuk fillon vetëm në këto kolektive, po është fundi i asaj që po mund të ndodh në Mitrovicë. Ju them të vërtetën, unë kam kërkuar trajtim institucional dhe institucioni i Kosovës është edhe ky Kuvend si organi më i lartë ligjdhënës dhe nga i cili kërkohet të marrë vendime politike. A do të realizohen ato a jo, është tjetër çështje. Në politikë, si njerëz të politikës, me kohë, nëse kemi lëshuar kohën, është ende koha të marrim vendime politike për Mitrovicën. Ne nuk po dëshirojmë, po e theksoj, nuk po dëshirojmë të marrim vendime për politikën, nuk kemi dashur të marrim edhe në vitin 2004, por një trazirë e vogël tërë procesin politik e ktheu atje ku ishim, në pikën zero. Ju them dhe ua tërheq edhe njëherë vërejtjen, nuk mund të ketë, përsëris, nuk mund të ketë dhe nuk do të ketë, me keqardhjen më të madhe, stabilizim procesi politik pa hyrë në vallë të zgjidhjes së problemit politik të Mitrovicës. A do të hymë me dëshirë, apo pa dëshirë, ky është mendim dhe qëndrim i atyre që jetojnë atje, sepse lehtë është për ta prishur punën dhe ne e kemi shtruar në rend dite për ta rregulluar punën, për të krijuar optimizëm, për të krijuar një fond. Unë kërkoj që ky Kuvend të marrë qëndrim dhe të aprovojë qëndrimet, gjegjësisht rekomandimet, natyrisht të plotësuara edhe me disa rekomandime shumë me vlerë përmbajtjesore të dhëna nga disa shefa, po thuaj të të gjitha grupeve parlamentare dhe duke i përkrahur ato dhe propozimet e mia lus Kuvendin të marrë qëndrim politik, sepse ne na duhet qëndrimi politik, qëndrim i cili do t'i jepet Bashkësisë Ndërkombëtare se Mitrovica është në prag

të ndezjes, sikur pyjet. Mjafton një gacë dhe do t'i ndezë ato, vështirë është pastaj të ndalen. Ju faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni, zonja Kelmendi, replikë.

NEKIBE KELMENDI – Unë vetëm po e lexoj tekstualisht propozimin - pikë urgjente të rendit të ditës, të dërguar nga Grupi Parlamentar i LDD-së, ku thotë: “I propozoj që të shqyrtojë në seancën e parë plenare si çështje urgjente këtë pikë të rendit të ditës: Ndërtimi ilegal i banesave kolektive nga Qeveria e Serbisë në lagjet veriore në qytetin e Mitrovicës dhe pasojat”. A nuk është ky reduktim i problemit të Mitrovicës vetëm në çështjet e ndërtimit, kur ajo është një problem madhor. Mos t’i përsëris ato që i thashë më përpara dhe të mos më imputohet mua se nuk jam e interesuar për zgjidhjen e problemit të Mitrovicës, mua që në vitin 2000 e kam ngritur këtë çështje të ndarjes së Mitrovicës kur kanë dashur të zhvendosen institucionet gjyqësore nga ajo pjesë në pjesën jugore të qytetit. Kur të shtrohet çështja e përgjithshme e situatës së përgjithshme të sigurisë politike dhe statusit të Mitrovicës dhe kur të kemi material, siç u cek këtu të bollshëm, që e tha ministri Gjini, atëherë me siguri se kjo sallë do të jetë plot e përplot dhe do të ketë diskutime më konstruktive. Kjo kështu është temë e thatë dhe shumë e ngushtë. E di prapavijën, i di të gjitha, por është temë shumë e ngushtë dhe e reduktuar. Këtu dua ta pranojmë gabimin, sepse pranimi i gabimit nuk është turp, përkundrazi është kulturë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëro Ramadan!

RAMADAN KELMENDI – Unë kam konsideratë, por konsideratën e demanton fakti. Ajo që thotë Nekibja ka të bëjë me datën 27. 3. 2007. Merrni me mend, në muajin e tretë e kemi ngritur këtë dhe kjo ka qenë kërkesë individuale e imja, ndërsa kjo pastaj ka kaluar nëpër procedurë kuvendore e penguar kryesisht nga sekretari i Kuvendit. Për këtë edhe kemi reaguar në mjete të informimit dhe duhet ta mbyllë këtë për hir të një kolegjaliteti, jo për hir të rrethanave të tjera. Ndërkaq, me datën 10.5. ky propozim është ngritur në nivelin shumë përmbajtësor të kërkesës dhe thotë: Kërkesë për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës të ndërtimit ilegal të banesave kolektive nga Qeveria e Serbisë në lagjet veriore të qytetit, e nënshkruar nga 16 deputetë. Edhe me këtë kërkesë nuk ka hy në Kuvend. Ju lutemi, ne jemi pikërisht ata që nuk kemi dashur dhe nuk po duam de fakto për të marrë vendime politike për Mitrovicën dhe kjo është e vërtetë. Nga institucionet e Kosovës dhe Qeveria e Kosovës nuk kemi qëndrime. Duhet të kemi qëndrime politike, sepse unë edhe Qeverisë së Kosovës dhe kryesisht Kryetarit të shtetit të Kosovës i kam dorëzuar materialin me 72 faqe material çka do të thotë decentralizimi i Mitrovicës dhe as që është marrë parasysh. Aty keni qenë edhe ju, Kryetar i nderuar, prezent, kanë qenë edhe të tjerët dhe është dashur së paku edhe material të shqyrtohet. Unë nuk di më ku është ai material. Nuk është e vërtetë se është reduktuar, por është shumë përmbajtësore kërkesa dhe në sajë të kërkesës të marrim qëndrime. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Sot i është kushtuar kujdes mjaft i madh, ka pasur diskutues mjaft dhe ka përfunduar diskutimi. Nuk kemi kuorum për të votuar, kështu që Kuvendi vendos në seancën e ardhshme për këtë çështje. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me propozimin e Prokurorisë Publike të Kosovës për emërimin e një anëtari të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Nuk kemi kuorum që mund ta zgjedhim këtë kandidat, andaj kalojmë prapë në pikën tjetër.

Pika e fundit është:

8. Informata për gjendjen aktuale të krijuar nga zjarret

Thërras ministrin Kuçi ta marrë fjalën. Kjo është vetëm informatë. Në mbledhjen e fundit është kërkuar kjo nga deputetët. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI BLERIM KUÇI – Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar zotërinj deputetë,

Duke pasur parasysh situatën që është krijuar rreth zjarreve kohëve të fundit, duke pasur parasysh edhe situatën çfarë është tani, duke pasur parasysh interesimin që e keni dhe duhet ta keni për këtë situatë, ne kemi vendosur t'u japim një informatë lidhur me menaxhimin e kësaj situate.

Në bazë të nenit 9.3. 16 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese, të nenit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të IPVQ-ve të Kosovës dhe të nenit 4 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës, Qeveria e Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 20.07.2007 mori vendim për themelimin e Komitetit ndërministror për menaxhimin e krizave me rastin e fatkeqësisë natyrore të shfaqjes së zjarreve.

Për shkak të temperaturave të larta që kanë përfshirë zjarrin që nga data 08.07.2007 edhe në vendin tonë ka pas shtim të intensivitetit të përhapjes së zjarreve. Në të gjitha rastet...(Ndërhyrje e kryetarit Kolë Berisha)

KRYETARI KOLË BERISHA – Kjo pikë e rendit të ditës ka hyrë për shkak se kemi pasur tri propozime: nga PDK-ja, nga Komisioni për Bujqësi dhe Pylltari dhe nga Komisioni për Siguri. Do të thotë, tri propozime i kemi pasur për këtë pikë të rendit të ditës, është votuar, ka hyrë si pikë e rendit të ditës për sot. Prandaj, vazhdojmë me informatën. Urdhëroni zoti ministër!

MINISTRI BLERIM KUÇI – Faleminderit, zoti Kryetar, edhe njëherë. Do të thotë, për shkak të temperaturave të larta që kanë përfshirë rajonin që nga data 08.07.2007 edhe në vendin tonë ka pasur shtim të intensitetit të përhapjes së zjarreve. Në të gjitha rastet është intervenuar me kohë dhe rreth përhapjes së zjarreve në përmasa të mëdha nuk ka pasur. Me gjithë këtë, për shkak të paralajmërimit të instituteve meteorologjike të vendit dhe të atyre ndërkombëtare se temperaturat gjatë këtyre dy muajve do të shënojnë rritje, efektivat ekzistuese të autorizuara për përcjellje dhe parandalim të situatave emergjente në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përkatësisht Departamenti për

Menaxhimin e Emergjencave ka ngritur nivelin e gatishmërisë emergjente duke aktivizuar të gjitha kapacitetet në disponim dhe koordinuar punën me drejtoritë për menaxhimin e emergjencave nëpër komuna.

Në fazën e parë, pra, që nga data 08.07.2007 e deri më datën 18.07.2007 situata është përballuar nga njësitë komunale për mbrojtje dhe shpëtim dhe ndihmë kryesisht nga brigadat e zjarrfikësve nëpër komuna. Duke i parë mundësitë e eskalimit të situatës, Ministria e Punëve të Brendshme përmes drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Situatave, zotëri Bislim Syrrapi në takim me Kryeministrin edhe kryeshefat e komunave, të mbajtur më 20.07.2007, ka paraqitur gjendjen dhe ka dhënë udhëzime shtesë për përballimin e situatës së shkaktuar nga fatkeqësia elementare e zjarreve. Me datën 20.07.2007 sipas raportit të njësive operative në terren ka rezultuar se situata është përkeqësuar dhe për këtë arsye Qeveria e Kosovës themelon Komitetin qeveritar për menaxhimin e krizës në vend. Komiteti me ndërmjetësimin e zotëri zëvendëskryeministrit Lutfi Haziri menjëherë fillon operacionalizimin e situatës dhe në të njëjtën ditë lëshon Urdhëresën administrative nr. 2007/4 me të cilën komunat urdhërohen që të formojnë nënshtabet në komuna në mënyrë që të mobilizohen në menaxhimin e situatës së shkaktuar nga fatkeqësia elementare e zjarrit si dhe të koordinojnë veprimet me komitetet qeveritare dhe me institucionet e tjera relevante si TMK-në, SHPK-në, KFOR-in e të tjera, të angazhuara në parandalimin e përhapjes së zjarreve. Përkundër angazhimit maksimal të njësive të zjarrfikësve në terren, temperaturat e larta kanë favorizuar aktivizimin e vatrave të zjarrit dhe nga 31 lokacione të përfshira me zjarr më 23. dhe 24. 07. 2007 numri i lokacioneve të përfshira me zjarr shtohet në 71, kryesisht zjarre malore dhe hamullore.

Në kuadër të angazhimeve të Komitetit qeveritar për Menaxhimin e Krizës, me datën 24 kompetencat për udhëheqje i kalohen ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe menjëherë, po në këtë ditë, në propozim të ministrit Qeveria miraton vendimin nr. 06-264 përmes të cilit urdhërohen shtabet komunale që në përputhje me gjendjen e krijuar në terren të mobilizojnë burime shtesë njerëzore, pra njësi vullnetar dhe materiale për t'i futur në funksion të pengimit të përhapjes së zjarrit, si dhe qëndrimi nr. 2/264 i cili kërkon nga Kryeadministratori i Kosovës që brenda kuadrit të gjendjes së gatishmërisë emergjente të marrë masa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me kompetencat e rezervuara e që i lehtësojnë procedurat, kryesisht në komunikacionin ajror dhe të ndihmave ndërkombëtare. Si rezultat i këtyre masave shtesë, me datën 25 numri i lokacioneve të përfshira nga zjarri nga 71 zvogëlohet në 31. Mirëpo, për shkak të terrenit të vështirë, njësitë tona e kanë pasur të pamundur të afrohen në afërsi të lokacioneve të zjarreve të cilat gjenden në thellësi të maleve tona. Për këtë shkak nga data 24 kemi bërë përpjekje për sigurimin e aeroplanëve dhe të helikopterëve për intervenim nga ajri si e vetmja mundësi për intervenim adekuat në zonat e thella. Kërkesat për këtë ua kemi drejtuar vendeve që kanë në dispozicion mjetet e tilla, si Franca, Gjermania dhe Sllovenia.

E para në ndihmë na është ofruar Qeveria sllovene, e cila përmes komandës së tyre ushtarake që gjendet në kuadër të KFOR-it, ka angazhuar një helikopter. Ndihma nga shtetet e tjera në këtë fazë thuajse ka qenë e pamundur për arsye se pjesa më e madhe e mjeteve të këtilla është angazhuar në rajon, ku gjendja ka qenë më alarmante dhe më e vështirë.

Njësitë ajrore të KFOR-it nuk posedojnë aeroplanë apo helikopterë për intervenim nga ajri. Helikopterët që janë në dispozicion të tyre mund të adaptohen për qëllime të zjarrfikjes, por ata nuk janë efektiv si mjetet e bëra enkas. Insistimet tona që të futen në funksion kapacitetet ajrore të KFOR-it kanë hasur në mirëkuptim pasi së bashku me zëvendëskryeministrin Lutfi Hazirin dhe komandantin e trupave të KFOR-it zotin gjeneral Rolan Kater më 27.07.2007 nga ajri me helikopter vizituam zonat e përfshira nga zjarri dhe pamë për së afërmi gjendjen. Kështu, me datën 28.07.2007, në takim me gjeneralin Kater, u dakorduam për veprimet e mëtutjeshme dhe përcaktuam prioritetet ku duhet të intervenohet me helikopter. Po në këtë ditë, KFOR-i angazhoi në veprim një helikopter të tipit BEL UH - 1 dhe një të tipit AS TRA TRA 2 SUPER PUMA, të cilët vepruan kryesisht në zonat e Gjakovës, ku gjendja ishte më kritike.

Si rezultat i angazhimit të njërive në terren, ne me datën 28 kemi pasur një gjendje relativisht të kënaqshme, duke reduktuar numrin e vatrave të zjarrit nga 71 në 24 me datën 28. Mirëpo, përkundër kësaj, ne si Komitet, në takimet e rregullta ditore, krahas rezultateve kemi vërejtur edhe disa të meta organizative, mënjanimi i të cilave do të rriste efikasitetin e veprimit. Për këtë arsye, me qëllim të rritjes së efikasitetit të veprimit në terren, vendosëm masa shtesë duke nxjerrë edhe një varg vendimesh, si urdhëresën nr. 561 datë 29.07.2007 me të cilën obligohen Shtabet komunale të krizave që të formojnë grupe të vogla për vëzhgim, shuarje dhe evitim të zjarrit, krejt kjo me qëllim të rritjes së operativitetit në terren në mënyrë që veprimet të orientohen në ndërtim të parandalimit të përhapjes së zjarreve.

Po ashtu, kemi bërë paralajmërimin e Vërejtjes nr. 562 datë 29.07.2007 e cila u është dërguar të gjithë kryetarëve të komunave, kryeshefave ekzekutiv dhe shefave të nënshtabeve komunale me qëllim që ata të jenë në funksion të gjendjes së krijuar si pasojë e zjarreve dhe të veprojnë në përputhje me ligjin dhe Po ashtu, u vendos vendimet e nxjerra nga Qeveria me rastin e situatës së krijuar.

Po ashtu, u vendos që të krijojmë një task forcë, grupim koordinues të përbashkët të përberë nga TMK-ja, zjarrfikësit dhe njësitë vullnetare, e cila në përbërje do të ketë rreth 200 efektiva, ku me këtë rast është emëruar komandanti i Incidentit, zotëri Nazim Ibrahimaj, komandant i Zonës së Tretë të TMK-së. Kjo është bërë me qëllim që të eliminohet tërësisht vatra e zjarrit në komunën e Gjakovës, duke koordinuar punën edhe me njësitë zjarrfikëse të Shqipërisë, si dhe me qëllim që kjo njësi të ketë mundësi veprimi në zonën e Deçanit, të Pejës dhe të Prizrenit.

Sipas inspektorëve për hulumtimin e shkaqeve të zjarrit, shkaktar i zjarreve në territorin tonë është kryesisht faktori njeri. Një pjesë e zjarreve është shkaktuar si pasojë e pakujdesisë së qytetarëve, ku temperaturat e larta kanë favorizuar përhapjen e zjarrit në përmasa të mëdha, kurse pjesa tjetër e zjarreve është pasojë e papërgjegjshësisë së qytetarëve, të cilët, edhe përkundër apeleve nga organizatat ekologjike dhe qeveritare që në këto temperatura të larta të jenë të përgjegjshëm, ata shkaktajnë zjarret të hapura, sidomos në sipërfaqet e korrura me grurë, zjarre këto që në shumë raste kanë dal jashtë kontrollit dhe kanë shkaktuar pasoja të mëdha.

Pjesa e zonave të përfshira nga zjarri, e që ne kemi probleme serioze, janë zjarret që përhapen nga zonat kufitare, kryesisht vijnë nga pjesët e shteteve fqinje, nga Serbia, Mali

i Zi, Maqedonia dhe Shqipëria. Njësitë tona të ndërhyrjes në përballje me zjarr në këto zona kanë vërejtur një neglizhencë totale të njësive zjarrfikëse të këtyre shteteve fqinje.

Në kuadër të përpjekjeve tona jemi angazhuar dhe kemi vënë kontakt me shtetet përkatëse me qëllim të parandalimit të zjarreve në këto zona. Deri më tani kontakte kemi vendosur me Zyrën Ndërlidhëse të Republikës së Shqipërisë dhe jemi në procedurën e hartimit të një Memorandumi për veprim të përbashkët.

Shërbimi Policor i Kosovës ka shtuar aktivitetin e vet në gjithë territorin e vendit në mënyrë që hetimet rreth ngjarjeve ku dyshohet se shkaktar i zjarrit ka qenë faktori njeri. Ne jemi të vendosur që të dërgojmë para drejtësisë të gjithë ata individë të papërgjegjshëm të cilët ...(ndërprerje e diskutimit nga ana e teknikës). Për momentin ne jemi në gjendjen e parandalimit të përhapjes së zjarreve dhe eliminimin e vatrave të zjarrit. Në këtë situatë është herët për të përcaktuar dëmet materiale, por ajo që mund të deklarojmë tani është se të vdekur si pasojë e zjarrit nuk kemi, të lënduar lehtë kemi rreth 120 raste, ata janë pjesëtar të njësive të zjarrfikësve dhe të TMK-së, të cilët pas dhënies së ndihmës së parë janë kthyer në veprim. Në anën tjetër, deri më sot nga flakët e marra janë djegur tërësisht dhe pjesërisht 40 mijë objekte banimi dhe objekte përcjellëse.

Ne mendojmë se deri më tani kemi krijuar një infrastrukturë ligjore të nevojshme që kryesisht buron nga ligjet në fuqi. Qeveria ka ndarë një fond emergjent prej 700 mijë eurosh për të cilën mendojmë se në këtë fazë është i mjaftueshëm. Me angazhimin e përbashkët të të gjitha strukturave të angazhuara për përballimin e situatës, të njësive të zjarrfikësve, të njësive vullnetare, të KFOR-it, të TMK-së, të SHPK-së, të Agjencionit të pyjeve dhe të qytetarëve jemi duke bërë përpjekje maksimale për përballimin e gjendjes së krijuar nga zjarret.

Situata sot: kemi pesë zjarre aktive nën kontroll, kemi 14 zjarre pasive që jemi duke i shuar. Po ashtu, ne kemi pasur edhe një pyetje parlamentare nga zoti deputet Mazllo Kumnova lidhur me zjarret që iu ka drejtuar zotit Tomë Hajdaraj. Në qoftë se deputeti konsideron se kjo është një përgjigje, ju kisha lutur që ta tërheq pyetjen e vet parlamentare. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Sipas radhës Grupi Parlamentar i PDK-së e ka fjalën, si sponsorues. Xhevat Bislimi, urdhëroni!

XHEVAT BISLIMI – Faleminderit, zoti Kryetar. Zjarret në Kosovë pothuaj se çdo vit, po sidomos këtë vit, përbëjnë një kërcënim serioz edhe për sistemin ekologjik, edhe për pyjet, edhe për tokën, edhe për shëndetin publik. Unë kam vërejtje edhe për Qeverinë, e cila nuk ka qenë që në fillim e angazhuar në çështjen e shuarjes së zjarreve, sepse zjarret, siç e dini të gjithë, në Kosovë kanë filluar të ndizen që në fillim të korrikut, kurse Këshilli ndërmintor për këtë çështje emergjente është krijuar diku më 21 a 22 korrik, do me thënë me 20 ditë vonesë. Zjarret në Kosovë nuk kanë ndodhur vetëm këtë vit. Zjarre ka pasur edhe viteve të tjera, verave të tjera, sivjet sigurisht më shumë. Zjarre ka pasur edhe për 1 maj, bile në një masë të madhe dhe shumë të dëmshme, me djegie edhe të gomave që rrezikojnë shëndetin e njerëzve më shumë se zjarret e tjera. Qeveria në këtë drejtim nuk i ka kryer obligimet e veta, nuk ka bërë fushatën e mjaftueshme për t'i ndërgjegjësuar njerëzit që të mos ndezin zjarre, të mos e ndotin ambientin, të mos e shkatërrojnë

sistemin ekologjik. Këtë verë situata është dramatike dhe të gjithë jemi të vetëdijshëm për këtë situatë. Është një tendencë ose një përshtypje që po përpiket të krijohet se zjarret kryesisht janë ndezur nga temperaturat e larta, janë shkaktuar nga temperaturat e larta dhe nga pakujdesia e njerëzve. Unë personalisht po mendoj dhe shumë të tjerë kanë përshtypjen se këto zjarre në Kosovës sikur po orkestrohen sivjet, sikur po frymëzohen, po nxiten nga hijet e padukshme. Por, me qenë se ne si Kosovë nuk i kemi shërbimet e nevojshme që do të merreshin me hetimin e këtyre çështjeve, me ndjekjen e këtyre çështjeve dhe me parandalimin e tyre, sidomos, nuk po dua të jem absolut në konstatimin tim.

Është edhe një diçka e dëmshme që ministri sot këtu në fjalën e tij e korigjoi, por që e kemi dëgjuar edhe nga qeveritarët, edhe nga gjenerali i KFOR-it edhe nga disa media se zjarri po vjen nga Shqipëria dhe nga Maqedonia. Sot këtu ministri e tha edhe nga Serbia. Unë mendoj se zjarri në qoftë se duhet kërkuar edhe të keqen, duhet ta dimë ku e kemi të keqen, nga vjen e keqja, nga na ka ardhur, nga po vjen, dhe nga dora e tyre që mund të jetë aktive në Kosovë. Prandaj, mos të manipulojmë me opinionin, mos të krijojmë përshtypjen, siç dimë mbrapsht nganjëherë, se çdo e keqe na vjen nga Shqipëria, nga Maqedonia e të tjera. Kam vërejtje për Qeverinë edhe në prezantimin e numrit të zjarreve. Unë jetoj në komunën e Vitisë dhe mund t'ju them se veç në komunën e Vitisë janë ndezur jo 70, po ndoshta 700 zjarre. Secili mund ta vërtetojë edhe në Viti, edhe në komunat e tjera se gati nuk ka mbetur arë e korrur pa u djegur. Me këtë çështje mendoj që duhet të merret edhe kleri dhe ta trajtojë nga aspekti fetar para besimtarëve të tyre, t'u thuhet se është mëkat që të digjet toka, të digjet mali, sepse aty digjen edhe miliona gjallesa edhe mos t'ju flitet njerëzve vetëm për atë botë, po t'u flitet pak edhe për këtë botë. Por, kryesisht duhet të merret Qeveria dhe mos t'ia lë rastin, mos të pres që të digjet një sipërfaqe e madhe e Kosovës, të dëmtohet, të shkaktohet një dëm i pallogaritshëm ekologjik, një ndotje e pallogaritshme e ambientit, e pastaj të reagohet, sepse zjarre nuk kemi pasur vetëm këtë vit. Kjo ishte ajo që doja të thoja dhe ta porosisja Qeverinë që në kohën që digjet Kosova, të mos krihet, se nuk del mirë dhe nuk është në nivel të detyrës që e ka marrë me vullnetin e saj. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit! Propozuesi i dytë është kryetari i Komisionit, zoti Maloku.

NAIM MALOKU – I nderuari zoti Kryetar,
I nderuari zoti ministër,
Të nderuar deputetë,

Unë pajtohem me një masë të madhe të fjalëve që i tha deputeti Xhevat Bislimi, i cili është edhe anëtar i Komisionit për Siguri. Në emër të Komisionit për Siguri, duke vlerësuar situatën më 20 korrik 2007 iu kam drejtuar Departamentit të Menaxhimit të Emergjencave me kërkesën për raport në lidhje me këto pika: Vlerësimin e shkaqeve të paraqitjes së zjarreve, masat e ndërmarra për evitimin e pasojave, si ka qenë niveli i gatishmërisë në nivel qendror dhe lokal dhe sa kanë qenë efektive njësitë tuaja, si ka qenë bashkëpunimi me KFOR-in dhe TMK-në për reagimet në këto situata. Kam paralajmëruar Departamentin që Komisioni, nëse vlerëson se ka nevojë, do të organizojë dëgjim publik me Departamentin tuaj për këtë situatë. Komisionit Parlamentar iu ka

drejtuar Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave me një raport, të cilin e kam shpërndarë, të nderuar deputetë.

Më lejoni që nga kjo foltore, duke përcjellë situatën për së afërmi t'ju them se prej datës 20. 7. orari i punës sime fillon në Qendrën e situatave në orën 8,00, pra për t'u njoftuar me situatën në lidhje me përballjen me këtë gjendje në 24-orëshin paraprak. Duke përcjellë me vëmendje dhe me shqetësim situatën e krijuar në dy javët e fundit dhe ballafaqimin me zjarret e shumta në territorin e Kosovës, mund të konstatoj se niveli i organizimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Departamentit për Menaxhimin e Emergjencave, të Shërbimit Policor të Kosovës dhe të Trupave Mbrojtëse të Kosovës ka qenë në nivel të duhur konform mjeteve dhe efektivave që i kanë në dispozicion. Kur them këtë, konform, atëherë dua t'ju jap, të nderuar deputetë, një shembull. Komuna e Deçanit disponom me 25 mijë hektarë pyje të pronës shoqërore, pra të shtetit, ka në dispozicion dy zjarrfikës dhe një automjet për shuarjen e zjarrit. Pra, konform mjeteve, pajisjeve, konform njësive, niveli organizativ i Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Departamentit për Menaxhimin e Emergjencave, të Shërbimit Policor të Kosovës, të TMK-së ka qenë në nivel të duhur dhe konform situatës dhe duke dhënë maksimumin për t'u përballur me to.

Të nderuar deputetë,

Komisioni Parlamentar për Siguri do të merret me këtë çështje. Dëgjim publik do të organizojmë me të gjitha segmentet që janë marrë me përballje me situatën dhe konform raportit dhe të gjitha informatave që i kemi dhe vlerësimit që do të bëjë Komisioni Parlamentar për Siguri, ne do t'i drejtohem këtij Kuvendi me rekomandimet e duhura. Si shoqëri duhet të merremi me situatën. Shoqëria kosovare nuk ka qenë e sensibilizuar në nivel të duhur për t'u përballur me situatën.

Të nderuar deputetë,

4.500 OJQ janë të regjistruara në territorin e Kosovës që janë më shumë se të mjaftueshme edhe për një shtet 100 milionë banorësh. Në media nuk kemi hasur asnjë OJQ që ka formuar një shtab që ka thirr dhe ka mobilizuar 5 vetë për t'u përballur me zjarrin dhe që del e thotë, ne e kemi shpëtuar një dru nga ndezja, pra ia kemi shpëtuar Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Partitë parlamentare që jemi këtu, dhe partitë që janë jashtë Parlamentit, kur i dëgjojmë se sa libeza kanë shpërndarë, mund të vijmë në një konkludim se Kosova ka më tepër se 25 milion banorë. Asnjë degë, asnjë nëndegë e asnjë partie parlamentare as jashtë parlamentare nuk ka mobilizuar 5 anëtarë për t'i dërguar dhe sot të thotë para Kuvendit, para qytetarëve të Kosovës se partia jonë e ka shpëtuar një metër katror, 5 metra katror, apo e ka shuar apo e ka lokalizuar një zjarr. Kjo është gjendja. Është vetëm Dega e Partisë Reformiste ORA e Pejës që 4 ditë pasi ka shpërthyer zjarri në Bjeshët e Rugovës, iu ka drejtuar përmes mjeteve të informimit me apel KFOR-it, Shërbimit Policor të Kosovës, zjarrfikësve, TMK-së që të shkojnë në malet e Rugovës dhe ta shuajnë zjarrin. Kjo është gjendja e shoqërisë sonë. Ne duhet të merremi seriozisht me vetveten, duhet të merremi seriozisht me shoqërinë tonë, si po reagon shoqëria jonë në këtë situatë. Kjo çka

na ka ndodhur ne është me pasoja të pariparueshme, këtë duhet ta pranojmë. Ne do t'i vlerësojmë dëmet. Ato janë të pariparueshme, por ne duhet më në fund seriozisht të merremi me vetveten, si po reagon shoqëria jonë. Nuk është vetëm Qeveria e Kosovës, që i ka ato pak mjete, ajo që duhet të reagojë në këso situatash. Ne duhet të përgatitemi të përballemi edhe me vërshimet, ndoshta në fund të këtij viti. Ju kujtohet viti 1979 me çfarë pasojash kanë qenë vërshimet. Kjo situatë që ka ndodhur këtë vit ka qenë para 30 vjetësh, pra në vitin 1977. Sipas burimeve sinoptike që i përcjellin dhe i krahasojnë vitet me vite, ne duhet të përgatitemi që në një periudhë mund të ndodhin vërshimet sivjet, mund të ndodhin në mot. Pra, unë ftoj deputetët, Kuvendin e Kosovës, ftoj të gjitha ministratë, Ministrinë e Arsimit, ne duhet të merremi edhe me edukimin e qytetarëve, me edukimin e fëmijëve, të nxënësve tanë, me edukimin e brezit që vjen si të përballen me situatën. Ne kemi qasje të patolerueshme ndaj mjedisit tonë ku jetojmë. Si shoqëri ne duhet të merremi me këtë. Duhet të merret Ministria e Shëndetësisë, Komisioni Parlamentar për Shëndetësi, sa është e dëmshme kjo erë e shkrumbit nëpër krejt territorin e Kosovës. Nuk ka fshat që nuk i vjen era shkrumb, sa është e dëmshme kjo për shëndetin.

Të nderuar deputetë,

Një popull që është djegur nga të tjerët, sot e djeg veten. Keni parasysh këtë, 75 raste janë nën hetime, 9 padi penale për zjarrvënie të qëllimshme. Ne duhet të merremi seriozisht me këtë çështje. Pra, duke ju siguruar se Komisioni Parlamentar për Siguri do të organizojë debate publike, do të merret me këtë çështje nga segmenti i fushëveprimit të vet. Ju ftoj të nderuar deputetë, që të gjithë, krejt shoqëria jonë të merret me vetveten dhe si po reagon shoqëria jonë në këso situatash dhe çfarë qasje ka shoqëria jonë ndaj mjedisit. Nuk ka lum që nuk është i mbushur me mbeturina. Këso qasjeje nuk ka askush në shtetet e BE-së ndaj mjedisit. Ne duhet të merremi me këtë prej Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Shëndetësisë, Qeverisë.

Ndoshta do të duhet të bëjmë ndryshime dhe plotësimin e Ligjit për fatkeqësitë natyrore dhe të tjera për shkak se jemi vonuar. Njëherë Komitetin ndërministror e ka udhëhequr zëvendëskryeministri Lutfi Haziri, pastaj është bërë veprimi i duhur dhe i nevojshëm që atë komitet ta udhëheq ministri i Punëve të Brendshme. Ju kujtohet, të nderuar deputetë, mandatin e kaluar kur këtu nga kjo foltore kam kërkuar që Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave të ristrukturohet nga Ministria e Shërbimeve Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka pasur reagime jo të mira në atë kohë, por sot është parë se është veprimi më i qëlluar që Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave është ristrukturuar në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Pse? Sepse është parë një bashkëpunim i shkëlqyeshëm në mes Departamentit për Menaxhim të Emergjencave, Shërbimit Policor të Kosovës edhe TMK-së. Falënderoj KFOR-in, Qeverinë Sllovene që të premtën e kaluar kanë dërguar ministrin e Punëve të Mbrojtjes për të inspektuar situatën dhe për të ndërmarrë hapa për ndihmë në ballafaqimin me këtë situatë.

Të nderuar deputetë,

Në fund, një vlerësim timin personal. Emërimi i njerëzve kompetentë dhe i njerëzve të duhur në poste dhe pozicione të duhura është treguar edhe kësaj radhe. Çdo lëvdatë për ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Blerim Kuçi, për nivelin organizativ të lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, çdo lëvdatë për Departamentin për Menaxhimin e

Emergjencave. Kjo na jep një dëshmi dhe një shembull angazhimi dhe përkushtimi se çka do të thotë kur njerëzit e përkushtuar të emërohen në pozicionet e duhura. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, Alush Gashi.

ALUSH GASHI – Faleminderit, i nderuari zoti Kryetar,

S'është e tepërt të theksohet se vera e vitit 2007 është verë e nxehtë në Evropën Juglindore e përfshirë me shumë zjarre dhe me humbje të një pasurie, për të cilën nevojiten dekada për kompensim.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mirëpret raportin e zotëri ministrit Kuçi, një raport i cili është përgatitur me kohë, është një raport i detajuar dhe shumë profesional. Ne e lavdërojmë punën, zoti Kryetar, të komisioneve funksionale të Kuvendit të Kosovës, të cilat me kompetencë dhe përkushtim e kanë përcjellë punën e Qeverisë, të Komisionit ... dhe ka demonstruar një bashkëpunim të pasqorë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, të cilën me shumë sukses dhe kompetencë e udhëheq ministri Kuçi.

Më lejoni, zoti Kryetar, në këtë rast të theksoj se është hera e parë që Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës të punojë kaq intensivisht me qytetarët e Kosovës për parandalimin e zjarreve. Kish mund të ishte më mirë, ashtu siç tha edhe kryetari i Komisionit për Siguri, por kemi shembuj shumë të mirë, siç është rasti i qytetarëve të organizuar në Therandë, apo i atyre në Rugovë, por ka edhe raste të tjera të cilat mund të përmenden në një rast tjetër.

Bashkëpunimi i ministrit Kuçi me KFOR-in, me SHPK-në, me TMK-në me zyrat e ndërlidhjes dhe me shtetet në veçanti, ka dhënë rezultate të mira. Natyrisht, është detyrë e jona, si deputetë, që të kërkojmë nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave që për Buxhetin e vitit 2008, por edhe për vitet e ardhshme, në kuadër të standardeve të cilat i ka miratuar ky Kuvend dhe për të cilat është e obliguar Qeveria jonë, zjarrfikësve të Kosovës t'ju sigurojë pajisje, që njësisë për emergjencë në TMK t'ju sigurojë pajisje, që zyrave në nivelin komunal t'ju sigurojë pajisje, që të ndajë fonde për edukimin e popullatës lidhur me këto çështje. Natyrisht, çdo deputet i grupit tonë do të kishte pasur dëshirë që lidhur me këtë çështje të kontribuojë, por ne kemi bashkëbiseduar që kësaj radhe lidhur me këtë çështje ta përfundojmë me kaq. Ne do t'i japim mbështetje të plotë Qeverisë në të gjitha aspektet që në vitet e ardhshme të jemi shumë më aktiv në rastet e emergjencës. Ju faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! fjalën e ka Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADRGJONAJ – Faleminderit, zoti Kryetar,

Bazuar në situatën që mbizotëron në terren, ku pothuajse në të gjitha komunat e Kosovës ka pasur zjarre, është shumë mirë që edhe nga Grupi Parlamentar i PDK-së, por edhe nga Komisioni për Siguri është kërkuar që të debatohet rreth kësaj çështjeje mjaft të

rëndësishme, rreth djegies së pyjeve të cilat kanë ndodhur gjatë kësaj vere. Desha që në fillim të them se kur nuk mobilizohet Qeveria, atëherë çka të pritët prej të tjerëve. Kjo është një çështje që ka të bëjë drejtpërsëdrejti me Qeverinë. Persona të caktuar kanë marrë pjesë në shuarjen e zjarreve dhe nëse nuk kanë shkuar në mënyrë të organizuar partitë politike për të shuar zjarrin, atëherë në mënyrë individuale iu kanë bashkëngjitur grupeve të caktuara të cilat kanë marrë pjesë në shuarjen e zjarreve.

Pyjet janë dëmtuar edhe në të kaluarën, por shqetësuese ka qenë që në përmasa mjaft të mëdha pyjet janë dëmtuar pas luftës, qoftë nga keqbërësit, por edhe veprimet të studiuar jo sa duhet nga institucionet. Dëmtimet legale dhe ilegale të drunjve halorë kanë vazhduar në kontinuitet, kurse Qeveria nuk ka paraparë ndonjë plan të mirëfilltë dhe afatgjatë për ruajtjen dhe shfrytëzimin racional të pyjeve. Këtë vit u shtua edhe dukuria e djegies së pyjeve që ka dëmtuar dhjetëra hektarë pyje, kurse Qeveria ka qëndruar anash thuajse kjo gjë po ndodh jashtë kufijve të Kosovës e jo në territorin e saj.

Mbrojtja e pyjeve ka rëndësi të madhe në aspektin ekonomik, por edhe në aspektin politik, ekologjik dhe strategjik, sepse gjysma e territorit të Kosovës është e përfshirë me pyje. Prandaj, çdo nismë në drejtim të mbrojtjes së pyjeve e konsideroj si diçka pozitive. Po çfarë ka bërë Qeveria që të ruhet biodiversiteti dhe të mos prehen egërsisht dhe ilegalisht pyjet dhe të mos digjen ato? Pothuaj se asgjë. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në qershor ka nisur fushatën: “T’i mbrojnë pyjet tona”. Qëllimi i kësaj fushate ka qenë që të sensibilizohet opinioni i gjerë dhe të vetëdijësohen qytetarët të mos dëmtojnë pyjet, mos të bëjnë prerje ilegale dhe të mos i ndezin pyjet dhe të kenë kujdes për këtë pasuri të madhe shoqërore. Për këtë fushatë kësaj Ministrie i janë nda 20 mijë euro në vit. Fushata do të zgjasë tri vjet dhe buxhetit do t’i kushtoj, 60 mijë euro. Por, siç është bërë dukuri, nga kjo Qeveri edhe në këtë rast kanë mbizotëruar shfrytëzimi joracional i mjeteve. Financimi i mjeteve duhet të pasojë me rezultate, por në këtë rast, në vend të rezultateve pozitive rezultojnë rezultatet negative. Shtrohet pyetja: Cilat janë efektet e kësaj fushate që po i kushton Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës? Pa u bërë një muaj, pyjet e Kosovës u dëmtuan në përmasa të paparashikuara nga zjarret e shkaktuara në disa raste nga vapa, e në shumë raste nga pakujdesia dhe nga keqbërësit, kurse Qeveria ka vëzhguar nga lart. Në një material që kemi këtu shihet se me datën 20.7. Qeveria ka marrë një vendim për themelimin e Komitetit ndërministror për menaxhimin e krizave në rast të fatkeqësive natyrore, në rastin konkret të shfaqjeve të zjarreve. Qeveria në vend të intervenimit të shpejtë për të shpëtuar pasurinë kombëtare, me avashllëk formon komitete, apo këshilla, si zakonisht në këto raste, të cilat i udhëheq si zakonisht zëvendëskryeministri, i cili asnjëherë nuk raporton se çfarë është bërë në atë komision apo në atë këshill të cilën e ka udhëhequr, sepse në fakt nuk bën asgjë dhe në fund jep dorëheqje pa ndonjë obligim tjetër të caktuar.

Në materialin që e kemi përpara dhe në atë që tha zoti ministër, shihet se në të gjitha rastet është intervenuar me kohë dhe përhapje të zjarreve në përmasa të mëdha nuk ka. Sipas Qeverisë, nuk paska përhapje të zjarreve në përmasa të mëdha! Ndoshta Qeveria ka pritur që të digjen 50% të pyjeve dhe qindra shtëpi, të vdesin njerëzit në përmasa të madha e tek pastaj të llogaritet përhapja zjarreve në përmasa të mëdha dhe atëherë të sensibilizohet seriozisht Qeveria.

Zjarret kanë shpërthyer anembanë Kosovës, kanë lënë të lënduar shumë qytetarë, pjesëtarë të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, të cilët janë angazhuar në shtabet komunale, të cilat në kushte shumë të rënda pa pajisje të duhura kanë dhënë maksimumin e mundshëm për të evituar zjarret. Djegia mbi 10% e pyjeve është dëshmi se Qeveria nuk është e aftë të përballet me situata emergjente. Qeveria çdoherë kur janë paraqitur rastet emergjente është gjendur jashtë lojës, si edhe në këtë rast. Kjo i ka kushtuar miliona euro Buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Kjo djegie që ka ndodhur në pyjet e Kosovës nuk ka ndodhur për një natë, por me javë e muaj të tërë edhe para temperaturave të larta. Zjarri gjatë këtij muaji dogji pyje, kullosa e shtëpi, rrezikoi jetën e shumë qytetarëve dhe kjo është dëshmia më e mirë e dështimit të kësaj Qeverie. Qeveria nuk ka vizion të përballet me kriza. Këtë e ka dëshmuar në të gjitha rastet kur janë paraqitur situata emergjente. Persona përgjegjës për të menaxhuar me këtë situatë po sillen në atë mënyrë thua se nuk po ndodh gjë. Shumica e zjarreve janë shkaktuar nga keqbërësit dhe mosmarrja e masave efikase nga personat kompetent ka krijuar përshtypjen tek qytetarët se kjo neglizhencë po bëhet me qëllim nga se më pas pasojnë tenderët për pastrimin e pyjeve, zyrtarët qeveritarë i kanë interesat e tyre për të marrë përqindjet të cilat janë bërë dukuri në këtë Qeveri, kurse keqbërësit interesat e tyre për t'i fituar tenderët dhe në emër të pastrimit të pyjeve të shkatërrojnë edhe pjesën e padjegur të pyjeve dhe të fitojnë miliona euro. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI – I nderuari Kryetar,
I nderuari ministër,

Situata për të cilën sot e kemi marrë një informatë apo raport, është mjaft interesante. Është prezantuar një angazhim thuajse i përciptë lidhur me gjendjen në të cilën po kalon Kosova. Nuk e kam ndërmend të zgjatëm shumë me raportin sepse ne si Kuvendi dhe si ministri apo shoqëri në Kosovë duhet të angazhohemi që t'i marrim dhe t'i bëjmë ndryshimet në mënyrë që gjendja e ardhshme të mos na befasojë.

Unë mendoj që fakti i dhënë që në komunën e Deçanit ekzistojnë, për shembull, vetëm dy zjarrfikës, një makinë dhe 25 mijë hektarë pyje, tregon se është e pamjaftueshme të menaxhohet gjendja në komunën e Deçanit me dy zjarrfikës dhe një makinë. Ndërsa, anën tjetër, mendoj që e tha edhe deputeti zoti Alush, që për 2008 apo në mënyrë urgjente të shtrohet nga Ministria dhe propozimi im është që të blihet helikopteri, i cili nuk kërkon një çmim të jashtëzakonshëm dhe ne mund t'i mbulojmë të gjitha këto aktivitete për fikjen e zjarrit. Një helikopter kushton me të gjitha pajisjet që i ka maksimum 2 milion euro, ndërsa dëmet që llogariten deri më tash janë afër 40 milion euro. Prandaj, llogaria është që ne ta blejmë, Kuvendi ta ngarkojë Ministrinë e Financave që të ndaj këtë buxhet dhe me anë të këtij buxheti ta krijojmë mundësinë që mos ta shkatërrojmë pasurinë tonë të cilën e kemi. Po këta helikopter unë mendoj që duhet t'i dedikohen TMK-së, e cila e ka njësinë e emergjencës, njësinë e zjarrfikëseve. Ata janë pjesa kryesore që mund të komandojnë dhe e kanë njësinë e helikopterëve të trajnuar, të specializuar, pikërisht për stërvitjen dhe rastet emergjente të cilat janë. Prandaj, kërkoj që dy helikopter të blihen t'i dedikohen TMK-së dhe TMK-ja të mirret me menaxhimin. Si ka mundësi që një ushtar ose një pjesëtar i TMK-së me një çantë në dorë ose në krah të shkojë e ta fikë zjarrin në

temperaturën dhe në valën e zjarrit. Prandaj, unë i përgëzoj ata që kanë kërkuar që të na ndihmojnë, por ne nuk mund të mbesim gjithnjë në mëshirën e tjerëve që ata të na ndihmojnë neve. Prandaj, ky Kuvend, shoqëria, Ministria dhe Qeveria kanë obligim që ta ndajnë këtë buxhet për blerjen e këtyre pajisjeve teknike në mënyrë që në të ardhmen mos të na ndodh kësso gjendje zjarresh apo fatkeqësish natyrore. Prandaj, emergjenca është e nevojshme dhe kërkoj, si propozim, që Kuvendi i Kosovës të miratojë një buxhet, i cili do të jetë për blerjen e këtyre pajisjeve, të helikopterëve të dedikuar për TMK-në. TMK-ja e ka njësinë e zjarrfikësve dhe ata duhet ta marrin menaxhimin e situatës dhe ta shpëtojnë pasurinë tonë kombëtare. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka zoti Kumnova.

MAZLLOM KUMNOVA – Zoti Kryetar, unë e kam shtruar edhe pyetjen, prandaj jam i interesuar që edhe pak të bisedoj për këtë çështje. Së pari e falënderoj zotin ministër dhe e vlerësoj angazhimin e tij në këtë periudhë. Unë propozoj që për seancë tjetër, meqë jemi në gjysmën e verës dhe nuk është mbyllur kjo çështje ende, të hartohet një raport detaj për dëmet nga zjarri dhe, përkundër përpjekjeve që janë bërë, duhet ta vlerësojmë se organizimi i komuniteteve dhe përgatitja për rastet të tilla ka dështuar plotësisht. Partitë politike nuk mund ta bëjnë organizimin. Çdo statut i kuvendeve të komunës e ka të përshkruar organizimin e komuniteteve dhe të lagjeve. Këtë nuk e kemi. Ministria e Pushtetit Lokal duhet të merret thjesht me këtë çështje. Të sigurohen pajisjet speciale për ndërhyrje efikase. Unë kam qenë në vendin e ngjarjes, e di edhe ministri, ka ardhur njësia e TMK-së, ka ardhur njësia e zjarrfikësve, kanë qenë edhe fshatarët. Edhe ata, edhe unë, edhe ministri duart në xhepa. Asnjë mjet nuk e kanë pasur për shuarjen e zjarrit. Zjarre do të kemi edhe në të ardhmen. Unë propozoj që duhet t'i qasemi në mënyrë serioze kësaj. Këtë herë nuk kemi pasur viktimë, nuk do të thotë që herëve tjera nuk do të kemi. Njësia e zjarrfikësve në krejt botën e ka njësinë organizuar të vullnetarëve. Ne nuk e kemi arritur këtë dhe nuk e kemi, shumë gjëra nuk i kemi. Ndoshta është momenti i fundit që t'i qasemi shumë më seriozisht kësaj çështjeje. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI – Faleminderit Kryetar. Grupi jonë parlamentar sot e ka shqyrtuar informatën dhe e çmon dhe e konsideron si kontribut të madh punën e Ministrisë për Punë të Brendshme në krye me ministrin që ka bërë gjatë shuarjes së zjarreve dhe informatën që e ka përgatitur. Natyrisht, nuk kemi shumë çka të shtojmë, përveç se kjo është një fatkeqësi e madhe. Unë konsideroj se fatkeqësia më e madhe është informacioni që kemi marrë se në këtë ka dorë edhe faktori njeri, dhe ky është vërtetë dëmi më i madh sesa ai që është shkaktuar nga fuqia, nga zjarri e të tjera. Mendojmë se zyrat komunale dhe agjencitë rajonale të pyjeve është dashur që një pjesë të angazhimit më të madh të tyre ta bëjnë në shuarjen e tyre. Unë do të them nga pjesa ku unë i takoj, tash paksa është lokale, qytetarët e fshatrave kanë bërë çmos dhe ne kemi raste shumë evidente që kemi shpëtuar dy shtëpi, jo si subjekt politike, po natyrisht subjekt politik kemi qenë. Dhe krejt në fund, dua ta informoj ministrin e Punëve të Brendshme dhe këtë Kuvend, këta që janë prezent këtu, a e kanë të dhënë apo nuk i kanë këto shënime, prej Kishës Ortodokse Sokolica e deri te fshati Rudar serb që është, kanë shpërthyer 9 bomba dhe fati i fshatit Libë dhe Boletin ka

qenë që nuk është vra asnjë njeri. Ato male që janë djeg na ua kemi bërë hallall, sepse 9 bomba dhe një numër i madh i kasetave askund nuk janë përcjellë në mjete të informimit. Kjo do të ishte ndoshta një tragjedi më e madhe se të tjerat. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni – Kaloshi.

HYDAJET HYSENI – Faleminderit, zoti Kryetar, është kohë e vonë dhe jemi lodhur dhe fjala ime do të jetë e shkurtër.

Një gjë është e vërtetë që edhe ky zjarr, kjo verë e ngrohtë e zuri Qeverinë dhe gjithë Kosovën në befasi, si edhe dimri, si edhe gjithçka tjetër. Kam përshtypjen që edhe ky debat e ka zënë Qeverinë në befasi. Është vetëm ministri i Rendit dhe çështja e zjarrit në gjithë Kosovën konsiderohet vetëm çështje e Ministrisë së Rendit. A është çështje që vërtet u përket të gjithëve dhe duhet t'u përkas të gjithëve? Nuk është çështje që mund të zgjidhet duke hedhur topin. Qytetarët fajësojnë Qeverinë dhe Qeveria tash e ndonjëherë edhe parlamentarët kthehen dhe i fajësojnë qytetarët.

Është kohë në të cilën ne duhet të jemi bashkë për ta përballuar këtë të keqe të madhe, dhe jo të na ndodh si në atë ankdotën kur fshatarët i ankoheshin pashës se ua ka vjedhur dikush qetë, e ai u thoshte, po ju ku ishit? Këta i thoshin, po ishim fjetur. Mirë, thotë, atëherë e paçi veten në qafë, pse ishit fjetur, pse fleni, kurse ata ia kthejnë: - Fjetëm ne pashë, se kujtuam se jeni ju zgjuar, po të ishit ju fjetur, ta dinim që jeni fjetur, ne do të ishim zgjuar. Edhe ne po na ndodh që ti rri, unë rri, e Kosova në flakë. Nëse është e vërtetë se edhe qytetarët duhet të jenë jo vetëm më të kujdesshëm, po edhe më të organizuar, por kush duhet t'i mobilizojë ata? Qeveria, sepse qytetarët kanë bindjen se paguajnë taksa, paguajnë njerëz, paguajnë funksione, institucione, aparate të ndryshme. Prandaj, Qeveria duhet të jetë ajo që t'i organizojë qytetarët dhe bashkë me ta të përballët me të keqen. Jo vetëm me zjarret, por edhe me zjarre tjetër fare, me fatkeqësi tjetër fare që mund të na ndodhin. S'mund të arsyetohemi atëherë nëse kjo verë e nxehtë na ka zënë në befasi, të papërgatitur, edhe pa pajisjet elementare për zjarrfikësit. Do të duhej të shkonin funksionarë nga përgjegjësitë e tyre vetëm për këtë fakt, zoti ministër, zotëri e zonja të nderuara. Por, së paku mos të lejojmë që situata të tilla të na zënë në befasi edhe në të ardhmen se jetojmë kohë kur asgjësë nuk i dihet. Le të na shërbejë kjo tragjedi që të mobilizohemi dhe të organizohemi e të jemi bashkë të gjithë, edhe qytetarët, edhe qeveritarët, edhe parlamentarët, edhe shoqëria civile në fund. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka zoti Canziba.

XHELAL CANZIBA – Faleminderit i nderuari Kryetar,
I nderuari ministër,
Deputetë të nderuar,

Vera e këtij viti po përcillet me temperatura të larta, të cilat po shkaktojnë probleme të mëdha në tërë vendin. Problemet po paraqiten në mungesë të ujit të pijes, kemi djegie masive të pyjeve dhe të livadheve në tërë vendin, ndotje të mjedisit, shkatërrim të florës dhe faunës dhe ndikim të drejtpërdrejtë në botën e gjallë, e në veçanti në shëndetin e njeriut.

Mendoj se gjendja është më tepër se alarmante. Në këtë situatë Qeveria u gjend totalisht e papërgatitur, ashtu si në fatkeqësitë e mëhershme, vërshimet, mbyllja e rrugëve e të tjera. Paralajmërimet e hidrometrologjia në vend dhe në rajon në asnjë mënyrë nuk arritën që të shtyjnë Qeverinë të mendojë se duhet të jetë e gatshme dhe e përgatitur për veprim në rastet të fatkeqësive natyrore dhe të tjera. Djegiet e pyjeve dhe të kullosave në Kosovë kanë filluar gjatë muajit shkurt të këtij viti dhe Qeveria e heshtur si zakonisht. Tashmë në Kosovë janë djegur dhjetëra mija hektarë sipërfaqe të pyjeve dhe të kullosave dhe Qeveria vëzhgon dhe mezi arriti të përgatitet për një mbledhje urgjente më 21 dhe 24 korrik për të dalë me disa masa të cilat janë aq të pakoordinuara dhe me pamundësi të veprimit.

Tash jemi në një gjendje emergjente dhe ende pa veprime konkrete. Qeveria e Kosovës është Qeveri e dështuar për rastet e tilla. Në aspektin e mbrojtjes së mjedisit me rastet e djegieve masive tani më në Kosovë janë shtuar pikat e nxehta të ndotjes së mjedisit, pasojat e të cilave do të ndihen për periudhë të gjatë kohore.

Nga djegiet masive të pyjeve dhe livadheve, vendit i janë shkaktuar dëme të pallogaritshme, të cilat nuk do të mund të kompensohen asnjëherë, sepse djegia nuk ka dëmtuar vetëm masën drunore, po ka shkaktuar deri në zhdukje vlera të jashtëzakonshme floristike, vegjetative dhe faunistike. Andaj, urgjentisht kërkoj nga Qeveria e Kosovës zbatimin e Ligjit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë të tjera, i cili u shpall më 12 janar 2007, hartimin e programit dhe të planit nacional për parandalimin dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, të përcjellë me plane konkrete operative, sigurimin urgjent të pajisjeve të nevojshme për intervenime në raste emergjente për parandalim dhe sanim, veprim dhe koordinim urgjent të aktiviteteve nga ana e resorëve qeveritarë, të pushteteve lokale, të TMK-së, të SHPK-së, të KFOR-it dhe të të gjithë mekanizmave të tjerë të organizuar, përgatitje trajnimi dhe angazhimi të komunitetit për veprim në raste emergjente. Reduktimet e ujit të mos jenë me orar shumë të gjatë gjatë orëve të ditës me temperatura tejet të larta me qëllim të evitimit të epidemive të ndryshme eventuale. Identifikimin e rasteve ku zjarret janë shkaktuar nga faktori njeri dhe zbatimin e masave rigoroze ndaj tyre. Apeloj te të gjithë qytetarët e Kosovës që të jenë më të vëmendshëm gjatë punës dhe aktiviteteve të tyre për të evituar çdo mundësi të shfaqjes së zjarreve dhe për të bërë parandalimin e tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputetja e fundit është Nurishahe Hulaj .

NURISHAHE HULAJ – Faleminderit Kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,

E pash të arsyeshme t'i them dy – tri fjalë duke u bazuar në disa hulumtime botërore për nxemjen globale. Përgëzoj Ministrinë e Punëve të Brendshme, posaçërisht ministrin Kuçi për krijimin e mekanizmave për të zhvilluar aktivitetin në shuarjen e zjarreve në Kosovë. Duke u bazuar në të dhënat hulumtuese botërore dhe projektuese se do të jetë problem global botëror nxemja si bazë e saj temperaturat e larta që janë paraqitur, por që mund të paraqiten edhe në të ardhmen.

Unë personalisht mendoj se Kosova me institucionet e saj duhet të hartojë një strategji për veprim dhe me integritime ndërkombëtare me qëllim që të analizohet çdo vit situata globale eventuale e nxemjes e si pasojë e saj edhe mungesa e ujit. Parashikimet janë se do të ballafaqohemi me deficit të ujit kur dihet se janë shterur shumë lumenj, andaj mendoj se duhet të kemi një projekt strategjik edhe për ujërat në Kosovë në të ardhmen. Mungesa e ujit ka ndikim direkt dhe indirekt në shëndetin e qytetarëve, sidomos në paraqitjen e sëmundjeve ngjitëse dhe shpërthimet eventuale të ndonjë epidemie. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit edhe juve.! Seanca mori fund, shihemi në seancën e radhës.

(Mbyllja e seancës plenare)